

GAZETA SHQIPTARE



Kryeredaktor: Erl MURATI
Zv/kryeredaktore - Rezarta DELISULA
Tel:(04)2359-104, Fax:(04) 2359-116 E-mail:gazetashqiptare@hotmail.com



Viti XXIV - Nr. 7575 E diel 1 Korrik 2018 Çmimi, 50 lekë (1.5 euro)

Opinion Ditës

Jo vetëm se pa budallenj jeta do të kishte pas qenë tepër e mërzi-shme, por rrezik edhe vështrësisht e jetueshme. Monotone, pa yndyrë, pa variacion ...
Vijon në faqen 21

Nga KIÇO BLUSHI

Sa mirë ke bërë, o Zot, që nuk e kufizove budallallëkun!



Opinion Ditës

Në vend të këtij 28 qershori, sikurse i kishte rekomanduar Komisioni Evropian, Këshilli Evropian (organ i përbërë nga 28 kryetarët e Shteteve Anëtare të BE-së) ...
Vijon në faqen 22

Nga FATOS ÇOÇOLI

Kampionati njëvjeçar i integritimit



Pagesa për 2018, 6% zbritje mbi shumën

Pagesa vullnetare, ISSH: Si të merrni pension pleqërie kur s'keni punuar

“Oferta” për emigrantët, kontributet që duhet të derdhni për të përfituar pension

ORNELA MANJANI

Çdo qytetar apo emigrant që dëshiron të derdhë kontribut vullnetar në Shqipëri për të marrë pension pleqërie mund të përfitojë zbritje nëse parapaguan për vitin korrent. Kështu, nëse qytetarët duan të bëjnë vitet e punës ...
Në faqen 7

FAMILJA E 31-VJEÇARIT, MESAZH POLITIKES: MJAFT ME FANTAZI E FABRIKIME

POLICIA: VETEVRITET SHOFERI I FATMIR XHAFAJT

Berisha dhe PD-ja: Është ngjarje mafioze. Reagon ministri i Brendshëm: Ishte djalë i shkëlqyer, hienat e politikës të mos sulen mbi të ndjerin



(Në foto) 31-vjeçari Shkelzen Qordja. Garda e Republikës



Në faqen 2-3

KRYETARJA E LSI

Kryemadhi: Rama dështoi, duhet pakt kombëtar për ta larguar

Në faqen 4

NEGOCIATAT

Ruçi falënderon Arbnorin dhe Metën: Pozitë-opozitë janë të dyja në provim

Në faqen 5

TAKIMI I PERVITSHEM

Majko në Paris, në mbështetje të muxhahedinëve: Irani i lirë

Në faqen 9

STUDIMI

Rreziku i pastrimit të parave nëpërmjet “call center”-ave

Në faqen 8

“BOTERORI 2018”



Mesi dhe Cristiano Ronaldo i thonë “lamtumirë” Rusisë, ja sfidat e sotme

Në faqen 12

MILOSIO Poezi nga Arian Leka, “Çufo” e Eljan Taninit, skica të Maks Velos

Zjarr dhe shi, pse jo Piramida bibliotekë?

Ide, gërmadha e socializmit mund të shndërrohet në Bibliotekë Kombëtare

Nga BEN ANDONI

Do duhej shiu i rrëmby-der në Tiranë, kushtet e vështira ku ruhen librat dhe ngushtësia e mjediseve të Bibliotekës Kombëtare, që njerëzit të kuptonin edhe njëherë emergjencën e saj. Këtë herë, drejtoresha e in-



stitucionit ka qenë disi pa doreza. Nuk kemi ambiente, kushtet janë të vështira, ishte me pak fjalë ajo që parash-troi në këto orë të vështira. Ndërkaq, nuk ka mundur t'i shpëtojë politikës dhe aku-zave ndaj saj gjendja aktuale e Bibliotekës ...

Suplement

VDEKJA E GARDISTIT REAGIMET

"Nuk kam koment për ngjarjen, po punojnë prokurorët dhe ekspertët përkatës"

Vdekja e gardistit, reagon Xhafaj: Jam i shokuar, humba një njeri të afërt

"Ishte djalë i shkëlqyer. Hienat e politikës të mos sulen mbi të ndjerin"

TIRANË

Ministri i Brendshëm, Fatmir Xhafaj ka reaguar në lidhje me vdekjen e shoferit të tij, i cili sipas policisë është vetëvrasar me armën e shërbimit brenda makinë, në garazhin e Gardës së Republikës. Xhafaj shprehu dje ngushëllimet për familjarët e 31-vjeçarit Shkëlzen Qordja, ndërsa theksoi se është i shokuar nga ngjarja, pasi ka humbur një njeri të afërt. Gjithashtu, ministri është shprehur se nuk ka asnjë koment për rrethanat e vdekjes së 31-vjeçarit, pasi sipas tij, janë prokurorët dhe ekspertët, ata që po hetojnë për zbardhjen e ngjarjes. Ndërkohë, kreu i Ministrisë së Brendshme u ka bërë apel mediave që të mos merren me akuzat politike në lidhje me vdekjen e shoferit të tij, por të respektojnë dhimbjen e familjarëve të tij.

REAGIMI I FATMIR XHAFAJT:

Jam i shokuar dhe nuk gjej fjalë të ngushëlloj prindërit dhe të gjithë familjen e Shkëlzenit për humbjen tragjike të jetës së tij. Kjo ngjarje e rëndë ka shkaktuar një dhimbje të fortë njerëzore për mua dhe për të gjithë ata që punuan dhe e njohën nga afër atë.

U prehsh në paqe, i dashur Shkëlzen! Nuk është dita sot për mua që të bëj politikë dhe as e ndaloj dot që politika të vazhdojë të merret me mua sot. Kam humbur krejt papritur një njeri të afërt, i cili si edhe gjithë familja e tij, ishte bërë si pjesë e familjes sime. Nuk kam asnjë koment për rrethanat e ndarjes së tij nga jeta, sepse prokurorët dhe ekspertët përkatës po punojnë ndërkohë për sqarimin e tyre. Nëse nuk kam se si u kërkoj hienave politike të mos sulen mbi të vdekurin, u lutem mediave që kanë sadopak ndjenjë njerëzore të respektojnë dhimbjen e prindërve, vëllezërve, të afërmeve e miqve të tij. Ai ishte një djalë i shkëlqyer, një punonjës i papërtuar e fjalëpak, që la një boshllëk të madh pas vetes dhe nuk e meriton në asnjë mënyrë përbaltjen.

Faleminderit paraprakisht, kujto që do ta konsideroj këtë apel njerëzor!



Ministri i Brendshëm,
Fatmir Xhafaj

APELI I MINISTRIT

"Nëse nuk kam se si u kërkoj hienave politike të mos sulen mbi të vdekurin, u lutem mediave që kanë sadopak ndjenjë njerëzore të respektojnë dhimbjen e prindërve, vëllezërve, të afërmeve e miqve të tij. Ai ishte një djalë i shkëlqyer, një punonjës i papërtuar e fjalëpak, që la një boshllëk të madh pas vetes dhe nuk e meriton në asnjë mënyrë përbaltjen", u shpreh dje Xhafaj.

"Garda dhe Ministria e Brendshme fshehën krimin"

Vetëvrasja e shoferit të Xhafajt, reagon PD dhe Berisha: Është vrasje mafioze

TIRANË - Pas njoftimit të policisë se dyshohet që shoferi i ministrit të Brendshëm ka bërë vetëvrasje, ka reaguar ashpër Partia Demokratike, e cila ka qenë në një linjë me ish-kryeministrin Sali Berisha. Në një deklaratë për mediat, PD u shpreh dje se ajo është një vrasje e pastër mafioze dhe se Garda dhe Ministria e Brendshme janë përpjekur për të fshehur provat. Në një status në "Facebook", Berisha shkroi dje: "Fillon qerimi i hesapeve midis familjeve mafioze të pushtetit! Ekzekutim mafioz i shoferit të familjes mafioze Xhafaj. Për të vdekurit ka vetëm ngushëllime për familjen dhe unë ngushëlloj familjen e viktimës!". Ndërkohë që në reagimin e saj, Partia Demokratike theksoi në deklaratën e saj se vetëvrasja nuk mund të bëhet me tre plumba dhe se për këtë arsye, ministri Xhafaj duhet



të japë dorëheqjen që t'u hap rrugë hetimeve.

DEKLARATA E PD:

Sot Garda e Republikës, Policia e Shtetit dhe Ministria e Brendshme fshehën ngjarjen e rëndë të ndodhur brenda Gardës së Republikës. Për dijeni të publikut, vrasja e shoferit të Fatmir Xhafajt iu bë e njohur medias dhe publikut nga Partia Demokratike menjëherë sapo ne morëm informacionin. Që prej fillimit pati përpjekje për të manipuluar këtë ngjarje, nga më të rëndat që implikon

drejtpërsëdrejti ministrin e Brendshëm, Fatmir Xhafaj. Policia private e Fatmir Xhafajt po bën çdo përpjekje që ajo të duket si një vetëvrasje me 3 plumba. Por ne jemi të bindur se ngjarja është një vrasje mafioze, ndoshta edhe më e rrezikshme sesa vrasja e shoferit të familjes së Prokurorit të Përgjithshëm, Theodorit Sollaku në mes të bulevardit në vitin 2003. Në njoftimin e vet, policia e Fatmir Xhafajt nuk jepte shpjegime sesi ka mundësi që brenda Gardës së Republikës askush nuk ka dëgjuar 3 të shtëna armë me breshëri automatiku, siç thuhet në njoftim! Kjo dhe rrethanat të tjera që po i verifikojmë tregojnë se vrasja e shoferit të Fatmir Xhafajt është e tipit mafioz, e kryer me silenciator. Me një polici që e kontrollon vetë, me një prokuror plotësisht nën urdhrat e tij, Fatmir Xhafaj duhet të japë menjëherë dorëheqjen!



Garda e
Republikës ku
ndodhi ngjarja

"PEZULLIMI"

Pak pas ngjarjes u përfol se Gardisti Shkëlzen Qordja ishte pezulluar tri ditë më parë nga detyra dhe se ai nuk e kishte dorëzuar armën e shërbimit. Në një kohë që të shumta janë pikëpyetjet pse u vetëvra mungjesin e djeshëm shoferi i ministrit të Brendshëm, Fatmir Xhafaj, zëdhënësi i kësaj ministrie, Ardi Bitia hodhi poshtë çdo dyshim për pezullimin e tij nga detyra. I kontaktuar nga gazetaria Klodiana Lala, Bitia konfirmoi se nuk ka asnjë urdhrë për pezullimin e 31-vjeçarit Shkëlzen Qordja nga detyra.


Familja e viktimës, mesazh politikës: Na lini të qajmë djalin, mjaft me fabrikime!

TIRANË - Reagimet dhe versionet e ndryshme që pasuan ngjarjen e djeshme në ambientet e Gardës së Republikës ka pasuar me reagimin e familjarëve të 31-vjeçarit Shkëlzen Qordja, që u gjet i vdekur brenda në makinë. "Është e pabesueshme për ne që në kushtet e një tragjedie familjare që nuk i urohet as hamit, të na duhet të përballojmë edhe shqelmat e politikës mbi trupin pa jetë të djalit dhe vëllait tonë, që e kemi në mes të shtëpisë! Kur s'ka fjalë dhe ngushëllim për ne sot, detyrohemi nga këto shqelma egërsirash të gjejmë fjalë për të bërë deklaratata publike si familje! Por fatqesisht nuk kemi asnjë rrugë tjetër përveçse t'u drejtohem publikisht politikëve që të na lënë të qajmë njeriun tonë. Të mos shkelin mbi çdo ligj e zakon, duke bërë atë që as gjakësi i Kanunit nuk e ka bërë kurrë për viktimën e tij. U lutem mos e rëndoni djalin e vëllain tonë me fantazi dhe fabrikime për qëllimet tuaja. Për shpirtin e zi që ju shtyn në të tilla akte çnjerëzore nuk është fajtor i shtrënjti ynë dhe zija jonë del e tepron për supet e familjes sonë të thjeshtë. Prindërit dhe vëllezërit e të ndjerit Shkëlzen Qordja. (Marrë nga gazeta "Tema").



DEKLARATA

Kur s'ka fjalë dhe ngushëllim për ne sot, detyrohemi nga këto shqelma egërsirash të gjejmë fjalë për të bërë deklaratata publike si familje!



Policia: U vetëvra me armën e shërbimit tip "MP5". Merren në pyetje kolegët e viktimës

Misteri, gjendet i vdekur me plumb në kokë shoferi i ministrit Xhafaj

31-vjeçari Shkëlzen Qordja ishte brenda në makinë, në garazhin e Gardës së Republikës

TIRANË

Një punonjës i Gardës së Republikës është gjetur i vdekur mëngjesin e djeshëm në garazhin e këtij institucioni. Bëhet fjalë për 31-vjeçarin Shkëlzen Qordja, shofer i ministrit të Brendshëm, Fatmir Xhafaj. Nga kryerja e hetimeve paraprake ka rezultuar se i riu ka gjetur vdekjen nga plumba tejpshues në kokë. Kanë qenë kolegët e tij, që e kanë gjetur të pajetë brenda në makinë. Pas ngjarjes së rëndë ka reaguar zyrtarisht Garda e Republikës. Në njoftimin për media thuhet: "Sot (dje) rreth orës 09:30 të mëngjesit, në garnizonin e Gardës së Republikës është gjetur i pajetë brenda garazhit, të caktuar për mjetet e Ministrisë së Brendshme, gardisti me detyrë funksionale shofer i ministrit të Brendshëm, shtetasi Sh.Q., 31 vjeç. Trupi i pajetë u konstatua nga punonjës të Gardës. Grupi hetimor nën drejtimin e Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Tiranë është duke punuar për të qartësuar shkaqet e ngjarjes dhe zbardhjen dhe rrethanave".



31-vjeçari Shkëlzen Qordja



GARDISTI

Burime zyrtare nga Policia e Shtetit dhe Prokuroria e Tiranës dje bënë me dije se 31-vjeçari Shkëlzen Qordja ka nisur punë në Gardën e Republikës në datën 29.03.2017 dhe nuk ka qenë asnjëherë subjekt procedimi, pezullimi apo mase tjetër disiplinore. Grupi hetimor nën drejtimin e Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Tiranë është duke punuar për të qartësuar shkaqet e ngjarjes dhe zbardhjen e rrethanave.

jetë gardisti me detyrë funksionale shofer i ministrit të Brendshëm, Shkëlzen Qordja, 31 vjeç. Menjëherë është ngritur grupi hetimor, nën drejtimin e prokurorit të Rrethit Gjyqësor Tiranë, me përbërje oficerë të Policisë Gjyqësore ekspertë mjeko-ligjorë, ekspertë të kriminalistikës dhe hetues të SHÇBA-së. Nga veprimet e para hetimore rezultuan se në mjetin e Gardës u gjet i pajetë, i ulur në sediljen e shoferit, punonjësi Shkëlzen Qordja. Makina ishte e parkuar në garazhin e caktuar për mjetet e Ministrisë së Brendshme, i cili u gjet i mbyllur nga brenda. Nga këqyrja rezultoi se në kokën e viktimës ka plagë tejpshuese të shkaktuar nga armë zjarri, me qitje me drejtim nga e djathta në të majtë. Në vendngjarje u gjetën 3 gëzhoja të qitura nga arma automatike tip "MP5", e cila ishte në dorën e djathtë të viktimës, me levën e ndërrimit të llojit të zjarrit, në pozicionin "qitje breshëri". Nga tërësia e veprimeve hetimore të kryera deri tani në vendin e ngjarjes, dyshohet se viktima është vetëvraurë me armën e shërbimit".

ARMA AUTOMATIKE

Sipas hetuesve të çështjes, në vendngjarje u gjetën 3 gëzhoja të qitura nga arma automatike tip "MP5", e cila ishte në dorën e djathtë të viktimës, me levën e ndërrimit të llojit të zjarrit, në pozicionin "qitje breshëri". Nga tërësia e veprimeve hetimore të kryera deri tani në vendin e ngjarjes dyshohet se viktima është vetëvraurë me armën e shërbimit.

Profili i gardistit Shkëlzen Qordja: Mos u mundoni të më ndryshoni

TIRANË - 31-vjeçari Shkëlzen Qordja, i cili u gjet i pajetë mëngjesin e djeshëm në garazhin e Gardës së Republikës, mësohet të ketë qenë më herët shofer i Engjëll Agaçit, sekretar i përgjithshëm i kryeministrit. Por, më vonë në vend të Shkëlzen Qordjes, shofer personal i Agaçit u vendos i vëllai, Ermal Qordja (dhe ky efektivi i Gardës), ndërsa Shkëlzeni kaloi te Ministria e Brendshme, shofer i ministrit Fatmir Xhafaj. Ngjarja ka tronditur familjarët e viktimës dhe jo vetëm. Ndërkaq, nga një kërkim në profilin e tij në "Facebook", rezultuan se Qordja ka qenë një ndjekës i futbollit dhe se ishte tifoz i Tiranës dhe Bajernit. Në statutet e 31-vjeçarit ka edhe shprehje filozofike dhe herëherë shfaqet konfuz. "Kshu jam unë, këtë pamje kam, llogjikoi si s'llogjikoi, ndje si ndjej, dashuroj si dashuroj, jam një lëmsh! Më pranoi ose largohuni... Vetëm mos u mundoni të më bëni të ndihem 'jo njeri' dhe mos u mundoni të më ndryshoni, sepse nuk ndryshoj kurrë! Vetëm e vetëm se nuk përputhem me ju!", shkruante dy vite më parë. Ndërsa në një status tjetër shkruante: "Kam mësuar se nuk kalohet jeta duke dhënë shpjegime, pasi miqtë e tu nuk kanë nevojë për to, armiqtë nuk të besojnë, ndërsa bu-dallenjtë nuk të kuptojnë".



“ HETIMI

Nga veprimet e para hetimore rezultuan se në mjetin e Gardës u gjet i pajetë, i ulur në sediljen e shoferit, punonjësi Shkëlzen Qordja. Makina ishte e parkuar në garazhin e caktuar për mjetet e Ministrisë së Brendshme, i cili u gjet i mbyllur nga brenda. Nga këqyrja rezultoi se në kokën e viktimës ka plagë tejpshuese të shkaktuar nga armë zjarri, me qitje me drejtim nga e djathta në të majtë. Mësohet se hetuesit e çështjes kanë sekuestruar kamerat e sigurisë së Gardës së Republikës, ndërsa janë marrë në pyetje edhe përgjegjësit e turnit në këtë institucion.

kur hyri Qordja brenda ambienteve të Gardës, nëse ka qenë i vetëm, i shoqëruar, me makinë, apo në këmbë. Nuk dihet saktësisht se kur ka qëlluar veten dhe pse mbante armë automatike me vete. Po ashtu, nuk bëhet me dije nëse janë dëgjuar krisma, apo arma ka qenë me silenciator. Pritet që hetimet të hedhin dritë mbi këtë ngjarje që tronditi kryeqytetin.

“ MISTERI I NGJARJES

Pavarësisht deklaratave zyrtare të Gardës së Republikës dhe të Policisë së Shtetit, ngjarja është e veshur me mister. Kjo për faktin se ende nuk dihet saktësisht se kur hyri Shkëlzen Qordja brenda ambienteve të Gardës, nëse ka qenë i vetëm, i shoqëruar, me makinë, apo në këmbë. Nuk dihet saktësisht se kur ka qëlluar veten dhe pse mbante armë automatike me vete. Po ashtu nuk bëhet me dije nëse janë dëgjuar krisma, apo arma ka qenë me silenciator. Pritet që hetimet të hedhin dritë mbi këtë ngjarje.

POLICIA

Prokuroria e Rrethit Gjyqësor Tiranë, Policia e Shtetit, SHÇBA në një deklaratë për mediat sqaruan se Shkëlzen Qordja dyshohet se është vetëvraur. Në deklaratën për mediat thuhet se: "Policia e Shtetit është njoftuar nga Garda e Republikës rreth orës 09:30 të mëngjesit se në garnizonin e Gardës është gjetur i pa-

SITUATA POLITIKE

LSI

Kryetarja e LSI-së i kërkon presidentit të mos dekretojë ligjin për godinën e teatrit

Negociatat në 2019-ën, Kryemadhi: Rama dështoi, pakt kombëtar për ta larguar

"Meta të shlyejë gabimin që solli Ramën në krye"

Kryetarja e Lëvizjes Socialiste për Integrim, Monika Kryemadhi e ka cilësuar shtyrjen e negociatave për në vitin 2019 një dështim të qeverisë Rama. Kryemadhi tha dje në një konferencë për shtyp se reforma në drejtësi e po ecën me ritme shumë të ngadaltë, edhe pse është ndër rekomandimet kryesore. "Shqipëria nuk e ka kaluar klasën dhe do duhet sërish të hapë provimet e saj, por këtë radhë me kushte shumë të vështira dhe me një bazë materiale shumë më të madhe dhe shumë më voluminoze. Shqipëria tashmë ka kushte madhore, që kërkojnë një punë voluminoze si lufta kundër krimit të organizuar, korrupsionit, drogës dhe eja me ritme sa më të shpejta për të zhvilluar pa pasur ndikim politik në procesin e vetingut. Sepse të mos harrojmë që vetëm në gjashtë muajt e fundit janë kryer vetëm 25 raste të vetingut, kur janë edhe 800 të tjera për t'u kryer. Pra, në rastin më të mirë, do të duhet që reforma në drejtësi të funksionojë pas 16 vjetëve. Pra, i bie që një nga 5 kushtet kryesore që kanë qenë në lidhje me reformën në drejtësi e shtynë jashtëzakonisht në kohë nëse ne do të ecim me këto ritme, siç kemi ecur dhe tashmë", deklaroi Kryemadhi. Në lidhje me ngritjen e institucioneve të reja të drejtësisë, Kryemadhi tha se SPAK e Byroja e Hetimit janë kushte të rëndësishme të vëna nga BE, por që nga maxhoranca ka mungesë vullneti për t'i ngritur. Sipas Kryemadhit, aksioni opozitar do të vazhdojë për të larguar Edi Ramën, i cili është shaktar i vetëm i moshapjes së negociatave për Shqipërinë. "Aksioni i opozitës është i vazhdueshëm, pasi parlamenti nuk ndonjë vlerë, në jemi thjesht të pranishëm aty. Unë theksoj se tashmë nuk është vetëm dëshira e klasës politike për të krijuar një mocion tjetër, e cila përballë qeverisë së drogës, është shumë e madhe. Djegia e mandateve nuk mendoj se është zgjidhje. Në SHBA ne kuptuam se ata kanë problemet e tyre, por një gjë e sigurt është se vëmendja e tyre për Ballkanin nuk do të ndalet asnjëherë. Nga ana tjetër, SHBA-të janë shumë të vëmendshme jo vetëm ndaj politikës, por edhe sigurisë në vend", u shpreh Kryemadhi. Sipas saj, "siguria në vend është e cenuar. Pakti kombëtar është pakt për të larguar Edi Ramën, pasi është shaktar për moshapjen e negociatave". Në lidhje me debatin për ndërtimin e godinës së re të teatrit, Monika Kryemadhi i bëri apel presidentit që të mos e dekretojë

ligjin. "Unë shpresoj që zoti Meta ka shansin për të shlyer gabimin që u solli shqiptarëve Edi Ramën në krye. Besoj që duhet të gjejë forca brenda vetes së tij të rikthejë mbrojtës të projektit. Shpresoj të distancohet, por megjithatë kjo është një zgjidhje e atij dhe mund t'i bëni pyetje vetë zotit Meta", u shpreh Kryemadhi para gazetarëve. "Pro-

jektligji i Z.Rama që ka sjellë për teatrin tregon që ëndrrat e tij në sirtar prej 20 vitesh vazhdojnë të jenë akoma, por ngelen përsëri ëndrra të grabitjes së pronës publike, ashtu siç ka bërë dhe kur ishte kryetar bashki. Kërkon përsëri të grabitë një pronë, të cilën në qoftë se e mbani mend dikur e quante pronë që mbante dhe publikonte të brendsh-

met e Violeta Manushit. Sot është kthyer në një godinë me radioaktivitet për shqiptarët. Është gjithmonë qesharak për hir të së vërtetës dhe tregon dhe nivelin e lartë të amatoresk të tij. Por ajo që dua të them është që ky projektligj nuk do të ketë shanse për të kaluar, pavarësisht se numrin e votave ai e ka", tha kryetarja e LSI-së.

Godina e teatrit, përplasen sërish maxhoranca e opozita

Vokshi: Do të ngrihen 6 kulla. Balla: Eja provoje në gjykatë

PD dhe PS u përplasën sërish dje për godinën e Teatrit të ri Kombëtar. Në një deklaratë për mediat, deputetja e Partisë Demokratike, Albana Vokshi ka publikuar akuzat e tyre për skemën e grabitjes së territorit të Teatrit Kombëtar. Sipas Vokshit, Rama dhe Veliaj po e përdorin teatrin për të pastruar paratë e krimit dhe të drogës. Akuzat e Vokshit thonë se është mbajtur e fshehtë ndërtimi i kullave në qendrën historike të kryeqytetit. "Edi Rama dhe Erion Veliaj e kanë mbajtur të fshehtë deri më sot projektin e kompanisë së tyre private, që do të shkatërrojë Teatrin Kombëtar dhe do të ndërtojë 6 kulla në qendrën historike të kryeqytetit. Kryeministri dhe

kryebashkiaku gënjehjnë publikisht, kur thonë se territorin i teatrit nuk do të preket asnjë centimetër", tha Vokshi, sipas të cilës në territorin e teatrit do të ngrihen 3 kulla. Pas kësaj deklarate të Vokshit, reagoi kreu i grupit parlamentar të PS-së, Taulant Balla. Balla tha se ashtu si Basha, edhe Vokshi do të paditet në gjykatë për shpifje. "Duke qenë se sot Lulzim Basha zgjodhi ta hedhë balten e shpifjeve përmes deputetes Albana Vokshi, megjë në fundjavë ai zakonisht

viziton Holandën, nuk mbetet gjë tjetër përveçse ta bashkojmë deputeten me kryetarin e saj në rrugën drejt gjykatës me një paditë radhës. Zonja Vokshi, ashtu si Lulzim Basha, do të jetë e ftuar të provojë në gjyq se shpifjet e saj nuk janë të pabazuara. Kjo çmenduri balte e përkallëzuar pasi Shqipëria mori datën për çeljen e negociatave, ka zhvlerësuar çdo mijë tjetër regjimi ndaj këtyre esadistëve të rinj të Shqipërisë", u shpreh Balla.



Gjatë një seance parlamentare



Kryetarja e Lëvizjes Socialiste për Integrim, Monika Kryemadhi

LARGIMI I DEPUTETIT
Kryetarja e LSI-së ka shprehur habi për largimin e deputetit Robert Bitri nga grupi i LSI-së. Por ajo tha dje: "Do të jetë ai që do të përballlet me votuesit e LSI në Fier, nuk do të përballlemi me. Por mendoj që të realizojë qëllimet e tij financiare dhe ekonomike, nëse e ka bërë këtë gjë".

Bylykbashi: Rama e Ruçi po pengojnë arrestimin e "peshqve të mëdhenj"

Deputeti i Partisë Demokratike, Oerd Bylykbashi akuzoi dje kryeministrin Rama e kreun e Kuvendit, Gramoz Ruçi se me ndryshimet në rregulloren e Kuvendit u japin imunitet ministrave të tyre të korruptuar. Në një deklaratë për media, Bylykbashi tha: "Gramoz Ruçi po sjell në parlament me kërkesë të Edi Ramës për miratim për të enjten që vjen të një vendimi, i cili rasti Tahir e kthen në rregull. Mbrojtjen me vendim të parlamentit, me imunitet nga parlamenti nga arrestimi dhe ndjekja penale e Saimir Tahirit sot duan ta kthejnë në rregull për të mbrojtur ministrat e korruptuar. Kërkoi të kthehet në gjykatë që të jetë parlamenti që do çmojë nëse ka prova për të hequr imunitetin, për të arrestuar, për të bërë kontroll apo kërkim në banesat e ministrave". Bylykbashi tha se, "Edi Rama dhe Gramoz Ruçi duke u dhënë imunitetet dhe mbrojtje deputetëve të kriminelëve, imunitet parlamentar, duke kthyer parlamentin në gjykatë rrezojnë reformën në drejtësi". Sipas tij, Bashkimi Europian kërkon arrestimin e "peshqve të mëdhenj", por pikërisht këtë e pengon Rama.

Vasili: E ardhmja e vendit në rrezik, të reflektojmë sot

Kryetari i grupit parlamentar të LSI-së, Petrit Vasili u shpreh dje se Shqipëria po përballlet sot me destruktivitetin institucional më të rëndë dhe më të rrezikshëm të saj gjatë gjithë pluralizmit. "Dekapitimi i sistemit të drejtësisë, pa Gjykatë Kushtetuese, pa gjykatë të lartë dhe pa ngritjen e qeverisjes së gjyqësorit pa KLGJ, pa KLE, pa Inspektorin e Lartë të Drejtësisë dhe pa KED. Kaosi ekonomik është shkatërrimtar, sepse nuk ka model ekonomik se ku shkon vendi, sepse koncesionet dhe pastrimi i parase kanë zaptuar ekonominë, sepse borxhi publik është tërësisht jashtë kontrollit", u shpreh Vasili. Për të, "dialogu politik është zëvendësuar nga qeveria me mekanizmin e shtitlerjes së votave qoftë në zgjedhje, qoftë pas tyre". Sipas Vasilit, "trafiqet dhe krimi i organizuar janë sot ato që mbajnë peng integrimin europian". "E sotmja dhe e ardhmja e vendit janë më të rrezikuara dhe më të tronditura se kurrë më parë. Ku shkojmë?" ai kërkoi që të reflektohet sot, përballë kësaj gjendjeje, pasi nesër do të jetë vonë.

NJOFTIM ANKANDI
Përmbarues gjyqësor privat Artan Sima zhvillon ankandend sipas datave të mëposhtme: **Datë 03/07/2018, ditën e Mërkurë, ora 16:00**, përfundon ankandend i (i parë), për shpijen e pasurive të paluajtshme të llojit:
"Apartament" me sipërfaqe prej 53.92 m², Rr" Ahmet Bekdash" pl.59 shk.1, k.z.p.6, në Kollonjë, në vlerën 1.600.000 lekë.
Pasuria është lenë në garanci bankare për shlyerje kredie sipas kontrates për venien e sendit në hipoteke të debitorit: Z.Bashkim Irimi Selaj banues në Korçë, për detyrimin ndaj kreditorit z.Ahmed Selim Xhambazi banues në Korçë.
Ankandend zhvillohet pranë zyrës së përmbaruesit me seli lagjen nr.3, Rruga "Avni Rustemi", nr.31 k.1, Korçë. Kontakt Cel.0674044666, e-mail. simaartan@yahoo.com

NJOFTIM ANKANDI
Përmbarues gjyqësor privat Artan Sima zhvillon ankandend sipas datave të mëposhtme: **Datë 04/07/2018, ditën e Mërkurë, ora 16:00**, përfundon ankandend i (i parë), për shpijen e pasurive të paluajtshme të llojit:
"Apartament" me sipërfaqe prej 82 m², e ndodhur në Korçë, në vlerën 2.099.200 lekë.
Pasuria është lenë në garanci bankare për shlyerje kredie sipas kontrates për venien e sendit në hipoteke të debitorit: Z.Bashkim Irimi Selaj banues në Korçë, për detyrimin ndaj kreditorit z.Ahmed Selim Xhambazi banues në Korçë.
Ankandend zhvillohet pranë zyrës së përmbaruesit me seli lagjen nr.3, Rruga "Avni Rustemi", nr.31 k.1, Korçë. Kontakt Cel.0674044666, e-mail. simaartan@yahoo.com



Vendimi i BE, kryetari i Kuvendit falënderon paraardhësit nga Arbnori te Meta

Negociatat, Ruçi: Deri në qershor 2019 jemi në testim, si qeveria, edhe opozita

"Do të plotësojmë paketën e 27 ligjeve të reformës në drejtësi"

Darina Tanushi

Kryetari i Kuvendit, Gramoz Ruçi për shëndeti dhe vendimin e vendeve të Bashkimit Evropian për hapjen e negociatave me Shqipërinë në qershor 2019, por nga ana tjetër shtoi se kjo nuk është festë për qeverinë. "Në testim është si qeveria, ashtu edhe opozita. Prandaj ne duhet të sillemi si palë e denjë negociatore. Vendimi për hapjen e negociatave në qershor të vitit 2019 është një arritje dhe meritë e të gjithëve", tha dje, Ruçi në një bashkëbisedim me gazetarët në kryesinë e Kuvendit. Sipas Ruçit, Këshilli e mori këtë vendim sepse disa vende anëtare si Gjermania kanë detyrimin ligjor të marrin edhe opinionin e parlamenteve kombëtare për çështjen e zgjerimit dhe hapjen e negociatave, ndërkohë që një procedurë e tillë është ndjekur edhe për Malin e Zi e Serbinë. "Lexuar në mënyrë realiste dhe neutrale, vendimi për të hapur negociatat në qershor të vitit 2019 është një arritje për Shqipërinë. Të kesh një datë konkrete për hapjen e negociatave dhe të fillosh procesin përgatitor për hapjen e tyre, është arritja më e rëndësishme në rrugën tonë drejt Europës. Kur të gjitha emocionet do të fashiten, kur të gjitha akuzat në emër të luftës politike do të ftohen, kur do të çlirohemi nga dallitë tona, ajo që do të mbetet është data e negociatave, që shkëlqen në kalendarin evropian, qershor 2019. Tashmë nuk kemi thjesht një ambicie e proces, por një kalendar të detajuar të bashkëpunimit me Bashkimin Evropian dhe hapave të ndërmjetëm deri në qershor 2019", u shpreh Ruçi. "Negociatat janë të garantuara kur ne shqiptarët sillemi si palë e denjë negociatore. Deri në qershor 2019 jemi në testim të gjithë, si qeveria, edhe opozita. Nuk do të



Kryetari i Kuvendit, Gramoz Ruçi

gjitha qeverive dhe opozitave, partive politike, udhëheqësve të tyre, grupeve parlamentare dhe të gjithë deputetëve që kanë kontribuar në realizimin e aspiratës europiane të Shqipërisë gjatë tri dekadave të fundit", tha Ruçi. Kreu i Kuvendit tha se "deri në qershor 2019 Kuvendi do të ndër marrë një ofensivë të diplomacisë parlamentare me vendet anëtare për të bërë të mundur që arrijtjet e Shqipërisë të njihen me realizim e në detaje". Ndërsa puna e tij do të përqendrohet në realizimin me sukses të objektivave të fazës së tretë të procesit të reformës në drejtësi, miratimi i 8 projektligjeve, pjesë e paketës së 27 projektligjeve të reformës në drejtësi si dhe 3 projektligjeve të tjera që janë tërhequr nga deputetët propozues. Me miratimin e tyre do të përmbillet paketa e plotë e 27 projektligjeve të reformës në drejtësi. Një tjetër sfidë e Kuvendit është reforma zgjedhore si dhe plotësimi i vakancave në strukturat e reja të sistemit të drejtësisë. Ruçi theksoi edhe forcimin e dialogut politik me opozitën si një nga sfidat e Kuvendit.

OPOZITA

"Për sa u përket kërkesave të opozitës, mua nuk më shqetëson fare, pasi ka një rregull në demokraci që çdo opozitë dhe çdo forcë politike që del në opozitë, që ditën që lë pushtetin, bën dhe fillon përgatitjet për të marrë pushtetin, se prandaj janë krijuar partitë politike. Dhe kërkesat janë të natyrshme që nga ajo për zgjedhje të parakohshme deri tek mocionet e mosbesimit për qeverisjen në tërësi apo të ministrave në veçanti", tha dje Ruçi.

MAGJISTRATËT E RINJ

Kreu i Kuvendit bëri të qartë dje se grupet parlamentare po negociojnë për projektligjin për shkollën e magistraturës, i cili ka gëzuar. "Unë do ta inkurajoj këtë bashkëpunim dhe nuk do të kërkoja thjesht numrat për të miratuar këtë ligj, por do të kërkoja dhe do të inkurajoja një konsensus të gjitha forcave politike parlamentare që ta miratojnë një orë dhe më parë këtë ndryshim për shkollën e magistraturës".

TEATRI

Kreu i Kuvendit, Ruçi tha dje se kërkesa për të ngritur një godinë të re teatri ka qenë që në kohën e monizmit, por sipas tij ka qenë edhe ide e Sali Berishës. "Ideja ka qenë shumë e mirë, ndoshta tani u krijuan mundësitë apo u gjetën mekanizmat, që edhe kjo ide për ta përhëndetur e z. Berisha bëhet realitet nga kryeministri pasardhës, z. Rama dhe kjo është normale", u shpreh Ruçi.

dëshiroja që në këtë ditë të shënuar, që do të mbetet në kujtesën kolektive të shqiptarëve të kritikojë opozitën e vendit tim", tha kreu i Kuvendit, ndërkohë që falënderoi kryetarët e parlamentit ndër vite, që

nga Kastrioti Islami, Pjetër Arbnori, Skënder Gjinushi, Namik Dokle, Servet Pëllumbi, Jozefina Topalli dhe Ilir Meta. "Ky vendim nuk është sukses vetëm i qeverisë, as i shumicës qeverisëse. Kjo arritje është meritë e të

Në përgjigje të pyetjeve të gazetarëve, Ruçi bëri të qartë se, "lupa në përpjekjet tona integresive nuk ka për të na u ndarë deri në momentin e fundit, si ne, por edhe të gjitha vendeve që aspirojnë aderimin në BE. Në raportin e Komisionit Evropian, apo në konkluzionet e BE-së së ditëve të fundit, sigurisht që nuk ka kushte, por ne duhet të jemi të qartë që edhe kur të hapen negociatat, në qoftë se unë përmenda një shifër në rastin e Kroacisë, 684 ligje, të gjitha ato përbejnë kushte, të cilat ne që aspirojmë për t'u integruar në BE, duhet të njohim legjislacionin dhe ky legjislacion të jetë i implementueshëm dhe i zbatueshëm në vendet aspirante. Kështu që, unë jam i përgatitur, që kjo lupë e BE-së do të jetë akoma më e fuqishme".

Kryeministri, në Voskopojë për projektin e '100 fshatrave'

Rama: Mbështetje për agroturizmin dhe bujtinat, emigrantët të investojnë

Kryeministri Rama ishte dje në Voskopojë për të folur me ekspertë të fushës për të zhvilluar projektin e 100 fshatrave turistike. Një grup pune i përbërë prej arkitektësh dhe pedagogë të Universitetit të Buqësisë do të punojnë për projektin, me qëllim zhvillimin e potencialëve ekonomike dhe turistike të fshatrave. Kryeministri Edi Rama u drejtua një thirrje emigrantëve, që të ardhurat e 20 viteve punë t'i investojnë në shtëpitë e prindërve apo gjyshërve të tyre, në kuadër të projektit "100 fshatrat" që përfshin "Rilindja Rurale". "Është e padiskutueshme që këto investime do të mund të kthejnë mbrapsht fitim shumë më tepër sesa çfarë mund të fitohet sot në Greqi apo Itali", deklaroi kreu i qeverisë. Kryeministri veçoi Voskopojën me histori qytetërimi dhe shenjtësi, sot një fshat i bukur turistik, edhe pse ende vështirësisht i arritshëm, siç tha Rama. "Një fshat që është quajtur 'Sikstina e Lindjes' me 7 kisha të mrekullueshme dhe me kuroren e Shën Prodhonit, kur nuk ka javë që të mos vijnë turistë të huaj. Produktet e 100 fshatrave do të promovohen në një rrjet dyqanesh 'Made in Albania'. Dhe në këtë kuadër, Voskopoja ka të paktën tri produkte që i çon në këtë vitrinë nga tryeza e saj, mishin, bulmetin dhe petkat", tha Rama. Kryeministri ritheksol edhe një herë thirrjen për aplikime nga ata që duan t'i kthejnë shtëpitë e tyre në bujtina apo kush do të ndërtojë hotele në këto zona. Qeveria parashikon që të ngrihet vala e parë e një zhvillimi të strukturuar rural.

Spartak Braho pëson atak kardiak, shtrohet në spital

Deputeti i Partisë Socialiste, Spartak Braho ka kaluar në parainfarkt. Gjatë ditës së premte mësohet deputeti ka pasur dhimbje gjoksi, shtrëngim dhe probleme me frymëmarrjen. Pasi është vizituar nga mjekët në spitalin e Durrësit, ai është dërguar në Tiranë ku i është nënshtruar vizitës nga mjekët kardiologë. Mjekët kanë konstatuar se Braho ka pësuar parainfarkt. Deputeti Braho ndodhet i shtruar në një spital privat në Tiranë, ku po kurohet për ndihmë mjekësore të nevojshme. Kur deputeti Braho ka shprehur shqetësim lidhur me gjendjen e tij shëndetësore, familjarët dhe të afërmit kanë insistuar për kontroll mjekësor të menjëhershëm, por Braho është shprehur se mund të ishte diçka kalimtare dhe jo problematike. Ka qenë insistimi i të afërmeve që parainfarkti u kap shpejt, pasi pasojat do të ishin të rënda.

REPUBLIKA E SHQIPËRIE
Zyra përbarimorë "Best 2010"

SHPALLJE ANKANDI

Më datë 16 korrik 2018 nga ora 08.00-ora.16.00 tek kjo zyre përbarimorë do zhvillohet ankand për shpëtim e pasuritë nr.5856, vol 17, fq 3 të ndodhur në L.13, ZK 8518, Plazh, Durrës. Truallit që ka sipërfaqen prej 600 m² kullizohet sipas një marrëveshje sipërmarrje.
Prona është e vëllëzërve, z.Arben e z. Shkëlqim Riza Brameta
Çmimi fillestar me të cilin hapet ankandi do të jetë 570020 Euro.
Çmimi mund të llogaritet edhe në lek sipas kursit të këmbimit ditor.
Oftentimes duhet të kenë depozituar në llogarinë e zyrës përbarimorë 10% të çmimit fillestar.
Adresa: L. 2, prapa Prokurorisë së Rrethit Durrës. Tel/Fax: 052-22-6000
E-mail: best.2010@perbarues.al, web: www.perbarues.al

REPUBLIKA E SHQIPËRIE
Zyra përbarimorë "Best 2010"

SHPALLJE ANKANDI

Më datë 3 korrik 2018 nga ora 08.00-ora.16.00 tek kjo zyre përbarimorë do zhvillohet ankand për shpëtim e pasuritë së shqiptarë "Kontrolli shtet".
Aparamenti/zyra që do të shpëtimohet në ZK 8310, Rr"Delian Hoxha", Tiranë (kafë 7 ndërtesë, më zyra e Bankës NBB).
Prona është e debitorit e nuk rëndohet nga asnjë detyrim tjetër civil.
Çmimi fillestar me të cilin hapet ankandi është 11.772.000 lekë.
Çmimi llogaritet edhe në euro sipas kursit të këmbimit ditor.
P.s: Çytlarët/sbjektet që dëshirojnë të marrin pjesë në ankand duhet të kenë depozituar dhe: 10% të çmimit fillestar si garanci për pjesëmarrje në ankand. Kjo garanci pasurore duhet të jetë e dorëzuar në BKT, nr.103agatës Samir Hoxha PF (IBAN: AL07 2051 2046 4204 RBLI PRICALLA)
Adresa: L. 2, prapa Prokurorisë së Rrethit Durrës. Tel/Fax: 052-22-6000
E-mail: best.2010@perbarues.al, web: www.perbarues.al

Ish-presidenti: Vendet e BE refuzuan për të dytën herë negociatat me Shqipërinë

Nishani: Shqiptarët të mblidhen e të çlirojnë rrugën drejt Evropës

"Gënjeshtria, puna përgatitore nisi që në 1 prill 2009"

Ish-Presidenti i Republikës, Bujar Nishani deklaroi dje se fakti që nuk u hapën negociatat me Bashkimin Evropian tregon se BE ka vlerësimit negativ për qeverinë shqiptare. Përmes një postimi në rrjetin social, "Facebook", Nishani u shpreh se vendet anëtare të BE refuzuan për të dytën herë propozimin e komisionit për hapjen e negociatave (bisedimeve) për anëtarësim në BE të Shqipërisë. "Ashtu siç bënë ekzaktësisht në 2016 kur përshëndetën arritjet e Shqipërisë (korrektësi diplomatike e politike), deklaruaran mot-a-mot dhe tashmë se pa luftuar krimin e organizuar, korrupsionin, vendosur shtetin ligjor, zgjedhje të lira e të ndershme, nuk hapim negociatat. Qeveria dhe shërbëuesit e saj të paguar u turru në gënjeshtëri pa turp si në çdo skandal të këtyre pesë viteve", u shpreh ish-presidenti. "Do të ishte krejt pa vlerë dhe irracionale që opozita dhe shqiptarët e ndershëm të merrshin dhe harxhonin energji dhe kohë për të përgënjeshtuar gënjeshtarit. Gënjeshtari nuk përgënjeshtrohet, por veç diskutohet. Tashmë ndër ne, gënjeshtarët nuk e hanë më turpin me bukë, por e gëlltisnin me hare e çakërreqj duke pirë kupa me verë të shtrëngtë", vijoi Nishani. Realiteti, sipas tij, është fare i thjeshtë: "Evropa i dha ca

VENDIMI I KËSHILLIT
"Këshilli rikujton që vendimi për të hapur negociatat me Shqipërinë do të jetë subjekt i përfundimit të procedurave parlamentare dhe miratimit nga Këshilli Evropian dhe do të pasohet pas kësaj nga konferenca e parë ndërqeveritare deri në fund të vitit 2019, në varësi të progresit të bërë", theksoi këshilli më datë 26 qershor.

KRYEMINISTRI
"Vendosja më në fund e datës, në 12 muaj nga sot, si dhe drita jeshile për të nisur përgatitjet për negociatat me Komisionin Evropian është absolutisht një zgjidhje optimale kompromisi, e cila e blinda përfundimisht perspektivën e anëtarësimit të Shqipërisë jo me fjalë të përgjithshme, sado të bukura për progresin, por me një kalendar të miratuar nga Këshilli Evropian", tha Rama për vendimin e BE.

detyra shtesë Shqipërisë për t'i bërë deri në vitin e ardhshëm, kur do të shqyrtojedhe ndërherë propozimin e Komisionit, nëse këto detyra janë përmbyshur apo jo nga Shqipëria. Zor shumë do të jetë të përmbyshen këto detyra, sepse është pikërisht ajo që ka përgjegjësinë kryesore, qeveria që e pengon Shqipërinë t'i përmbyshë këto detyra". Sipas Nishanit, ky vendim i BE-së ka në fakt dy lajme, një të keq dhe një të mirë. "Lajmi i keq është shqyrtja e shqyrtimit të vendimit nëse Shqipëria do hapë negociatat pas 2019-ës. Lajmi i

perversitet kur thonë se u vendos të nisim 'punën përgatitore'! Puna përgatitore ka nisur që me miratimin e Marrëveshjes së Stabilizimit Asocimit, qysh më 1 prill 2009, o mashtrues, boll u tallët me shqiptarët", sqaroi ish-presidenti. Sipas tij, negociatat nuk u bllokuan nga vendet skeptike, por nga zullumet e modeli i një pushteti të korruptuar dhe inkriminuar në Shqipëri. "Nuk janë skeptikët evropianë, por familjet mafioze që nuk preken dot nga kjo qeveri. Ndaj kësaj qeverie i është vënë kushti që t'i godasë ato. Ajo nuk e bën dot! Janë grupet e organizuara kriminale që blejnë vota për qeverinë dhe qeveria që u dorëzom më pas atyre Policinë e Shtetit dhe paratë e buxhetit. Ndaj, kësaj qeverie i është vënë kushti i ri t'i demontojë ato. Ajo nuk e bën dot", u shpreh më tej ish-presidenti. Sipas Nishanit, kjo qeveri "është me shpatulla për muri për të dënuar korrupsionin qeveritar dhe atë të oligarkëve të saj. Jo, nuk e bën dot!". Sipas ish-presidentit, "shqiptarët duhet të mblidhen e të vendosin se si ta çlirojnë rrugën e tyre drejt Evropës që zullumçarët ia janë bllokuar. Unë besoj se shqiptarët e ndershëm do të mblidhen pareshtrull sallave e kuvendeve në çdo qytet e komunë të vendit për t'i diskutuar gënjeshtarët dhe për të vendosur se si të bëjnë realitet vullnetin dhe qëllimin e tyre. E duam Shqipërinë në Evropë!".



Ish-Presidenti i Republikës, Bujar Nishani

Drejtori i BE në Ministrinë e Jashtme: Tashmë nis faza e vlerësimit të ligjeve

Mënjëherë pas vendimit për çeljen e negociatave për anëtarësim të Shqipërisë qershorin e vitit 2019, nis faza përgatitore, ajo që mund të konsiderohet si prioritarë mbi diskutimet në tavolinën e punës. Drejtori në Drejtorinë për BE-në në Ministrinë e Jashtme dhe Europën e Punët e Jashtme, Sokol Dedja, tha dje në një intervistë për "Vizion Plus" se fokusi do të jetë përafërimi i legjislacionit shqiptar me atë të BE-së, që ka nisur me hyrjen në fuqi të Marrëveshjes së Stabilizimit-Asocimit në vitin 2009. "Në përfundim të këtij procesi, që quhet 'screening' në gjuhën teknike, analizimit të legjislacionit tonë, për të parë shkallën e përputhjes me legjislacionin e BE, komisioni për çdo kapitull të legjislacionit të BE përgatit një vlerësim, një raport mbi shkallën e përafërimit që vendi ka arritur dhe mbi bazën e këtij raporti, ose vendos detyra për hapjen e secilit kapitull, ose thjesht në rast se shkalla e përafërimit është e avancuar, thjesht vendos hapjen e negociatave për atë kapitull", u shpreh Dedja. Për Dedjen, këto nuk janë detyra të reja, por vijim i plotësimit të 5 prioritetëve kyçe. Vëmendje e veçantë do t'i kushtohet sundimit të ligjit dhe luftës kundër krimit dhe korrupsionit.



Deputetja e PD-së: Duhet ndëshkim brenda vetë qeverisë

Negociatat, Duma: Nuk u hapën për shkak të krimit dhe drogës

Deputetja e Partisë Demokratike, Grida Duma, e ftuar në emisionin "Kjo Javë" të gazetares Nisida Tufta në "News 24", foli për dështimin e hapjes së negociatave me BE-së. Ajo u shpreh se janë pikërisht skandalet e kësaj qeverie, që e bënë të mundur këtë, edhe pse nga kryeministri Rama paraqitet si fitore. Sipas Dumës, shqyrtja me një vit e një përgjigjeje nga BE-ja do të thotë që do të jemi sërish në të njëjtën situatë, madje Bashkimi Evropian do të 3-fishojë monitorimin. Përsa i përket trafikut të drogës e krimit, deputetja e PD tha se evropianët e kanë parë të keqen e shqiptarëve në shtëpinë e tyre. "Ne e quajmë mbyllje negociatash se në dokumentet e reja rezulton

si regres. Ne kemi një dokument të ri që nuk lidhet me me 5 kërkesat, por thotë që të funksionojnë institucionet. Ka thënë që Shqipëria ka korrupsionin e sidomos në polici, ka probleme me trafikun me drogën dhe probleme me vetingun. Ne në kushtet që kemi marrë nga BE, jemi si një vend që nuk e kishte hapur fare marrëveshjen e stabilizim-asocimit, ndërkohë që ne e kemi hapur në 2006-

ZYRA PËRMBARIMORE PRIVATE ENIRJETA ZISI
Permbarese gjyqesore private Enirjeta Zisi zhvillon ankandin për shitjen e pasurisë së paluajshme "Apartamenti" me sipërfaqe 92.1m2, ZK.3866, Nr.Pasurie.300/143+1-7, Vol.83,Fq.186,Indeksi I Hartes K-34-100, të ndodhur në Tiranë, Yzberisht pranë rruges "Joklin Persi", kati 13, shk.1 ap.7 Tiranë, për shlyerjen e detyrimit në favor të kreditorit Yzeiri Llanaj.
Çmimi i me të cilin shpallet ankandi është në shumën 3.010.352 (tre mijë e dhjetë mijë e tetëqind e nëntëqind e dy) lekë.
Ankandi zhvillohet në datë 04.07.2018, ora 16.00 në zyrën e Permbareueses gjyqesore private Enirjeta Zisi, Bulevardi "Gjergj Fishta", Pallati "Gora" Kulla.2,Kati 1, 2, Tiranë Nr.Tel. 0694799000, email:enirjeta.zisi@gmail.com

REPUBLIKA E SHQIPERISE
BANKA E SHQIPERISE
DEPARTAMENTI I ADMINISTRIMIT
SEKTORI I PROKURIMIT

TENDER I HAPUR KOMBËTAR

Banka e Shqipërisë kërkon të realizojë objektin e prokurimit: **"Blerje uniforme e veshje pune për punonjësit e Bankës së Shqipërisë"**

"Banka e Shqipërisë fton kandidatët e interesuar, të marrin pjesë në procedurën e prokurimit "Tender i hapur kombëtar", për realizimin e objektit të prokurimit si më sipër, **me fond limit 2.457.000 Lekë**".

Dokumentet e tenderit mund të tërhiqen pranë Sektorit të Prokurimeve të Departamentit të Administrimit, të Bankës së Shqipërisë, me adresë: Rruga e Dibrës, Kompleksi "Halili", Kulla A, Tiranë, Tel. 042419411(ext. 4251), çdo ditë nga ora 10.00 – 13.00 nga çdo person i autorizuar, me paraqitjen e një kërkesë me shkrim. Tërheqja e dokumenteve mund të bëhet vetëm pasi të keni bërë paraprakisht pagesën e paktyshme prej 500 Lekë, pranë një banke tregtare në llogarinë e Bankës së Shqipërisë sipas detajeve të mëposhtme:

Përfutuesi: Banka e Shqipërisë
BIC: STANALTR
IBAN: AL68 1011 1008 0000 0000 2222 222L; BIC

Përshkrimi: Blerje dokumente tenderi për tenderin me objekt: **"Blerje uniforme e veshje pune për punonjësit e Bankës së Shqipërisë"**

Oferta duhet të paraqitet në zyrën e Sektorit të Prokurimeve, pranë Departamentit të Administrimit, në Bankën e Shqipërisë, deri më datë **31 Korrik 2018, ora 11:00**, kohë në të cilën do të hapet edhe tenderi, ku ftohen të marrin pjesë kandidatët ose përfaqësuesit e autorizuar të tyre.

Kontributet vullnetare, sa përfitoni nëse parapaguani për vitin korrent

ISSH: Si të merrni pension pleqërie kur s'keni punuar

Pagesa për vitin 2018, përfitoni zbritje 6 për qind mbi shumën

Ornela Manjani

Cdo qytetar apo emigrant që dëshiron të derdhë kontribut vullnetar në Shqipëri për të marrë pension pleqërie mund të përfitojë zbritje nëse parapaguan për vitin korrent. Kështu, nëse qytetarët duan të blejnë vitet e punës për periudha kur nuk kanë qenë në punë, pagesa është standard në 5184 lekë. Por nëse parapaguajnë në fillim të periudhave për vitin 2018, pagesa ka zbritje të ndjeshme. Kështu, nëse parapaguhet i gjithë viti, zbritja është 6 për qind mbi shumën. Nëse parapaguhet 6 muaj, zbritja është 3 për qind mbi shumën totale dhe nëse parapaguhet 3 muaj, qytetarët përfitojnë 1.5 për qind zbritje. Për të përfituar pension pleqërie, qytetarët duhet të sigurojnë minimalisht 15 vite pune dhe në këtë rast përfitojnë pension të pjesshëm. Ndërsa me 36 vite e 4 muaj sigurim përfitojnë pension të plotë pleqërie. Me reformën e re në pensione sa më shumë kontribute të derdhësh, aq më i lartë është edhe përfitimi. Çdo qytetar ka të drejtë të përfshihet në skemë dhe të derdhë kontributet për vitet e kaluara edhe pa qenë të siguruar më parë.

PËRFITUESIT

Shtetasit shqiptarë që kanë mbushur moshën 18 vjeç dhe që nuk u ka lindur e drejta për ndonjë përfitim nga skema e sistemit të detyruar. Shtetasit shqiptarë meshkuj për periudhë e studimeve universitare, pasi periudha e studimeve pasuniversitare është me pagesë. Shtetasit shqiptarë që kanë periudha të pambuluara nga sistemi i sigurimit të detyrueshëm dhe dëshirojnë t'i plotësojnë ato nëpërmjet sigurimit vullnetar. Personat që kanë lënë shtetësinë shqiptare mund të bëjnë sigurim vullnetar për mbulimin e periudhave të kaluara nga data 01.01.1994 deri në datën që kanë lënë shtetësinë. Sa është masa e kontributit për sigurim vullnetar për periudhat e kaluara? 1. Masa e kontributit që duhet të paguhet për sigurim vullnetar nga personi i interesuar për mbulimin e periudhave të kaluara përcaktohet nga koha kur bëhet pagesa (aplikohet masa që është në fuqi



Kontributi për sigurim vullnetar

Masa e kontributit që duhet të paguhet për sigurimin vullnetar nga personi i interesuar është e barabartë me masën që paguhet për degën e pensioneve, sipas pagës për efekt kontributësh të miratuar në periudhën kur bëhet pagesa. Pagesa aktuale për një muaj sigurim vullnetar është 5 184 lekë, që i korrespondon pagës minimale mujore: 24 000 lekë x 21.6%. Për pagesat paradhënie aplikohen zbritje në Instituti i Sigurimeve Shoqërore në varësi të kohës kur kryhet pagesa. Kështu, nëse do të parapaguani për vitin në vijim në fillim të periudhave, do të ketë



zbritje: - 6% mbi shumën për një pagesë vjetore (me kusht që pagesat të realizohen brenda muajit janar); - 3% mbi shumën për një pagesë 6-mujore (me kusht që pagesat të realizohen përpara

fillimit të periudhës 6-mujore, që do të mbulohet me sigurim vullnetar); - 1.5% mbi shumën për një pagesë 3 mujore (me kusht që pagesat të realizohen përpara fillimit të periudhës 3-mujore, që do të mbulohet me sigurim vullnetar). Por pagesat e vitit korrent mund të bëhen edhe me shumëfishin e kuotës minimale mujore, 5 184 lekë, deri në kufijtë e pagës maksimale. Përfitimet nga sigurimi vullnetar për vitin korrent: - pensione minimale pleqërie, invaliditeti dhe familjar; - pensione më të larta se niveli minimal, sipas logaritjeve mbi shumëfishin e pagave të paguara.

në momentin e kryerjes së pagesës, masë e cila miratohet me VKM, për degën e pensioneve). 2. Pagesa aktuale për të mbuluar periudha të kaluara bëhet vetëm në kuotën minimale

dhe është 5 184 lekë për një muaj sigurim vullnetar. Kjo kuotë i korrespondon pagës minimale mujore: 24 000 x 21.6%. Në këto pagesa nuk aplikohen zbritje. Përfitimet nga sigurimi vull-

netar për periudhat e kaluara: - Vjetërsi pune, e cila influencon në plotësimin e kushteve për të përfituar një pension. - Pension pleqërie, invaliditeti dhe familjar, në nivel minimal.

SIGURIMI VULLNETAR PËR VITIN KORRENT

Sigurim vullnetar për vitin korrent mund të paguajnë të gjithë shtetasit shqiptarë që:

- Kanë mbushur moshën 18 vjeç deri në arritjen e moshës për pension.
- Nuk mund të sigurohen në sistemin e sigurimit të detyrueshëm.
- Nuk mund të sigurohen në sistemin e të vetëpunësuarve në bujqësi.
- Nuk u ka lindur e drejta për ndonjë përfitim nga skema e sistemit të detyruar.

BOXHET E PRAPAMBETURA

Të pashlyera, vendimet e gjykatave për pronat dhe largimet nga puna

Rrëth 867.4 milionë lekë është vlera e detyrimeve të prapambetura të krijuara nga institucionet shtetërore në 3-mujorin e parë të vitit. Të dhënat raportohen nga Ministria e Ekonomisë dhe Financave, sipas deklarimeve të ministrive, ndërkohë që së bashku me detyrimet e akumuluar nga janari i vitit 2016, shuma totale arrin në 4.18 miliardë lekë. Vendimet gjyqësore për largime nga puna, vendimet e gjykatës së Hagës në favor të ish-pronarëve, por edhe shlyerja e detyrimeve ndaj biznesit janë zërat kryesorë ku janë përqendruar borxhet e krijuara rrishtazi. Referuar të dhënave për 3-mujorin, detyrimet më të mëdha të pashlyera i takojnë Ministrisë së Infrastrukturas dhe Energjisë, e cila kryeson listën me 535.2 milionë lekë, ku shifra më e madhe i takon mirëmbajtjes rrugore. Për këtë dikaster, një vend të rëndësishëm në krijimin e borxhit zënë vendimet gjyqësore, me rreth 195 milionë lekë. Shifra të larta në këtë drejtim të vendimeve gjyqësore për largim nga puna raporton Ministria e Brendshme dhe ajo e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, me respektivisht 372.9 dhe 33.2 milionë lekë. Faturore e pashlyer për vendimet e ish-pronarëve shkon në 76.6 milionë lekë. Ndërkohë që në drejtim të rimbursimit të TVSH-së raportohet se nuk ka detyrime të krijuara rrishtazi, ndërkohë që prej 2016-ës, shuma e pashlyer shkon në 195.3 milionë lekë. Në mars të këtij viti, Fondi Monetar Ndërkombëtar bëri thirrje për konsolidim të financave publike, duke kërkuar edhe shlyerjen e detyrimeve të prapambetura.



Përfundon ndërhyrja në autostradën Tiranë-Durrës

Nga sot, autostrada e hapur për trafikun

Prej më shumë se dy javësh autostrada Tiranë-Durrës ka qenë e bllokuar në segmente të ndryshëm të saj për shkak të ndërhyrjes së Autoritetit Rrugor Shqiptar në riparimin e pikave më problematike. Në një dalje për mediat, këtë të shtunë drejtori i përgjithshëm i Autoritetit Rrugor Shqiptar,

Afrim Qendro tha se punimet totale përfundojnë në mesnatë dhe nga sot rruga do të jetë e hapur në gjithë gjatësinë e saj, duke mos krijuar më probleme me trafikun. Kreu i ARRSH ka falënderuar qytetarët dhe bizneset për mirëkuptimin, ndërkohë që theksoi se ashtu siç ishte premtuar,

punimet përfunduan me mbylljen e qershorit, duke e bërë të aksesueshme dhe më të thjeshtë kalimin në autostradë në vijim. Autostrada Tiranë-Durrës është arteria kryesore e transportit rrugor në vend me një interval mes 40-45 mijë mjete në ditë mesatarisht përgjatë gjithë vitit. Ndërhyrja e fun-

dit e qeverisë është një ndërhyrje e pjesshme që "korrigjoi" vetëm pikat më problematike, por vetë ARRSH ka deklaruar se po kërkon financim për të vënë në zbatim një projekt për riparimin tërësor të rrugës, e cila shkon në miliona euro. Projekti fillestar që kërkon vetëm ndërhyrje në shtresat asfaltike ka një kosto rreth 11 milionë euro, ndërkohë që një tjetër projekt që përfshin element shtesë së bashku me zgjerimin ka një kosto 30 milionë euro.

Drejtoria e Përgjithshme e Parandalimit të Pastrimit të Parave merr sinjale për aktivitete të paligjshme

Call center pa licencë si 'Forex': Rreziku i pastrimit të parave

AMF njofton prokurorinë dhe SHISH-in për bllokimin e aktivitetit

Të kamufluara si call center, sot askush nuk mund të na thotë saktë sa është numri i operatorëve në 'Forex', që operojnë pa licencë në vend. Alarmi se shumica prej tyre mund të shërbejnë për pastrim parash apo si skema mashtrimi është dhënë tashmë. Një grup institucionesh, duke përfshirë AMF-në, Krimin Ekonomik, Pastrimin e Parasë dhe Tatimet kanë nisur hetimet, kontrollat dhe verifikimet në terren. "Call center-kambistë" rrezikojnë ta kthejnë Shqipërinë një njollë të zezë në Europë. Të dhënat e sakta mungojnë, por burime të ndryshme, duke përfshirë edhe vetë Autoritetin e Mbikëqyrjes Financiare bien dakord se fenomeni i personave që kanë ngritur aktivitete që operojnë si agjentë për të ofruar shërbime investimi (kryesisht 'Forex' dhe kontrata CFD) është evident. Vlerësohet se janë rreth 50 operatorë fantazmë, që veprojnë nën petkun e call center apo edhe pa asnjë regjistrim në Shqipëri (nga ambientet e shpëtime të kthyer në zyra), duke iu shmangur jo vetëm licencimit, por edhe detyrimeve fiskale dhe respektimit të detyrimeve kontraktuale me punëmarrësit.

NIS 'GJUETIA' E TYRE

Pas një periudhe kaosi në këtë sektor, falë edhe denoncimeve të autoriteteve ligjzbatuese fëmijë, AMF dërgoi muajin e fundit një sërë sinjalizimesh pranë prokurorisë dhe Shërbimit Informativ Shtetëror (SHISH), me qëllim bllokimin e aktivitetit të këtyre firmave të palicencuara. Kreu i AMF, z. Ervin Koçi, e pranoi gjatë raportimit të tij pranë Komisionit Parlamentar të Ekonomisë se do të jenë këto autoritete ligjzbatuese që duhet të hetojnë më tej mbi të gjitha dyshimet e ngritura mbi aktivitetin e këtyre firmave në pastrimin e parave apo edhe mashtrimin e klientëve të tyre. Njëkohësisht, AMF dhe Drejtoria e Përgjithshme e Parandalimit të Pastrimit të Parave (DPPPP) kanë nisur një seri kontrollesh në terren pranë të gjitha kompanive që veprojnë në sektorin e call center. Përtej grupës që po krijon për sistemin fiskal duke punuar në informilitet, këta operatorë piratë rrezikojnë që të shkatërronë reputacionin e vendit tonë si një partner i besueshëm për operatorët e rregullt në këtë sektor, sipas Roberto Caparrotta, përfaqësues i CONFIMI Albania, që ka pasur aktivitet në call center. Operatorët e licencuar paralajmërojnë se shumë shpejt mund të gjen-



Foto ilustruese

demi përballë bllokimit të kontratave të rregullta, duke hedhur në rrugë mijëra punonjës, që janë sot të punësuar në kompanitë e licencuara. Njëkohësisht, reputacioni i një vendi ku mbizotëron informaliteti dhe skemat mashtruese mund të reflektohet në dëmtimin e besueshmërisë së sistemit financiar dhe vetë investimet e huaja në vendin tonë, paralajmërojnë institucionet shqiptare të kontaktuar nga "Monitor".

RREZIKU

Rreziku më i madh që i kanoset Shqipërisë, përveçse përdorimit të këtyre kompanive si instrument për pastrimin e parave është edhe kthimi i Shqipërisë në një njollë të zezë për sa u përket tregjeve financiare. Sipas burimeve nga Drejtoria e Përgjithshme e Parandalimit të Pastrimit të Parave, janë marrë sinjale që këto shoqëri mund të funksionojnë si instrument për pastrimin e parave ose si skema mashtrimi. Rastet kanë qenë në rritje sipas burimeve të "Monitor" në DPPPP. Kjo njësi e Intelligjencës Financiare mbledh të dhëna mbi transaksionet që kryhen nga shumë burime (bankat, pikat e këmbimit valutor, etj.) dhe me anë të analizave shkencore marrin sinjale në rast se diçka nuk shkon. Si funk-

sionojnë në përgjithësi? Kompanitë (kryesisht me bazë në Qipro ose Maltë) lidhen me kompanitë shqiptare, të cilat janë të palicencuara nga autoritetet mbikëqyrëse për shërbime financiare. Kompanitë shqiptare operojnë si ndërmjetësues dhe marrin përqindje për transaksionet e kryera nëpërmjet individëve në shtetet europiane dhe kompanisë mëmë (transaksioni përgjithësisht nuk kryhet në Shqipëri, po këtu vijnë vetëm komisionet). Kompanitë mëna u sigurojnë bazën e parë, listën me kontakte dhe tregun. Këto kompani gjetin një strukturë gati, për shkak se aktiviteti call center kishte filluar të tkurrej, duke qenë se kompanitë nuk po siguronin më kontrata me jashtë. Ishte shumë e lehtë që ato të fillonin që të operonin në këtë fushë, tekta infrastruktura ishte thuasje gati. Një tjetër avantazh ishte kosto e lirë e fuqisë punëtore dhe njohja e gjuhëve të huaja. Sipas burimeve nga DPPPP, rreziku qëndron në faktin se në rast se një nga kompanitë e huaja të brokerimit është një skemë Ponzi (piramidë) dhe në një moment qytetarët e BE-së përballen me humbjen e kursimeve të tyre, Shqipëria do të shënohej si njollë e zezë dhe pasojat do të ishin të rënda. Rasti më i rrezikshëm është

RREZIKET E OPERIMIT PA KONTROLL

- Disa prej skemave që kanë përdorur firmat fantazmë të investimeve 'online' janë:
 - Kryen aktivitet të këshillimi financiar pa licencën përkatëse nga autoritetet shqiptare.
 - Kryen aktivitet të këshillimi financiar drejt klientëve të huaj për llogaritë të platformave fantazmë të huaja, të cilat nuk kanë të drejtë të ofrojnë këto shërbime në këto vende.
 - Ushtrimi i kësaj veprimtarie pa lejet dhe kontrollat përkatëse është i qëllimshëm për të pasur mundësi (siç ndodh në të vërtetë) vjedhjen e parave të klientëve me anë të mashtrimit.
 - Gjithashtu, prejardhja e parave është kryesisht e pakontrolluar duke mbartur rreziqe të mëdha rickikimi parash të pista.
 - Mashtrorinë klientët duke i kërkuar që të investojnë para në uebsite 'online' dhe pastaj nuk u kthen më paratë mbrapsht, duke mos u përgjigjur më në telefon dhe duke u ndërruar fjalëkalimet e hyrjes në sistëm.
 - Kryejnë transaksione bankare me të dhënat e kartave të kreditit që arrijnë tu marrin klientëve pa dënimin e këtyre të fundit.
 - U paguan punonjësit vetëm pagat minimale në bankë dhe pjesën kryesore në 'cash', pa e deklaruar duke shmangur taksat.
 - Shpesh personi kryesor udhëton jashtë shtetit për të tërhequr paratë e realizuara me këtë skemë mashtrimi.
 - Firma që ka krijuar nuk është në emrin e vet, por t'u shmangur përgjegjësisë ligjore. Hapja e NIPT-ëve në emër të punonjëseve.

PROBLEMI KOMBËTAR, NËSE PASTROJNË PARA

dhe ai i ngritjes së firmave fantazmë pa partneritetin e platformave ndërkombëtare të licencuar në BE, që po ndodh në Shqipëri. Ky është edhe rasti më flagrant i operimit në këtë sektor, sepse kapalejt e klientëve janë të pasiguruara nga fonde garancie, ashtu siç kërkohet nga rregulltorët dhe pothuaj në çdo rast, klientët e tyre mund të kthehen në subjekt mashtrimi, sipas burimeve nga DPPPP. Mënyra më e mirë për t'u kontrolluar do të ishte licencimi i këtyre kompanive, rekomandojnë aktorët e tregut. Duke qenë të licencuara, do të ishin gjatë gjithë kohës në monitorin dhe licencim.

Call center-at "kambistë" që fshelin pas vetes brokera fantazmë e veprojnë si skema mashtruese, mund të kthehen në një problem kombëtar. Gjatë raportimit në Komisionin për Ekonominë dhe Financat, drejtori ekzekutiv i Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare, Ervin Koçi, tha se nga institucioni që ai drejton janë nisur shkresa drejt një sërë institucioneve të rëndësishme në vend për të bashkërenduar një plan veprimi. "Kemi pasur informacion që operojnë të tilla shoqëri, sidomos në tregjet e huaja, sa i përket shitjes së

produkteve financiare. Nëse ata janë të licencuar nga broker të Bashkimit Europian, kjo është një gjë pozitive se të paktën janë të kontrolluar. Problemi qëndron nëse ata janë broker fantazmë dhe qytetarët mund të përfshihen. "I kemi shkruar Policisë së Shtetit, Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve, Shërbimit Informativ të Shtetit, Drejtorisë së Përgjithshme të Parandalimit të Pastrimit të Parave. Kam bërë takime dypalëshe dhe kam kërkuar nga SHISH që të na japë emrat e kompanive. Duke qenë se institucioni ynë nuk kishte certifikatë sigurie për të marrë informacion të klasifikuar që jepet nga Drejtoria e Sigurimit të Informacionit të Klasifikuar kemi kërkuar dhe jemi në fazën përfundimtare për të marrë informacion nga SHISH, por duhet të kemi një plan veprimi konkret me gjithë institucionet. Problemi i këtyre shoqërive është që ata më shumë marrin shatas të huaj dhe nesër mund të kthehet në një problem kombëtar, sepse mashtrues qytetarët të huaj. Kjo mund të kthehet në problem edhe nga institucionet ndërkombëtare, nëse shërbejnë për pastrim parash", - tha Koçi. Shqetësimi për operimin e call center-ave jtopikë që operojnë për shitje produkteve financiare ka të paktën dy vite që po lakohej gjërisht.

Marrë nga "MONITOR"

EPSA SHOQËRIA PËRMBARUESE PRIVATE "E.P.S.A." SHPK NJOFTON SHPALLJEN E ANKANDIT PER:

- "Pyll + Kullote"** me sip. 280.000 m², Nr. hipotekor 168 date 29.05.2012, ZK 3028, e ndodhur në Poro, Vlore. Kjo pasuri është hipotekuar në favor të Banka Raiffeisen sha. Çmimi me të cilin fillon ankandi është **4.800.320 Euro**. Ankandi zhvillohet datë **26.07.2018 ora 16.00** në adresen Rr."I. Qemali", Pall."Fratar", K.6,Tirane.
- "Pyll + Kullote"** me sip. 95.000 m², Nr. hipotekor 66 date 25.03.2009, ZK 3028, e ndodhur në Poro, Vlore. Kjo pasuri është hipotekuar në favor të Banka Raiffeisen sha. Çmimi me të cilin fillon ankandi është **1.628.680 Euro**. Ankandi zhvillohet datë **26.07.2018 ora 16.00** në adresen Rr."I. Qemali", Pall."Fratar", K.6,Tirane.
- "Truall + Ndërtim"** me sip.3,250 m² nga kjo 1474,5 m² ndërtesë me adresë Xhafzotaj, Durrës. Kjo pasuri është hipotekuar në favor të Banka Raiffeisen sha. Çmimi me të cilin fillon ankandi është **545.440 Euro**. Ankandi zhvillohet datë **26.07.2018 ora 16.00** në adresen Rr."I. Qemali", Pall."Fratar", K.6,Tirane.
- 4-Për pasurinë** me Nr.578/184, vol.13, fq.216, Zk.3385, me sip.1.270 m² me adresë Shkallur, Durrës, Kjo pasuri është hipotekuar në favor të Banka Raiffeisen sha. Çmimi me të cilin fillon ankandi është **35.560 Euro**. Ankandi zhvillohet datë **26.07.2018 ora 16.00** në adresen Rr."I. Qemali", Pall."Fratar", K.6,Tirane.
- 5-Për pasurinë** me Nr.1/973-1-9, vol.41, fq.85, Zk.8513, me sip.119,2 m² me adresë Rr."Mucu/15", Durrës, Kjo pasuri është hipotekuar në favor të Banka Raiffeisen sha. Çmimi me të cilin fillon ankandi është **40.040 Euro**. Ankandi zhvillohet datë **26.07.2018 ora 16.00** në adresen Rr."I. Qemali", Pall."Fratar", K.6,Tirane.
- 6-Për pasurinë** me Nr.160/51, vol.16, fq.72, Zk.2574, me sip.2.470 m² me adresë Xhafzotaj, Durrës, Kjo pasuri është hipotekuar në favor të Banka Raiffeisen sha. Çmimi me të cilin fillon ankandi është **138.320 Euro**. Ankandi zhvillohet datë **26.07.2018 ora 16.00** në adresen Rr."I. Qemali", Pall."Fratar", K.6,Tirane.
- 7-Për pasurinë** me Nr.160/50, vol.6, fq.71, Zk.2574, truall + ndërtesë me sip.7.330 m² me adresë Xhafzotaj, Durrës, Kjo pasuri është hipotekuar në favor të Banka Raiffeisen sha. Çmimi me të cilin fillon ankandi është **941.360 Euro**. Ankandi zhvillohet datë **26.07.2018 ora 16.00** në adresen Rr."I. Qemali", Pall."Fratar", K.6,Tirane.

Per cdo informacion kontaktoni ne tel. 04 2262711 ose ne www.epsa.al

Përmbarsuesi gjyqësor Genti Bushati nxjerr për shitje në ankand pasurinë :

a) Toke are e regjistruar ne regjistrin hipotekore me nr pasurie 582/1, volumni 10, Fage 248, ne zonen kodestrane nr 1100, me siperfaqe totale 5230 m², e ndodhur ne adresen Barbullush Shkoder
 b) Toke are e regjistruar ne regjistrin hipotekore me nr pasurie 523/21, volumni 9, Fage 3, ne zonen kadastrale nr 1100, me siperfaqe totale 2360 m², e ndodhur ne adresen Barbullush Shkoder
 2. Çmimi me të cilin do të fillojë shitja në Ankand për pasurinë e sipërpërmëntuar, është në vlerën Për pasurinë "Toke Are" me sip 3230 m², është në vlerën 488.376 leke
 Për pasurinë "Toke Are" me sip 2360 m², është në vlerën 356.832 leke
 Shitja e pasurisë fillon me date 04.07.2018 ora 16.15 ne Zyren e përmbarsuesit gjyqësor Genti Bushati me adresë Rruga Don Bosko, Perbalte Gjakates se rrethit Gjyqësor Shkoder.
 Personat e interesuar duhet te derdhen perpara fillimit te ankandit 10 % te vleres si garanci ne Banken BKT dega Shkoder me nr llogarie 41064051,



Rudy Giuliani dhe personalitete nga e gjithë bota në kongresin e përvitshëm

Majko në Paris, në mbështetje të muxhahedinëve: Irani i lirë

Rajavi: Kudo protesta, fitorja e pashmangshme

Mbledhja e përvitshme e iranianeve dhe mbështetësve të Rezistencës Iraniane u mbajt në Paris të shtunën, 30 qershor, 2018. Në "Free Iran" morën pjesë presidentja e zgjedhur e Këshillit Kombëtar të Rezistencës së Iranit, Maryam Rajavi, si dhe qindra politikanë e figura shtetërore të shquara nga pesë kontinente. Mes tyre, edhe ish-kryebashkiaku i Nju Jorkut, Rudy Giuliani dhe ministri për Diasporën i Shqipërisë, Pandeli Majko.

Në fjalimin e saj të mbledhjes, znj. Rajavi vuri në dukje: "Një brez i pasionuar dhe i etur për liri është ngritur në të gjithë vendin për ta rimarrë Iranin nga pushtuesit, mullahët. Punëtorët e Haft-Tapeh, punëtorët e celikut, fermerët e Varzaneh, rinia në Kazerun, shoferët e kamionëve në mbarë vendin, tregtarët e pazareve, të rinjtë në Lalehzar, Ferdoësi, Shoush, Mellat dhe Ekbatan në Teheran kanë treguar një guxim shumë të madh, duke u përballur me forcat mizore të sigurisë. Kjo është beteja e kombit iranian. Rrëzimi i regjimit është i pashmangshëm. Fitorja është e sigurt dhe Irani do të jetë i lirë. Tashmë po duket perspektiva e një Irani të lirë nga mullahët dhe Shahu. E ashtuqajtura zgjidhje brenda fashizmit fetar është bërë e pavlefshme dhe boshe. Popullsia dhe rinia e rebeluar i kanë dhënë fund epokës së të pozuarit për të dyja palët e regjimit". Maryam Rajavi shtoi: "Në gjashtë muajt e shkuar, populli iranian, i të gjitha kombësive dhe etnive, ka ngritur krye pavarësisht shtypjes maksimale. Shoqëria është në një gjendje shpërthyes. Pozita e Khamenei-it ka rënë në mënyrë dramatike dhe nuk ka aspak legjitimitet. Gar-



Ministri i Shtetit për diasporën, Pandeli Majko, gjatë takimit të djeshëm në "Free Iran"

kanë pasur frikë liderët e regjimit". Për sa i përket Iranit të lirë të së ardhmes, Maryam Rajavi tha: "Në bëmë thirrje për themelimin e një shoqërie, të bazuar në liri, demokraci dhe barazi. Ne kemi mbrojtur dhe do të vazhdojmë të mbrojmë barazinë gjinore, të drejtën për të zgjedhur lirisht veshjen, ndarjen e fesë nga shteti, autonominë e kombësive, të drejtat e barabarta politike dhe shoqërore për të gjithë qytetarët e Iranit, heqjen e dënimit me vdekje, lirinë e shprehjes, partive, medias dhe mbledhjes; lirinë e unioneve, shoqatave, këshillave dhe sindikatave. Ne përkrahim një Iran jobërthamor, që do të promovojë bashkëjetesën paqësore me fqinjët e tij dhe që mirëpret bashkëpunimin rajonal dhe ndërkombëtar". Në vijim ajo shtoi: "Në këtë rrugë, hapi i parë është të transferohet sovraniteti tek populli i Iranit. Duke u mbështetur tek populli iranian dhe tek një bazë popullore, mund të shmangët kaosi dhe pasiguria si dhe të mbrohet integriteti i Iranit dhe iranianeve, duke e bërë atë një komb krenar. Sipas programit të NCRI, pas rrëzimit të regjimit, do të formohet një qeveri provizore gjashtëmuajore, detyrues kryesore e së cilës do të jetë të formojë një asamble kushtetuese përmes zgjedhjeve të lira me një votim të përgjithshëm, të drejtëpërdrejtë, të barabartë dhe të fshehtë. Kjo asamble kushtetuese duhet të hartojë Kushtetutën e republikës së re brenda dy vitesh dhe ta kalojë në votim. Ajo duhet të vendosë gjithashtu edhe institucionet kryesore të republikës së re bazuar në

Rrëzimi i regjimit është i pashmangshëm. Fitorja është e sigurt dhe Irani do të jetë i lirë. Tashmë po duket perspektiva e një Irani të lirë nga mullahët dhe Shahu. E ashtuqajtura zgjidhje brenda fashizmit fetar është bërë e pavlefshme dhe boshe.

PERSONALITETET NGA E GJITHË BOTA NË TAKIMIN E PËRVITSHËM TË MEK

Personalitetet e shquara që morën fjalën në këtë tubim të madh përfshijnë Rudy Giuliani, aspirues i postit të presidentit të SHBA dhe ish-kryetar bashkie i Nju Jorkut; Newt Gingrich, kandidat presidencial i SHBA dhe ish-Folës i Dhomës së Përfaqësuesve; guvernatori Bill Richardson; Michael Mukasey, ish-Prokuror i Përgjithshëm; Louis Freeh, ish-drejtor i FBI dhe Gen. George Casey, ish-shef i Stafit të Ushtrisë Amerikane, nga Shtetet e Bashkuara; Stephen Harper dhe John Baird, ish-kryeministër dhe ministër i Jashtëm i Kanadasë; Bernard Kouchner dhe Philippe Douste-Blazy, ish ministra të Jashtëm dhe Rama Yade ish-ministër i të Drejtave Njerëzore të Francës; ambasador Giulio Terzi, ish-ministër i

Jashtëm i Italisë; Sid Ahmad Ghozali, ish-kryeministër i Algjerisë; Eduard Lintner, ish-zëvendësimistër i Brendshëm i Gjermanisë; Rt Hon. Theresa Villiers, ish-sekretare e Shtetit për Irlandën e Veriut; Michele de Vaucouleurs dhe Philippe Gosselin, parlamentarë francezë; senator Paolo Corsini, që përfaqësonte delegacionin italian; Anna Fotyga, ish-ministre e Jashtëm e Polonisë dhe anëtare e Parlamentit Europian; Pandeli Majko, ministër i Shtetit dhe ish-kryeministër i Shqipërisë; Ben-Oni Ardelean, zëvendëskryetar i Dhomës së Deputetëve të Rumanisë; Saleh al-Qalab, ish-ministër i Jordanisë dhe Nazir Hakim, drejtor i Përgjithshëm i koalicionit të opozitës siriane.

da Revolucionare dhe Bassij janë goditur nga dezertimet. Mullahët e kanë humbur mbështetësin më të rëndësishëm të politikës së paqësimit, konkretisht Shtetet e Bashkuara. Orteku i

sankcioneve të njëpasnjëshme po i godet rëndë dhe sinjali më i rëndësishëm për fazën e rrëzimit

it të mullahëve është lidhja midis furisë së popullit dhe lëvizjes së organizuar të rezistencës, gjë që e

kanë pasur frikë liderët e regjimit". Për sa i përket Iranit të lirë të së ardhmes, Maryam Rajavi tha: "Në bëmë thirrje për themelimin e një shoqërie, të bazuar në liri, demokraci dhe barazi. Ne kemi mbrojtur dhe do të vazhdojmë të mbrojmë barazinë gjinore, të drejtën për të zgjedhur lirisht veshjen, ndarjen e fesë nga shteti, autonominë e kombësive, të drejtat e barabarta politike dhe shoqërore për të gjithë qytetarët e Iranit, heqjen e dënimit me vdekje, lirinë e shprehjes, partive, medias dhe mbledhjes; lirinë e unioneve, shoqatave, këshillave dhe sindikatave. Ne përkrahim një Iran jobërthamor, që do të promovojë bashkëjetesën paqësore me fqinjët e tij dhe që mirëpret bashkëpunimin rajonal dhe ndërkombëtar". Në vijim ajo shtoi: "Në këtë rrugë, hapi i parë është të transferohet sovraniteti tek populli i Iranit. Duke u mbështetur tek populli iranian dhe tek një bazë popullore, mund të shmangët kaosi dhe pasiguria si dhe të mbrohet integriteti i Iranit dhe iranianeve, duke e bërë atë një komb krenar. Sipas programit të NCRI, pas rrëzimit të regjimit, do të formohet një qeveri provizore gjashtëmuajore, detyrues kryesore e së cilës do të jetë të formojë një asamble kushtetuese përmes zgjedhjeve të lira me një votim të përgjithshëm, të drejtëpërdrejtë, të barabartë dhe të fshehtë. Kjo asamble kushtetuese duhet të hartojë Kushtetutën e republikës së re brenda dy vitesh dhe ta kalojë në votim. Ajo duhet të vendosë gjithashtu edhe institucionet kryesore të republikës së re bazuar në

Dosjet e viteve 1993-2008, formulari-tip për informim në lidhje me ecurinë e vendimeve

Ornela Manjani

Pronarët në Korçë, ATP merr në shqyrtim 10 mijë dosje

Problematikat, procedurat për t'u njohur me ecurinë e shqyrtimit

Agjencia e Trajtimit të Pronave publikon listën me 10 mijë dosje ish-pronarësh, që janë në proces shqyrtimi nga kjo agjenci. Kërkesit janë në qarkun e Korçës. Në listën e përditësuar jepet numri i dosjes dhe data e aplikimit, gjeneralitetet e kërkesit, sipërfaqet e njohura për kompensim, dosjet për pronarët që kanë marrë vendim negativ dhe dosjet që duhet të plotësohen. Dosjet janë të viteve 1993 deri në vitin 2008. Agjencia e Trajtimit të Pronave ka vënë në dispozicionin të pronarëve formularin tip, "Informacion në lidhje me ecurinë e dosjes", i cili duhet të plotësohet dhe të dorëzohet në Agjencinë për t'u njohur me fazën në të cilën ndodhet shqyrtimi i saj. Agjencia Trajtimit të Pronave është e detyruar që brenda 15 ditëve nga momenti i dorëzimit të kërkesës t'i kthejë përgjigje pronarit në lidhje me ecurinë e dosjes.

FORMULARI

Formulari i aplikimit për informacion në lidhje me ecurinë e dosjes është i ndarë në tri seksione. Aplikanti duhet të plotësojë gjen-

eralitet, adresën dhe të jetë i pajisur me mjet identifikimi në momentin e aplikimit. Në seksionin e dytë duhet të jetë përshkruar në mënyrë të saktë se në lidhje me çfarë kërkon informacion pala e interesuar, në këtë rast pronari që ka aplikuar për kthim e kompensim prone. Dhe në seksionin e fundit janë të specifikuar pesë dokumentet që duhet të disponojë pronari në momentin e aplikimit.

APLIKIMI

Për t'u njohur me ecurinë e dosjes, subjekti duhet të plotësojë dhe të paraqesë dorazi ose me postë pranë ATP-së kërkesën përkatëse me shkrim për informim në lidhje me ecurinë e dosjes, fotokopje të kartës së identitetit, dëshmi trashëgimie

DOKUMENTACIONI QË DUHET TË PARAQISNI

- Formulari-tip
- Fotokopje e kartës së identitetit
- Kopje vendimi nga ish-KKP/AKKP (nëse ka)
- Dokumente të tjera

dhe prokurë të posaçme. Në faqen zyrtare të ATP-së mësohet se subjekti plotëson kërkesën me shkrim për informim në lidhje me ecurinë e dosjes pranë Zyrës së Marrëdhënieve me Publikun, në 'Agjencinë'. Më pas, kërkesa i kalon zyrës së protokollit, e cila pasi e protokollon, ia dërgon të gjitha kërkesat e ardhura drejtorit të përgjithshëm. Kreu i AKKP-ës ia delegon kërkesat sek-

torit përkatës për ndjekje dhe zbatim. Më pas, sektori përkatës përgatit informacionin e kërkuar dhe njofton subjektin. Në përfundim të shqyrtimit, subjekti paraqitet pranë zyrave të ATP-së për të tërhequr shkresën e kthimit të përgjigjes në lidhje me ecurinë e dosjes ose i dërgohet me postë, sipas kërkesës. Aplikimi për kërkesën për informim mbi dosjen nuk ka kosto.

KORÇË

Nr./Dosjes	Rrethi	Emri (Subjekti kërkuar)	Atesia 2	Mbiemri (Subjekti kërkuar)	Sip. E Njohur/ Mosnjohje M2	Problematika
485	DEVOLL				5132	
486	DEVOLL				1269	
482	DEVOLL	SERKA		OCKA	1000	
479	DEVOLL	IBRAHIM		TOPALLI	3000	
	DEVOLL				300	
	DEVOLL					
478	DEVOLL				90	
473	DEVOLL				400	
472	DEVOLL				200	
483	KOLONJE	ISMAIL		TOPÇI	1588	
481	KOLONJE	FERZILET		ZYFI	5498	
480	KOLONJE	RESHIT		GANI	3500	
484	KOLONJE				19100	
473	KOLONJE				300	
474	KOLONJE				1340	
475	KOLONJE	HYRIJE		MAHO	1487	
84	KOLONJE	SELVI		CERCIZI	2506	
145	KOLONJE				240	
365	KOLONJE				240	
314	KOLONJE	LLAMBI		LLAZARI	540	
76	KOLONJE	JASHAR		DEMKO	1383	
221	KOLONJE	HASAN		QOSE	4310	
254	KOLONJE				3006	
177	KOLONJE				4706	
1	KOLONJE				912	
4	KOLONJE				375	
108	KOLONJE				760	
228	KOLONJE	TAHIR		MEHMETI	527	
322	KOLONJE				5580	
12	KOLONJE				688	
234	KOLONJE				1392	
320	KOLONJE				795	
142	KOLONJE	AGRON			3248	
208	KOLONJE	LLAZI		RISTANI	935	
213	KOLONJE	VASILLA		KOTORRI	55	
139	KOLONJE				216	
148	KOLONJE	KOSTA		SHIMO	400	
204	KOLONJE				527	
80	KOLONJE				300	
205	KOLONJE	NIKOLLA		ZGJURI	760 Mos njohje	
257	KOLONJE				MOSMIRATOJE KERKESEN	
261	KOLONJE	ILO		DEDO	MOS MIRATOJE KERKESEN	
290	KOLONJE	KOCO		STAMLI	MOS MIRATOJE KERKESEN	
289	KOLONJE	SOTIR		RUCO	MOS MIRATOJE KERKESEN	
288	KOLONJE	KOCO		MITRE	MOS MIRATOJE KERKESEN	
	KOLONJE				MOS MIRATOJE KERKESEN	
286	KOLONJE	SKENDERIE		VENEDIKU	MOS MIRATOJE KERKESEN	
285	KOLONJE	FUAT		XHAMAOI	MOS MIRATOJE KERKESEN	
471	KOLONJE	FERIT		AGOLLI	1135 /MOS NJOHJE 778	
468	KOLONJE				3730	
594	KOLONJE				6135	
53	KOLONJE	HYSEN		MALUKA	1902	
	KOLONJE				924	
	KOLONJE				200	
	KOLONJE				3680	
72 73 74 75	KOLONJE				80	
	KOLONJE				3000	
	KOLONJE				1110	
	KOLONJE				3000	
238	KOLONJE	ABEDIN		BANUSHI	3468	
431	KOLONJE	QEMAL		IPI	6286	

Nr./Dosjes	Rrethi	Emri (Subjekti kërkuar)	Atesia 2	Mbiemri (Subjekti kërkuar)	Sip. E Njohur/ Mosnjohje M2	Problematika
466	KOLONJE	REFAIT		QIRIAZI	8798	
128	KOLONJE				12612	
470	KOLONJE	PETRINA		COBANI	1091	
483	KOLONJE				1045	
460	KOLONJE				10000	
445	KOLONJE				MOSNJOHJE	
453	KOLONJE				MOSNJOHJE	
31	KOLONJE				103	
112	KOLONJE				70	
	KOLONJE				2750	
	KOLONJE				594	
465	KOLONJE				800 /MOSNJOHJE 480	
472	KOLONJE	ALI		KACIU	1422 1233	
466	KOLONJE	ORESTI		PRODANI	3500	
84 85 86	KOLONJE				1880	
	KOLONJE				MOSNJOHJE 3000	
	KOLONJE				3987 +PARABLERE PER OBJEKTET	
	KOLONJE				932	
	KOLONJE				780	
	KOLONJE				702	
	KOLONJE				6662	
	KOLONJE				MOSNJOHJE	
	KOLONJE				MOSMIRATIMIN E KERKESES	
	KOLONJE				2204	
262	KOLONJE	KOCO		TITO	858	
461	KOLONJE	ASTRIT		CABEJ	720	
247	KOLONJE				39	
462	KOLONJE	VESEL		BAKO	4638	
464	KOLONJE	SULEJMAN		PUPË	22158	
341	KOLONJE	SOTIR		NIKOLLA	824	
451	KOLONJE				207	
372	KOLONJE				1030	
456	KOLONJE				280	
401	KOLONJE	BAJRAM		MALO	9147	
251	KOLONJE	SERVET		BAKO	MOS MIRATOJE KERKESEN	
267	KOLONJE	BESHNIK		MECË	MOS MIRATOJE KERKESEN	
266	KOLONJE				MOS MIRATOJE KERKESEN	
265	KOLONJE				MOS MIRATOJE KERKESEN	
264	KOLONJE				MOS MIRATOJE KERKESEN	
263	KOLONJE	SAKO		MECË	MOS MIRATOJE KERKESEN	
256	KOLONJE	VALTER		KACIUPI	MOS MIRATOJE KERKESEN	
250	KOLONJE	BEKTASH		TARË	MOS MIRATOJE KERKESEN	
277	KOLONJE	TOSI		NASTASI	15000	
276	KOLONJE				4342	
275	KOLONJE				MOS MIRATOJE KERKESEN	
	KOLONJE				49132	
	KOLONJE					
274	KOLONJE				17342	
273	KOLONJE				66886	
254	KOLONJE				MOS MIRATOJE KERKESEN	
268	KOLONJE	EDIE		RYTA	MOS MIRATOJE KERKESEN	
282	KOLONJE	HAJDAR		MALO	MOS MIRATOJE KERKESEN	
281	KOLONJE	KRISTAQ		NIKOLLA	MOS MIRATOJE KERKESEN	
280	KOLONJE	XHEMAL		ISAJ	MOS MIRATOJE KERKESEN	
279	KOLONJE	ENGJELUSHË		MUCO	MOS MIRATOJE KERKESEN	
278	KOLONJE	MURHAMED		SHEGA	MOS MIRATOJE KERKESEN	
262	KOLONJE				MOS MIRATOJE KERKESEN	
283	ZYRA MALUKA	SULEJMAN		QEMALI	MOS MIRATOJE KERKESEN	
272	KOLONJE	SULEJMAN		QEMALI	MOS MIRATOJE KERKESEN	

DEVOLL				6803
123	DEVOLL	SALI	CELA	46 DY
127	DEVOLL			2372
				152479
134	DEVOLL			19000
131	DEVOLL	ELI	POPILLO	35000
129	DEVOLL	FANA	NICO	MOS MIRATOJE KERKESEN
DEVOLL	ULAZI		NICO	MOS MIRATOJE KERKESEN
122	DEVOLL			5 DYNYM
133	DEVOLL			54 DY
DEVOLL				886900
DEVOLL				
125	DEVOLL	REXHEP	TOPÇIU	14 DY
124	DEVOLL	RAMADAN	NEZIRAFI	MOS MIRATOJE KERKESEN
349	DEVOLL	MUHAMMAD	MULLA	2300
352	DEVOLL	NISTO	SHUNDO	20
349	DEVOLL	NEIM	BEQIRI	20
362	DEVOLL	ISMAIL	GRACA	1943
361	DEVOLL	ALI	GRACA	1943
350	DEVOLL			
357	DEVOLL	PANDI	FILO	5357
359	DEVOLL			7435
353	DEVOLL	MARIKA	SHUNDO	14 DY
358	DEVOLL	GANI	HOXHA	34000
356	DEVOLL			44 DY
141	DEVOLL			2000
145	DEVOLL	REFAT	HAMIT	1120
153	DEVOLL			400
152	DEVOLL			1000
DEVOLL				
151	DEVOLL			6000
150	DEVOLL	ELMAS	HOXHALLI	460
149	DEVOLL	ZYDI	MALLOLI	150
148	DEVOLL	FERIT	ZERBA	2350
147	DEVOLL	VELISHAH	AGASTRO	1681
146	DEVOLL	NEKI	SPAHO	MOS NJOHIE
144	DEVOLL			795
143	DEVOLL			1800
142	DEVOLL	SULEMAN	BYLYKBASHI	1408
154	DEVOLL	ENGIJELL	PEMA	402
156	DEVOLL			550
155	DEVOLL			407
100	DEVOLL			1800
402	DEVOLL	MINE	HOXHALLI	3810
104	DEVOLL	ULAZI	NICO	278
101	DEVOLL	EMIN	HISO	830
115	DEVOLL			940
113	DEVOLL	RAHMI	MANAFI	9382
112	DEVOLL	VEKHUJE	MUSA	567
110	DEVOLL	HATIXHE	TARE	
109	DEVOLL			2882
103	DEVOLL	SHABAN	HOXHA	4000
111	DEVOLL	JAKUP	KAMT	750
105	DEVOLL	AVNI	GRABOLLI	3000
106	DEVOLL	SHPENDI	MALEZYKA	
107	DEVOLL	MENDI	MERROLLI	1500
108	DEVOLL	ILIA	TOSKA	869
114	DEVOLL	AGIM	GOSIA	1160
799	DEVOLL	ULAZI	KOVACI	1650
805	DEVOLL			2200
801	DEVOLL	NUNI	PLAREU	5740
808	DEVOLL	SHEQEREM	SALI	7426
804	DEVOLL			2420
802	DEVOLL	YRMET	URIKCI	1200
803	DEVOLL			5700
800	DEVOLL	ZALO	SHURDHO	
797	DEVOLL	ANESTI	FELI	MOSNJOHIE
798	DEVOLL			3150
796	DEVOLL	IZET	MEÇO	940
806	DEVOLL			1500
807	DEVOLL	QAMIL	BAROLLI	2800
810	DEVOLL	ELMAS	MULLA	2080
30	DEVOLL			85
18	DEVOLL			SHTUPI
12	DEVOLL			468
4	DEVOLL	JANI	KARANXHA	17.5
103	DEVOLL			1540
DEVOLL				5330
55	DEVOLL	BEXHET	FRASHERI	60
74	DEVOLL			3000
201	DEVOLL	BAZIKO	BEQIRI	4040
202	DEVOLL	ALI	JAZHI	
884	DEVOLL			447
885	DEVOLL	PANDI	GIATA	3718
878	DEVOLL			MOSNJOHIE
871	DEVOLL			1400
214	DEVOLL	SABRI	HYSI	200
216	DEVOLL			574
205	DEVOLL	ZIJA	GEGOLLI	150
215	DEVOLL			2355
213	DEVOLL	RAMI	BABASULI	5700
212	DEVOLL			1500 mosnjohie
211	DEVOLL	TEFERE	TAROLLI	1100
210	DEVOLL	ISLAM	BABASULI	9300
209	DEVOLL			NJOHIE 6755 MOSNJOHIE 3245 DHE 5700
208	DEVOLL	VASIL	GIYLALETE	870
207	DEVOLL	ISLAM	BANUSHI	5200
203	DEVOLL	RAMI	KAPE	1150
204	DEVOLL	MAZLLEM	SILLOGU	2800
DEVOLL				2431
206	DEVOLL	AGIM	HERRI	1994
872	DEVOLL			800
873	DEVOLL			1500
874	DEVOLL			225
876	DEVOLL			MOS MIRATOJE KERKESEN
875	DEVOLL	ANDON	DIMO	279
DEVOLL				MOS NJOHIE 2538
870	DEVOLL			2300
50	DEVOLL			1387
57	DEVOLL			2909
156	DEVOLL			2909
141	DEVOLL	NAFI	MULLA	655
130	DEVOLL	VASIL	SHANO	45.5
83/1	DEVOLL	HALLI	SPAHO	20340
83	DEVOLL	ZARIF	SPAHO	20340
DEVOLL				207
30	DEVOLL			310
74	DEVOLL			1947
DEVOLL				5000
DEVOLL				535
533	DEVOLL	SEIT	LATIFI	1100
DEVOLL				900
DEVOLL				
539	DEVOLL	THEMI	NAQO	1150
DEVOLL				1330
DEVOLL				
538	DEVOLL	MUSTAFA	ZEQIRI	7221

536	DEVOLL	MYSYM	MALIQI	1000
532	DEVOLL			1250
535	DEVOLL	ZAMIR	MERO	MOS MIRATOJE KERKESEN
537	DEVOLL	TROSDO	BOZHO	500
531	DEVOLL	VELISHAN	HYSENI	MOS MIRATOJE KERKESEN
534	DEVOLL	ILO	VASILU	286
540	DEVOLL	HYSEN	SINO	1950
541	DEVOLL	RESHAT	BEQIRI	1250
542	DEVOLL	SELAM	SHEHU	2000
543	DEVOLL	SALI	ZYLFERI	500
544	DEVOLL			2500
545	DEVOLL	SEIT	HYSENI	1200
546	DEVOLL	SULEJMAN	DAUTI	1100
547	DEVOLL	MYRTEZA	EMINI	1400
548	DEVOLL			660
549	DEVOLL			1056
550	DEVOLL	ELMAZ	SHABANI	1495
689	DEVOLL			368
682	DEVOLL	FERIDE	MULLA	666.5
671	DEVOLL			1150
672	DEVOLL			3210
673	DEVOLL	SHEFIK	ABEDINI	3393
674	DEVOLL			1807
683	DEVOLL			1181
685	DEVOLL			2410
686	DEVOLL			3500
687	DEVOLL			200
690	DEVOLL			468
684	DEVOLL			2100
675	DEVOLL	ASLLAN	BILEDHI	7550
678	DEVOLL			1500
681	DEVOLL			1500
675	DEVOLL	ZEQIR	KUTROLLI	1556.5
688	DEVOLL	MITAT	HOXHA	4500
679	DEVOLL	ISENDI	REXHEPI	2000
412	DEVOLL	HYSEN	DYU	1000
411	DEVOLL			1156
403	DEVOLL	SHEGA	LUSHI	713
401	DEVOLL	SKENDER	DENOLLI	704
402	DEVOLL			1693
593	DEVOLL	JOSIF	MUSTAFA	
597	DEVOLL	MESEN	HYSENI	
596	DEVOLL	HALIE	SADIKU	
599	DEVOLL			
598	DEVOLL			
600	DEVOLL	FEJZI	SHEHU	
602	DEVOLL	HYSEN	DEMIRI	
DEVOLL				
609	DEVOLL	GURALI	HAXHILLARI	975
591	DEVOLL			1500
604	DEVOLL	HYSEN	AHMETI	1900
592	DEVOLL	ALI	KARANXHU	2000
594	DEVOLL			2050
605	DEVOLL	AHMET	CETA	1240
607	DEVOLL			120
606	DEVOLL	XHEVDET	GEGOLLI	829
608	DEVOLL			1900
610	DEVOLL	SELAME	KASO	MOSNJOHIE 870
467	DEVOLL	VEPPRORE	BYLYKU	5660
463	DEVOLL	FILLORETE	MBRICA	40
466	DEVOLL	THIMI	ZOTO	1005
465	DEVOLL			108
461	DEVOLL	KOZMA	GIATA	472
458	DEVOLL	ALI	ETEM	736
457	DEVOLL			MOSNJOHIE
455	DEVOLL			375
454	DEVOLL	ROSTO	TODI	35
452	DEVOLL	TAHIR	JAGO	1600
451	DEVOLL	BUJAR	BARHI	2338
470	DEVOLL			4660
469	DEVOLL	ILO	XHACKA	570
453	DEVOLL	ETEM	PLAKU	3969
462	DEVOLL	ZYDI	TOPI	3260
459	DEVOLL			1274
464	DEVOLL	XHEMIL	XHEMAD	2600
468	DEVOLL	NJAZI	QARIMI	4041
162	DEVOLL			16000
163	DEVOLL			2180
168	DEVOLL	ENVER	DEMIRI	491
165	DEVOLL	FERIT	SPAHO	500
164	DEVOLL			4500
172	DEVOLL			4927
157	DEVOLL			MOSNJOHIE
158	DEVOLL			1000
160	DEVOLL	XHEVRIJE	BRACKA	1000
161	DEVOLL			3500
166	DEVOLL	FEJZI	MANCKA	1290
167	DEVOLL	DRITAN	ZAIMI	
169/1	DEVOLL			
170	DEVOLL	VALENT	ALICKOLLI	
171	DEVOLL	NJAZI	NIUHO	
173	DEVOLL	FIQIRI	ZENELOGU	4575
174	DEVOLL	NEXHDET	SHAHOLLI	2500
175	DEVOLL	ILMI	KOLONJARI	430
176	DEVOLL	AGIM	HYSI	2700
165	DEVOLL			MOS MIRATOJE KERKESEN
119	DEVOLL			4610
887	DEVOLL	AVNI		MOS MIRATOJE KERKESEN
DEVOLL				1000
DEVOLL				VENDIMI FOTOKOPJE
869	DEVOLL	FATJONA	YZEIRI	MOS MIRATOJE KERKESEN
868	DEVOLL	ARIF	KORDOLLI	MOS MIRATOJE KERKESEN
880	DEVOLL	AUREL	KELO	MOS MIRATOJE KERKESEN
888	DEVOLL	HAMDIE	BERBERI	MOS MIRATOJE KERKESEN
902	DEVOLL			9600
901	DEVOLL			MOSNJOHIE 2781
900	DEVOLL	XHAFERR	HARIFI	
897	DEVOLL	VILSON	MEKA	1457.5
403	DEVOLL	QAMIL	ISMALI	5243
409	DEVOLL	GJERGJII	PALLOI	350
DEVOLL				18000
405	DEVOLL			1425
DEVOLL				2000
406	DEVOLL			486
407	DEVOLL	AVNI	ZEQO	2888
408	DEVOLL	NAZIF	KAHANO	1000
409	DEVOLL	DEMIR	TARELLI	2250
409/1	DEVOLL	DUDI	LLECI	800
DEVOLL				1400
410	DEVOLL	FATIME	LLECI	1400
DEVOLL				
413	DEVOLL	ETEM	MYRTO	800
476	DEVOLL			3000
477	DEVOLL			150
486	DEVOLL	SERVET	LAME	5132

"Rusi 2018", Portugalia eliminohet

Dygolëshi Kavanit, Uruguai në çerekfinale



Uruguai-Portugalia ishte një nga ato ndeshje ku të gjithë e kishin të vështirë ta anonin peshoren nga njëri ekip apo nga tjetri. Kjo sepse ishte hera e parë që dy përfaqësueset përballëshin në histori, si dhe të dy trajnerët kishin në dispozicion artilleri të rëndë para, me Tabarezin që i besonte nga fillimi dyshes Kavanit-Suarez, ndërsa Ramos një nga lojtarët më të mirë të të gjitha kohërave, Kristiano Ronaldo, që mbështetej nga një mesfushë më cilësore sesa

ajo e Uruguait. Por, diferencën në këtë përballje e bëri mbrojtja. Portugalia e nis më mirë ndeshjen, por ata që shënojnë të parët janë uruguianët. Suarez e Kavanit kombinon bashkë me "el pistoleron", që harkon në zonë për kokën e Kavanit, që në shtyllën e dytë nuk fal duke thyer Rui Patrision, ndërsa Suarez pak minuta më vonë prvon nga goditja e dënimit,

por është në lartësinë e duhur gardiani luzitan. Ronaldo përpqet i vetëm të marrë përsipër Portugalinë, por do të ndalet me të gjitha mënyrat nga prapavija e vëmendshme e Uruguait. "Selestët" do të kenë dhe një tjetër rast shënimi në fund të pjesës së parë, por "El Matador" vetëm sa krijon iluzionin e golit. Në pjesën e dytë Portugalia është më ofensive dhe do të

barazojë shpejt. Minuta e 55-të dhe pas një skeme nga këndorja, Pepe do të mposhtë Muslerën kur gjuan saktë me kokë në qendër të zonës. Duket se Portugalia ka në dorë të marrë kontrollin e ndeshjes, por ata që shënojnë janë sërish uruguianët dhe sërish me Kavanin. "El Matador" realizon një gol të shkëlqyer me të djathtën, duke e lënë të

pashpresë Rui Patrision në hedhjen e tij. Fatkeqësisht ndeshja për Kavanin mbyllet pas këtij goli, pasi dëmtohet dhe zëvendësohet nga Stuan. Tashmë Portugalia nuk ka se çfarë të humbasë dhe hidhet e gjitha në sulm, por raste të pastra shënimi nuk do të krijojë, ndërsa nervat do të tradhtojnë portugezët, që do t'i administrojnë keq minutat e fundit. Përfundimisht 2-1, Uruguai që ka siguruar çerekfinalin, Uruguai që 'asgjësoi' Kristiano Ronaldo.

Në Kazan ka bollëk golash. Franca fiton 4-3, ndërsa 19-vjeçari eklipson "Mesian"

Franca "këndon" me Mbapen, Mesi e Argjentina në shtëpi

"Gjelat" janë çerekfinalistët e parë të Botërorit

Jeton Selimi

E kishim cilësuar si një finale të parakohshme dhe ashtu ishte. Franca dhe Argjentina dhuruan spektakël në "Kazan Arena" me gola të shkëlqyer dhe aksione të vrullshme. "Gjelat" e nisim me 100 km/orë ndeshjen dhe ajo që i druhej më shumë Sampaoli ndodh. Kilian Mbape në versionin Usain Bolt dhuron shpërthime pa fund që vendosin në siklet të gjithë prapavijen argjentinase, ndërsa Franca del në sulm me 3-4 pasime. Meskareano e ka të vështirë ta ndalë yllin e PSG-së. Roho, i adaptuar si qendërmbrojtës hipnotizohet prej tij dhe Mbape dhuron gjithçka në minutat e para të takimit. Fillimisht do të fitojë një faull pas ndërhyrjes së Maskeranos, faull të cilin Antuan Grizman e përplas në traversë, ndërsa 3 minuta më pas, rrëmben një top dhe vrapon me galop për rreth 70 metra, deri kur Roho e ndal me faull në zonë. Penaliti nuk nga pika e bardhë nuk gabon Grizman, që kalon "Gjelat" në epërsi. Por, Mbape nuk e ka hequr ende 'këmbën nga gazi', ndërsa në të 19'-ën fiton një

tjetër faull, të cilin Pogba e gjuan jashtë. Argjentina përpqet të reagojë, por duket e pafuqishme për të çarë prapavijen e trikolorëve, ndërsa për të shkundur të tijtë mendon Angel Di Maria. Mesfushori harrohet nga francezët, që i lënë të gjithë kohën e nevojshme për të kalibruar në perfeksion të majtën e tij, që nga 20 metra thyen Hugo Loris e prehet në rrjetë, për ta mbyllur pjesën e parë në barazim 1-1. Por nëse të parën e nisi Franca me gol, në të dytën është Argjentina që shënon. Harkim nga këndorja dhe topi shkon te Mesi, që gjuan, por Mercado është në trajektore dhe devi-



jon duke e nxjerrë në kundër kohë Loris. Gjithësi kjo përballje, kjo finale e parakohshme është e gjitha për t'u shijuar. Në minutën e 57-të vjen një tjetër eutrogol, kësaj radhe për Francën, me Pavar që bara-

zon ndeshjen me të djathtën e tij fluturimthi nga jashtë zonës, një diagonale perfekte, që prehet në rrjetën e Armanit, një gol që ia vlen ta rishohësh qindra herë. Goli bën që Franca të shtojë dozën në sulm, ndërsa goli i

epërsisë nuk do të vonojë. Një top mbetet në zonën e Armanit dhe Kilian Mbape përfiton në maksimum nga gjithë limiti defensiv i mbrojtjes argjentinase, duke shënuar golin e tretë për "gjelat". Por Mbape nuk ka mbaruar punë mes Argjentinës. Minuta e 68-tën dhe Zhiri hap topin në krah, me sulmuesin e PSG-së, që tregohet i përpiktë në takimin me topin dhe me të djathtën thyen për të dytën herë Armanin dhe duke sjellë qetësi në kampin francez, që tashmë në epërsi të dy golave, duhet vetëm që të administrojë avantazhin e çmuar. Por Argjentina nuk dorëzohet dhe në minutat

finale i shton edhe më emocionet e një sfide për t'u mbajtur mend me reagimin e saj. Mesi dhe Aguerro përpqen në disa momente të shënojnë, për të mbërritur në minutën e 93-të, kur Mesi 'pikturon' një asist për Aguerro, që me kokë ngush-ton shifrat në 4-3. Gjakra nxehen në fushë me ekipet që kërkojnë kush të fitojë sekonda në favor të saj. Argjentina prvon dhe një aksion të fundit, por topi del jashtë. Përfundimisht mbyllet 4-3 për Francën, që kalon në çerekfinale, ndërsa Argjentina bën valixhet dhe kthehet në shtëpi, ndërsa Mesin dhe Sampaolin i pret gjyqi i mediave.

Sot në Shën Pjetërburg

Çerçesov dhe Hierro duan biletën çerekfinaliste

Rusi-Spanjë është çerekfinalja e parë që do të luhet të nesër, ndërsa të zotët e shtëpisë do të përballen me një nga ekipet më të forta të turneut, ndërsa trajneri Stanislav Çerçesov e vë theksin tek eksperiencia e rivalëve. "Jemi të përgatitur për fazën e 1/8-ave. Është e vërtetë që kemi munguar në këtë fazë prej dekadash të tëra, por kjo nuk ndryshon asgjë. Përgatitja jonë është e njëjtë si për çdo ndeshje tjetër. Kundërshtari ynë ndryshon shumë nga sfidat tona të mëparshme. Spanja ka pikat e



saj të forta dhe të dobëta. Shpresoj vetëm të jemi në gjendje t'i shfrytëzojmë ato. Diçka është e sigurt, krahasuar me ta, ne kemi shumë më pak eksperiencë". Fernand Hierro ka gjithçka gati për ndeshjen me Rusisë. Trajneri i Spanjës kërkon nga djemtë

e tij që të minimizojnë gabimet dhe të improvizojnë gjatë lojës, çka mund të jetë çelësi i suksesit kundër Rusisë. "Kemi një plan të qartë për Rusinë. E dimë se çfarë duam, se cila është Rusia dhe se cilët jemi ne. Futbollit është një ndeshje gabimesh dhe fiton ai që gabon më pak. Ne duhet të gabojmë sa më pak të jetë e mundur. Jam optimist se në grupe kemi ditur të rikthehemi kur kemi qenë në disavantazh. Sa i takon Rusisë, mund të them se janë vërtet të fortë. Të shohim se ç'do ndodhë në fushë".

Sot në "Nizhni Novgorod"

Daliç ka besim te Kroacia, Hareide te Danimarka

Kroaci-Danimarkë është një ndeshje që ka dhuruar emocione gjithmonë. Në "Euro '96", Kroacia fitoi 3-0 dhe të gjithë tifozët ende e kanë para syve golin e Davor Shukerit ndaj Peter Shmajkëllit. Në sallën e konferencave, ish-trajneri i Dinamos së Tiranës, Zllatko Daliç, vlerëson në maksimum forcën e ekipit të tij. "Nuk do ta marrim me nxitim. Duhet të jemi të qetë dhe të presim shanset tona. Çdo gjë varet nga ne. Duhet të luajmë me zgjuarsi dhe emocionet do



kërkojnë të na udhëheqin, por koka ajo që duhet të na mbajë të ftohtë dhe të fortë. Duhet të jemi të kujdesshëm. Jam shumë optimist, sepse besoj pafundësisht te kjo skuadër". Trajneri i Danimarkës, Age Ha-

reide kërkon të fitojë dhe ndjen presionin e të gjithë popullit danez, që pret me padurim sfidën ndaj Kroacisë. "Mezi po e presim këtë ndeshje dhe jemi të vetëdijshëm që përballë do të kemi ekipin më të mirë të fazës së grupe. Kroacia ka zhvilluar mbase futbollin më të mirë nga të gjitha ekipet në këtë Kupë Bote. Në Danimarkë të gjithë do të jenë përballë televizorit për të ndjekur këtë ndeshje dhe presin kualifikimin. Natyrisht që është e vështirë, sepse Kroacia është një ekip i madh".

E DIEL

1 Korrik

2018



NGA BEN ANDONI

Do duhej shiu i rrëmbyer në Tiranë, kushtet e vështira ku ruhen librat dhe ngushtësia e mjediseve të Bibliotekës Kombëtare, që njerëzit të kuptonin dhe njëherë emergjencën e saj. Këtë herë, drejtoresha e institucionit, ka qenë disi pa doreza. Nuk kemi ambiente, kushtet janë të vështira, ishte me pak fjalë ajo që parashtrroi në këto orë të vështira. Ndërkaq, nuk ka mundur t'i shpëtojë politikës dhe akuzave ndaj saj gjendja aktuale e Bibliotekës Kombëtare. Siç mund të merret me mend i akuzuari kryesor ishte kryeministri i vendit dhe jo pa faj dhe instancat e tjera, duke mos lënë pa përgjegjësi dhe drejtoreshën aktuale, që në fakt ka kohë që apelon, por asnjëherë si ditët e fundit. Asgjë nuk i shfajëson njerëzit e piramidës socialiste, por edhe paraardhësit e tyre demokratë për të gjithë atë që po ndodh me këtë institucion, mbi të gjitha indiferencën për të dhe larjen e durave për fatin e saj.

Për ironi të fatit, mbase njerëzit e Ministrisë së Kulturës nuk janë fajtorët kryesorë të kësaj gjendje aktuale, porse neglizhenca e tyre skajore dhe mbi të gjitha mos ngërritja e zërit në kohën e duhur, që do të thotë marrja e masave, i bën po kaq fajtor.

I habitshëm ka qenë zëri i Presidentit Meta që u ka bërë thirrje institucioneve përgjegjëse të marrin masa urgjente në mënyrë që të parandalojnë përsëritjen e një situatë të ngjashme në të ardhmen. Sikur të jetë një burokrat i ndonjë shteti, që s'ka lidhje me Shqipërinë, ashtu ka folur edhe njeriu që ka qenë në kupolën shqiptare të politikës në të gjithë dekadën e fundit.

...

Përballë shiut dhe zjarrit

Ndaj Piramida duhet të jetë BIBLIOTEKË KOMBËTARE

Pak ditë më parë, reshjet e dendura në kryeqytet, shkaktuan përmbytjen e katit të parë të Bibliotekës Kombëtare. Prania e ujit, për të cilën ka ende mëdyshje për shkaqet, në një nga sallat e institucionit në katet e nëndheshme të hapësirave deponituese të kole-

sioneve bibliotekare (libra, revista, gazeta), ka shkaktuar lagjen dhe dëmtimin e materialeve bibliotekare të sistemuara në nivelet më të ulëta të sallës.

Në këtë rast, Biblioteka Kombëtare, duke parë edhe parashikimin e kohës shpallë gjendjen e

emergjencës për trajtimin e materialeve bibliotekare të lagura ose pjesërisht të lagura me qëllim tharjen dhe restaurimin e tyre të plotë. Sërisht, Biblioteka Kombëtare siguroi se nuk janë prekur mjediset ku ruhet fondi i Vlerave të rralla dhe Arkivi i librit e i periodikut

shqip. Madje, me shumë optimizëm është kumtuar se janë tharë një përqindje e madhe e librave dhe materialeve. Por mënyra e tharjes ka treguar hapur vështirësitë e institucionit dhe më kaq kushtet e mjereshme të librit tonë.

→ Vijnë në faqen 14

{ Në këtë numër: ARIAN LEKA, KUJTIM DASHI, MAKS VELO ETJ... }

B

BIBLIOTEKA

Për fatin e saj, Piramida nuk u bë dot muzeu i Enver Hoxhës, nuk u bë dot Qendër Ndërkombëtare e Kulturës, nuk arriti të bëhej dot Parlamenti i ri shqiptar, nuk u prish fare. Ashtu si me shumë gjasë e ka të vështirë dhe nuk do të bëhet dot kurrë Qendër Inovacioni, siç e propozon kryetari i Bashkisë Tiranës, por ka gjasë që me kakofoninë e zërave të mbetet një gërmadhë dhe kujtimi më i madh i gjallë i socializmit në vend.



PERBALLE SHIUT DHE ZJARRIT Ndaj Piramida duhet të jetë Bibliotekë Kombëtare

NGA BEN ANDONI

Vijon nga faqja 13

Larg këtyre, është koha që Ministra e Kulturës duhet të kapë momentin dhe të krijojë mundësinë që Biblioteka Kombëtare duhet të shkojë medeoemos në një vend, që i përgjigjet statit të sotëm të kulturës shqiptare. Apeli ynë i vazhdueshëm ka qenë të Piramida. Jo thjesht për hapësirën, por përgjithçka, që ky institucion paraqet. Në atë që mund të përcjellim në këtë apel, është fakti se kjo mundësi zhvendosje mund të përmirësojë jo thjesht punën e kësaj biblioteke që gjendet tashmë jashtë mundësive të saj, por i jep këtë institucion të gjitha hapësirat që të rivalizohet. Mbi të gjitha kuron simbolikën e Piramidës në një drejtim utilitar.

Është në nderin tonë, që me shkaktërimin e frikshëm që i kemi bërë këtij institucioni, siç ka ndodhur me Piramidën, të mos mendojmë ta kthejmë në një identitet krejt të ri. Të mendosh e bastarduam deri në nivele groteske duke i hequr pllakat mbuluese të mermerit dhe tentuam t'i zhvendësonim me pllaka keramike, nga ato që përdoren në tualete. E ndamë për lloj-lloj funksionesh. Më "guximtarët" e PD-së, përshirë kopolën e saj, donin ta shkaktëronin fare sepse quhej simbol i komunizmit dhe madje dolën lloj-lloj njerëzish që mbartnim argumente për prishjen e saj. U nis për salla teat-

ri, por nuk përfundoi dot, paçka se një sallë u ndërtua. Me shumë akoma, është bllokuar prej vitesh, pa asnjë lloj përgjigje nga instancat që e menaxhojnë. Derisa së fundi, ka ardhur ideja e kryetarit të Bashkisë së Tiranës për ta kthyer në qendrën më të madhe të teknologjisë në rajon. Ky është një paradoks i ri në zhvillimet tona, kur mendon se flitet për një vend që është i fundit për sa i përket zhvillimit ekonomik në rajon, e bash ky me këtë Qendër synon t'i paraprijë inovacioneve me zhvillimin e infrastrukturës moderne.

Nënkohë Biblioteka vuan mungesën e hapësirave të saj, kurse vetë Kryeministri, kohë më parë në postin e Kryetarit të Bashkisë së Tiranës, binte dakord se Biblioteka Kombëtare vepronte në kushte të pa përshtatshme. Dhe, zgjidhjet për të ishin nga më të habitshmet, ku theksojmë ajo që

erdhi me një plan rregullues (me konkurs ndërkombëtar) i cili e sugjeronte Bibliotekën Kombëtare të inkastruhej brendësisë së atriumit të Muzeut Kombëtar, duke ia shfrytëzuar të gjithë hapësirën brenda institucionit. Duke u ngritur si kullë, ajo do të dominonte Tiranën, por edhe do përshfaqte sipas ideatorëve fuqinë e institucionit. Paradoksi që vinte nga zgjidhja e arkitektëve të huaj e llogariste hapësirën e brendshme të muzeut pa funksion. Asokohe, atriumi i Muzeut Kombëtar shërbente edhe si vend muzeal për armët trofe të Luftës së Dytë Botërore. Po e Ramës si kryetar bashkie ishte edhe që parlamenti të shndërrohej në teatër kombëtar. Të tjerë dhanë alternativa të tjera, por të gjitha të diktuar nga politika dhe orekset e njerit apo krah të politikës.

Për fatin e saj tragjik, Piramida nuk u bë dot muzeu i Enver

Hoxhës, nuk u bë dot Qendër Ndërkombëtare e Kulturës, nuk arriti të bëhej dot Parlamenti i ri shqiptar, nuk u prish fare, ashtu si me shumë gjasë e ka të vështirë dhe nuk do të bëhet dot kurrë Qendër Inovacioni, siç e propozon Kryetari i Bashkisë Tiranës, por ka gjasë që me kakofoninë e zërave të mbetet një gërmadhë dhe kujtimi më i madh i gjallë i socializmit në vend.

Shiu dhe zjarri, që kanë qenë atë që afërt me Bibliotekën Kombëtare kohët e fundit por edhe bjerrja e sallave të këtij institucioni kanë sjellë si rast imediat, që këtij institucioni t'i konsiderohet si vend strehim vetë Piramida. Të paktën tashmë është harruar ajo habia që do krijonte Kulla e Bibliotekës brenda muzeut, teksa Piramida me hapësirat e saj arkitektonike, por edhe me aksesoret shtesë mund të bëhet një vend që të jetë destinacioni i dekadave të ardhshme të këtij institucioni. Bibliotekës i takon si institucion, një godinë që të përligjë nderin e Shqipërisë dhe asaj që fjala shqipe ka dhënë për ekzistencën e shqiptarëve.

Ndaj, shiu mund të quhet si ogur i mirë për kthjellimin e administratorëve të kulturës shqiptare. Biblioteka Kombëtare duhet të shkojë aty ku i takon pesha e rëndësisë së vet... te Piramida.



T

TREGIM

NGA KUJTIM DASHI

Metropoli i Veriut, bastioni i qytetërimit, djepi i kulturës, me një natalitet të pashterrshëm superlativësh krekosës, çfarë s'bënte askund vaki, si një portë hyrëse nga Jugu nga mesi i viteve 60' të shekullit të kaluar, kishte jevgjiti ose magjypët, tashmë, si për t'u hequr cipën pexhorative e, pse jo edhe raciste të rrallëshfaqshme, u thoshin egjyptianë. (U kishin gjetur një atdhe dhe jo sidokudo, por Egjiptin).

Dikur porta hyrëse kishte qenë shumë më e dinjitetshme dhe zëmadhe; bezisten, por atë e mbyllën heshturazi, e asfiksuari, e dergjen si vjetërsinë e së kaluemes, duke i shpronësuar dhe zhvendësuar me tregtinë socialiste, e rrëzuan përtokë dhe e shuan fare nga faqja e dheut, duke u përpëlitur të ngrenin si sfida moderniteti (!?) një park mbi një plagë të rëndë në shpirtat njerëzorë, pothuajse dyqind e pesëdhjetë vjet pasi që ndërtaur bezisten nga veziri Ibrahim Pashë Bushatliu dhe nami i tij rronte ende anekënd Europës sikur të ishte i gjallë. Parku, ende pa u bërë i tillë, me togje-togje hedhurinash dhe me ndonjë pemë në të rrallë, ngjante si shkretëtira e Gobit, që shakaxhinjtë e qytetit e kishin plotësuar me ndonjë zëvendësim fonetik bashkëtingloresh me emrin e së emës të kryetarit më të fundit të Komitetit Ekzekutiv, që kishte dhënë urdhër ta rrënonin përfundimisht, në emër të planit rregullues të qytetit (!?) Aq zëmadh kishte qenë bezisten si bërthamë e rëndësishme tregtare të metropolit të Veriut, sa vetëm pas pak vitesh, kur një studiuës i njohur spanjoll, i cili në atdheun e vet kishte kryer një studim të gjërë e të plotë gati shterrues e pat botuar dhe një libër për bezistenë e Ballkanit, sidomos në trojet shqiptare, si në Shkodër, Prizren, Berat, Prishtinë, pa i parë asnjëherë, por përmes dokumenteve të shkëmbimeve tregtare dhe arkivave të pasura e të paeksploruaru në vendet, ku kishte studiuar me zell të madh, kur iu krijua mundësia për të parë konkretisht atë monument dyqind e pesëdhjetë vjeçar, u çmerit fare që s'gjeti më as dhe një gjurmë të tij, as dhe një pllakëz përkujtimore për viktimën e ingorancës, le më ndonjë dhomë muze e ndonjë bezisten në miniaturë të improvizuar si një kujtim i rrallë shkëlqimi i një koha të shkuar. Asnjë therror, asnjë të rënë për mbrojtjen e tij nuk paskesh patur kjo mënyrë? –që interesuar ta dinte spanjoll. Si e lejuan vallë, si?! Bota s'i ka këto dhe i ngre nga hiçi, ju i keni dhe i hidhni në hiç! Pikërisht, në zgafllekujtesë, e kishte mbështetur i trishtuar edhe përkthyesi. Me copëra të bezistenit të shkyera a të shpëtuara gjallë qenë ngritur ca shtëpi jevgish në faqen e një kodrine mbi bezistenin e dikurshëm, një lagje e vogëlth me një mbi një dritare, në të cilat s'mund të gjeje goftë dhe një njeri i vetëm të hajrit jo të bënte ciceronin e një gjëme që kishte ngjarë pak vite më parë në sytë e tyre si hamej para se

Autori shquhet për humorin dhe sidomos përshtatjen e fabulave të ndryshme nga jeta në disiplinën e letërsisë. Njësoj ka ndodhur edhe me këtë rast, ku autori përcjell një realitet, që mund të jetë i njohur deri diku dhe bëhet edhe më i këndshëm kur ai e përcjell me elementët e duhur në tregim...

Spanjollit i përkthejnë thirrmenë “Kanë dalë planca!” ...

Në kujtim të Ramon Sanches Lizarralde

të mbërrinte spanjollit, por as t'i mblidhte dot disa mbresa a të dhëna, sa për t'ia shuar kureshtjen e përmasave të bezistenit, sidomos për mënyrën se si kishte rënë për tokë e sa kishte zgjatë kjo gjëmë. Pjesa tjetër e lagjes së jevgjëve që ngritur thuajse njëjtësisht po mbi një faqe kodre në anën tjetër përtej urës së lumit që buronte nga liqeni më i madhi i Ballkanit. Ajo ishte më e privilegjuar se kishte patur një xhami dhe ajo që kthyer tashmë në “ish”, si të gjitha simotrat e qytetit (edhe një me kupola prej plumbi), e rrezuar edhe ajo për tokë. Buzë liqenit, nën xhaden që të çonte në fshatin-plazh më piktoresk të të gjithë trevës ishte thertorja e madhe dhe e vetme e qytetit, ku herë branonin, herë blinin me çmim gati falas asortimentin më të lirë të bagëtisë, herë-herë u flanin këmbë bagëtish deri dhe palanca lopësh të vjetra apo qeshë tepër të dhjamosura që shoqet e qytetit nuk para i preferonin, nuk përballonin mundin për larjen e tyre dhe, në liqen e lum, nuk i linte njëri t'i hidhnin. Rrisku i jevgjëve që i ngjijnin në shtëpitë të tyre dhe bënin ndonjë festëz të vogël me faqoret me raki apo dhe shtynin javën duke ngrënë vëç në to, sa që prej andej patën dalë edhe shprehjet “jemi në javën e plancit shqiptar” apo “kemi hyrë në festiva-lin e plancit shqiptar” Spanjollit i tha shoqëruesit, ndërkohë që ia dhuronin me autograf librin mbi bezistenit e Ballkanit, të paktën të kisha marrë një tufë me lule t'i vija diku në ndonjë cep a themel ende të pafshirë. Ju vërtet jeni shkëputur nga kampi socialist, por mbase iu kanë mbetur ende zakonet ruse, pasi në Rusi, njerëzve u dhurohen lule, numri i të cilave duhet të jetë tek, sepse me numër çift çojnë në varrim... dymji e pesëqind dyqane bezistenit!...

Vetëm pasi kishin pirë në këmbë aranzhata me ca shishe të trasha, se s'kishte patur gjë tjetër të ftohtë, të cilat banakieri i kishte nxjerrë nga një kazan me ujë pa asnjë copë akulli brenda, vunë re se klubi sakaq u boshatis, sikur njerëzit që ishin deri atëherë aty ulur në ca tryeza me mbulesa gjithë njolla e karrige gjysmë të thyera, t'i kishte përpërë dheu. Banakieri, një barkmadh, që dukej se argëtohej me klientët e vet, duke i thirrur ap njerëzit e ap tjetrit, si të ishte ndonjë titull jevgjish, - të fundit i kishte pasë mbajtur vetë enkas duke i qerasur me razi, se janë të “grupit të entuziazmit këta”, domethënë hedhin parulla e duartrosasin si klaker, kishte sqaruar përkthyesin pa e pyetur fare ky, i ngucte të ngriheshin e të shkonin “të mbledhja”. Spanjollit ishte ndërjerë i afërt me ato tre-katër pijetarë si t'i kishte preo vendit të tij, nga rrethinat e Madridit. Edhe ata e lanë klubin e ikën me ngut e qejf të madh, duke e përshëndetur të huajin thuajse horazi “Hasta la vista!” Dhe spanjollit ua ktheu



sakaq “Hasta la vista!” Pse e njohin spanjishten? pyeti studiuesi. - Jo, jo është titulli i një romani të një romancierit tepër të njohur tonit, i cili ka qenë Luftëtar edhe në Luftën e Spanjës. Rron? Si nuk rron, por në mendjen e popullit se qeveria e ka bërë lanet, duke e vuajtur herë pas here në një kalvar vuajtjesh e mundimesh të pamërtuara sa që mund të jenë të paktë ata që e dinë se është gjallë, guxoi dhe sqaroi shoqëruesi. Simpatia për Petro Markon, bëri që ta tejkalonte protokollin, po s'e vrau fort mendjen për të. E kishte bërë edhe herë të tjera me të, duke ia treguar realitetin aq, shpesh me humorin e anekdotat e panumërta. Pse s'hua se qenkesh edhe Metropolit i humorit? tha studiuesi, që dukej ashiqare se i pëlqenin. Po në këtë qytet të gjithë këndonin!- shtoi përkthyesi me mburrje e nostalgji. -Ishte shok me Heminguein, - ia bëri përkthyesi si njeriu që do ta përplotësojë figurën e atij që adhuronte. Përkthyesi ishte pedagog i spanjishtes në Universitetin e Tiranës, një autodidakt, që kishte vetëmësuar shtatë-tetë gjuhë të huaja dhe, në po kaq gjuhë përkthente lirshëm literaturë dhe ishte i mjaft i kërkuar. Rrënjët i kishte në atë metropol, madje një rrugicë andej nga stadium i qytetit, ende thirrje në mbiemrin e tij të njohur, por prindërit e tij në kohën e mbretërisë kishin vajtur të punonin e banonin në kryeqytetin më të ri të Europës dhe s'qenë shku-lur më që andej.

- Duket sikur është zbratur e tërë lagjia, vetëm fëmijë, duke lozur të zë syri, - konstatoi spanjollit, pasi pak më parë lagjia ziente. - Kemi ardhur në një kohë të përshtatshme, - ia bëri shoqëruesi. Dhe, papritur pyetjen “Pse?” të spanjollit, sqaroi: Vendi është në një fushatë elektorale, madje sot këtu në një sallë të madhe, ka ardhur kandidati për deputet... - 199.99 përqindshit, ironizoi spanjollit, pasi në mes tyre tashmë ishte hedhur ura e sigurte e komunikimit dhe besimit reciprok.

- Pikërisht, por veprimtaritë në i bëjmë në rregull, shumë korrekte, demokratike... - E cilin paskan kandidatit të 99.99 përqindshit lagjia e jevgjëve? Përkthyesi ngurroi një copë herë dhe, më pas i tha: - Zëvendëskryeministri dhe ministri i mbrojtjes, B.B. - Edhe ky në Spanjë? - Ç'ne, - ia bëri përkthyesi. - Kur atje mbytej Republika ky rregullonte qepenat e dyqaneve në kryeqytetin tonë. Dhe të tim eti? - Tregtar? - Jo, jo menxher babai te një tregtar nga ky qytet, por që ushtronte aktivitetin e vet në Tiranë, në rrugën më moderne të kohës, që i kishin dhënë emrin i Mbretit. Këtu në bezisten, im atë, atëbotë dhjetë vjeç, si jetim çirak, nisi të marrë mësimet e para të tregtisë... Pastaj vajtën në kryeqytet, ku linda unë... - Zëvendëskryeministri dhe ministri i mbrojtjes, B.B. kandidon në një lagje jevgjish?! Numri dy i qeverisë do të shpalojë para tyre programin e Qeverisë për mbrojtjen?! - u çmerit spanjollit si për të dashur t'i përmbahej interesimit të tij të papritur dhe t'ia frenonte kujtimet shoqëruesit të vet nostalgjik e erudit, i cili i kishte dhuruar romanin “Komisionin e festës” në frëngjisht të Ismail Kadarese, pa emër përkthyesi në frontespis. - Vota është e barabartë si këtu, si në zemër të kryeqytetit a në Akademinë Ushtarake, ndërhyri përkthyesi me takt pasi u ndje i fyer nga shpërfillja e, pse jo, dhe racizmit i mikut. - Ok, por sidoqoftë!-gati mërmëriti spanjollit. Si pa e kuptuar i ishin qasë sallës kur mbuajër takimi elektorale. Pak më tutje ishte zyra postare e lagjes. - Mund të asistoj për pak kohë? Më intereson. S'dua ta humb këtë rast. Jam që jam, të shoh një 99.99 përqindsh qshiptar ia bëri spanjollit duke nëngeshur... - Si rregull, nuk lejohet, por do t'u them rojave se je një shok marksist-leninist nga Spanja. Se mos do të dijnë të dallojnë Sanchesin, përkthyesin e veprave të Udhëheqësit tonë në një shtëpi botuese shtetërore e folësin e spanjishtes në radion kombëtare me ty. Sanches ai, Sanches ti. Kështu e ke në pasaportë apo jo? - Të lutem, se mos kërkojnë t'u flas, në qoftë se e marrin vesh se jam nga partitë marksiste-leniniste motra, si mbështetje - iu lut spanjollit duke nëngeshur sërish. Apo nuk iu ngajz dhe nga lekura!.. Hynë në sallë dhe u ulën në karriget e fundit të saj, në kohën kur kandidati për deputet po fliste gjithë pathos për sukseset madhështore të arritura në tërësi dhe, sidomos në fushën e mbrojtjes: topat, tanket, avionët, grykat e zjarrit, mbrojtja kundërajrore, bunkeret, gjithë populli ushtar... Ne kemi ministri mbrojtje dhe jo luftë! - i vuri në spikamë përkthyesi mikut spanjoll. Historia nuk njeh qoftë dhe një rast të vetëm që ne të kemi sulmuar ndokënd. Përkthyesi s'bente përkthim simultan por bente herë pas herë përmbljedhje ose një rezymë të shkurtër të asaj ç'ka kumtonte kandidati. Spanjollit i bëri përshtypje varfëria e tejkajshme e njerëzve në sallë, fytyrat e tyre të rëguara dhe, sytë i mbetën te njëri në panel i bardhë dhuruar romanin “Komisionin e festës” në frëngjisht të Ismail Kadarese, pa emër përkthyesi në frontespis. - Vota është e barabartë si këtu, si në zemër të kryeqytetit a në Akademinë Ushtarake, ndërhyri përkthyesi me takt pasi u ndje i fyer nga shpërfillja e, pse jo, dhe racizmit i mikut. - Ok, por sidoqoftë!-gati mërmëriti spanjollit. Si pa e kuptuar i ishin qasë sallës kur mbuajër takimi elektorale. Pak më tutje ishte zyra postare e lagjes. - Mund të asistoj për pak kohë? Më intereson. S'dua ta humb këtë rast. Jam që jam, të shoh një 99.99 përqindsh qshiptar ia bëri spanjollit duke nëngeshur... - Si rregull, nuk lejohet, por do t'u them rojave se je një shok marksist-leninist nga Spanja. Se mos do

Nuk guxoi t'ia tregonte këtë aludim. Në sallë kishte rënë një heshtje si prej varri. Me sa duket ishte koha, kur do të ngriheshin njëri pas tjetrit të përgatiturit për t'u solidarizuar me kandidatin 99.99 përqindsh, kur befas u hap pakëz dera e sallës dhe, një djalosh jevg i pashëm si një Raxh Kapur që ishte në modë në atë kohë, futi kokën brenda dhe thirrmoi sa mundi: - Kanë dalë planca!... Një nga rojat e sigurisë e shtyu fort dhe ia mbylli derën në turi, por Raxh Kapuri i lagjes matanë urës mbi thertoren e vetme e të madhe të qytetit, bëri si bëri dhe s'vono shumë, e shtyu prapë derën dhe thirrmoi sërish: - Kanë dalë planca! As vërshim, as shpërthim dhe as sado ta vrasësh mendjen, për të gjetur një mori sinonimesh të tjera, qoftë edhe me sintagma, absolutisht asnjë, s'mund ta shprehin e ta jepnin të plotë atë shpërthim njerëzor që ndodhi në ato minuta brenda sallës. Një llavë e zezë sikur të kishte dalë nga katakombet e Parisit, gjeti dështedhësit të rrufeshme për në derën e jashtme. Sikur të mos ishte thirrur “Kanë dalë planca”, por tërmet, tërmet pasi kush e kush më parë të kapte derën e të fluturonte jashtë, të shtynte, të shtypte herë njërin e tjetrin e të shpëtonte kokën e vet, sikur i ka sulmuar ndonjë dem, mendoj spanjollit, mjaftonte që të mbërrinte më i pari te dyqani i mishit, ku sapo ishin shkarkuar plëncat nga thertorja matanë urës. Përkthyesi dëgjoji dikë që thoshte se të gjithë atë sasi plëncash e kishte pasë porositur e likujdhar vetë kandidati për deputet, ose s'çi tha miku nga Spanja 99.99 përqindsh, por defekti u dha aty ku nuk e kishin parashikuar; lajmimi u bë tepër para kohe, i pansinkronizuar me panelin, si një akt i pastër sabotazhi elektorale... - Ç'patën kështu që ia zbrazan sallën kandidatit? pyeti spanjollit i hutuar, duke çelur një shteg që të mos e merrte edhe atë përpara turma. Përkthyesi ia përktheu besnikërisht thirrmenë dhe nëngeshit. - E kanë specialitet të tyre? - Ç'specialitet, i dashur Ramon, është ushquji bazë dhe më i lirë për ta, tërë jetën kështu. Më kot priten rikthimin e njerëzve në sallë. Nga jashtë vinin zhurma, shamatosje, hare fukarenjsh... Kandidati 99.99 përqindsh pa ç'pa dhe, pasi u konsultua një copë herë më panelin a presidiumin e takimit elektorale, u ngrit si nja njëqind e tridhjetë kg burrë dhe doli jashtë në një sheshpushim të vogël prej nga zbrisje poshtë me shkallë i ndjekur nga pas nga shpura e tij laramanor. Te dera i tha njërit prej organizatorëve të takimit elektorale: Di gjë, kush ma dhjeu kështu në këtë farë feshë takimin?! Pse u lajmuan para kohe? Kush ma bëri, kush? Mos kij merak, shoku ministër, se do të merremi me tani mirë me Kolin e Dijes, është i dymbdhjetë fëmijë i nënës heroinë, Dijes së Refazit, të vetmit partizan që pati lagjia jonë, por ç'e do iu ka dalë dorët, vagabondi... Sikur e ka mësuar kush?! Si nënë heroinë, sipas ligjit, i kemi dhënë edhe lopën, që i takon në shtëpi, pa. Kemi pesë si ajo që kanë përfituar lopën, nga dymbdhjetë fëmijë... Mos mirënjohësit!... Na falni, shoku zëvendëskryeministër dhe ministër i mbrojtjes popullore! Herën tjetër kur të vini do të hanë ma fenë e t'et planca. Vetë ia hoqën rrisikun vetes! Tani në rresht për një si delet, do të votojnë për ju!... Në “Fshatin e Paqes”, 2003, vjeshtë, Shkodër.

P

POEZIA

Ky është një cikël i ndërtuar mes një urimi dhe një mallkimi detar; si forma politonike dhe monodie të autorit që sjell një fllad interesant të poezisë bashkëkohore shqiptare. Gjendja poetike, me jo pak nota epike, përcjell disi paradoksin shqiptar të çerekshekullit të fundit...



NGA ARIAN LEKA

Mallkim detar

Ti që shkel dallgët e mia, t'u sterroftë djaleria...!
Varkë e vogël, varkë e rëndë të hyfshin dallgët përbrenda...!

Dru i ngopur, ashkël, kleçkë, dalsh e rëncë nëpër ngrica!
Remin e gjatë, drekun e mesit, i përdorsh për palerica!

Real Taste and Zero Calories

Kur era lëshoi drejt nesh kosat, kosoret, këllëçët, hanxharët
Fruta kokeprera sollën perrenjtë me rrethda lërthore
U rrokullisen nga lart dardhë ftonj shegë dhe trush kumbullor
I mbyturim notoi drejt shtëpisë – mbylli dritaret

Në të njëjtin rrjetë me peshqit fytyra jote pa frymë
Në fund të delit, me pishtarët dhe sytë e shuar ranë unazat stollitë
Era shpëlan sëpatat në shkumë. Fruti paguan për farat. Etër e bij
Ndjene thartirë në herdhë filluska në gjak mes gjendrave helm e pështymë

Në drekëmortin e tij i mbyturim mungon – dëgjon vajet në largësi
Lëpin inoksin e lugeve marrë hua në mëhallë të gllonët
Druri i tabullit qirinjtë shandani i pastruar me fije
Pëlhuira e lirë e kostumit në arkivolin pa trup për të s'ka rëndësi

Dëgjon bisedat për kafen e zezë – mbipeshën – cigaren dhe blözën
- Ruhu nga helmet e bardha. - Hallva kapet me dorë. - Ka rryma Kanali
Turisi nga vendet me diell të ftohtë kap portrete pjesë rituali
Dhe nxjerr nga gota bletën e gjenijer nga ëmbëlsi e fruktozes.

Forever young. Sugar Zero. Caffeine Free.

Nën det gjendet kampi i përqendrimit të njerëzve të mi.
Te përkohe: nuk u ndihet zëri nuk hanë nuk pinë nuk flasin keq nuk flenë nuk bëjnë
dhurata nuk bëjnë seks nuk marrin në telefon.
Emigrojnë nga njëri në tjetrin breg për t'u bërë qoftë dhe të mbytur anëtarë të EU
Citizens Zone.

Iso - polifoni

...Tre muaj nga dita kur i mbyturim u kthye në shtëpi.
askush nuk fuli peshk të freskët në gojë.

ishin ushqyer me mishin e njerëzve të mi.

fisi im ha mollëzat e gishtave për plojen.
vendos midhje të zeza mbi sy.

ushqehet me thonj.

trumcakë fluturojnë në qiellzën e gojës - ulen mbi kordat e tua zanore.
lule kripe mblodha nga gjendrat e thara të lollit.

me harqet e vetullave ti preve mermer të zi në gurore.

kater vellezër peshkatarë hodhën vaj ulliri mbi det.

Mare Mortum

të zbuten dallgët. - mos i shkel të mbyturit me varkën fundore.

u bënë bujq. mbollën njerëz në tokën ku breshkat

liriqet dhe gjarpërinjtë flinin ende. lutën shiun përgjithmonë të largohej
dhe kërkuan ndjesë pse prishën sfondin me pamjet e Shqipërisë (fu)turistike.

regjisorit i Miss Albania bëri një dubel i ri përpara fillimit të sezonit.

sy njerëzish pranë sytë të sepjeve dhe kallamarëve në rrjetat plot.
nuk ishte hënë për gjueti. për ta gjenijer vdekjen me këngë politonike – vonë!

për ta mëkuar vdekjen si fëmijë – kot!

Lule me postë

Veshtrimi i vrazhdë i rojës detare u ngul si ushtë në ijtë të anijes dhe fundosi
shpresën tënde për një varr brenda sytë të mi. Në vend të kostumit detar me
timonë, spiranca dhe vija blu, emigranti vesh *salvagente* ngjyrendyshku zberdhur
nga dallga. Anijet kthyen obllat nga lajmet me shqiptare të mbytur në brigjet e
Italise.

Detyrat janë ndarë. Mjeku ligjor përcaktonte fundin e udhëtimit. I mbijetuari me tuba
dhe maskë oksigjeni në gojë – ai që ngjan me zhytësit amatorë - drejt *pronto*
soccorsa-s. Kufoma në thes mund ta vazhdojë udhëtimin drejt morgut. Dikush
kontrollon xhepat dhe nxjerr një celës.

Nuk i shkon mendja të kontrollojë edhe thonjtë. Prej aty, me fare pak kujdes, mund
të mblodhë rërë e pastër nga ajo që prodhon xham të mirë për drilare dhe syze e
lente për teleskopë hapsinore.

I mbyturim im përvesh mëngët zhyt krahet si rrema të gjatë nëpër shtëllunga resh,
rijelloj si e ëma kur zhyste duart në brumin e bukës dhe mbërrin më pranë nesh. Na
gjen ashtu siç na la tekta grindem pa fjalë duke kaluar dorë më dorë një fotografi ku
ai na puth me dorë nga larg.

U kthye për të na thënë se nuk i kujtohej se ku e kishte fshehur testamentin që e
ndante me drejtësi mes nesh varferinë, se nuk duhet t'i bënim funeral e se nuk duhet
ta shpallim as të zhdukur në det për të përfutur ca muaj ndihmë sociale.

Rrugicat e vjetra në Durrës bien një e nga një me shirokun e shkretëtirës siriane
ngulur pas shpine dhe përmes erës sjellin të mbytur që para se të mbërrin në
varrezë kthehen të fshijnë emrat e prindërve nga listat e ushqimeve hua. Emrat e
alyre që vijnë të varrosen në vendlindje qëndisen me pe të bardhë mbi mermerin
e brigjeve veriore të Afrikës dhe të ishujt shkëmborë të fqinjëve.

Kujtesa e regjuri me taninë gëshenjash nuk prodhoi lëkurë që e kthejnë shpejt të
mbyturin tim në shtëpi. Në kodra, pranë farit detar kujtesa mbledh lule mërsine për
belimet e thyera më shumë se sa gotat e dasmave nga të dehurit me gëzim.

Me postë online dërguan emigrantët trëndafilat të kuqërremtë për prindërit që vdiqen

të mbështetur të vetmia a gjatë. Monedhat 2 euroshe me fytyrën e Dantes dhe
Europa e rrembyer nga Zeusi u rrokullisen nga xhepi mbi qilim kur punonjësi i
morgut ktheu teshat e palosura dhe zgjati procesverbalin me fjalët "vdekje natyrale,
për shkak të moshës".

Fëmijët e bregut jugor të Shqipërisë

Natën e rënies së yjeve në gushit Fëmijët nuk hedhin lule mbi det.

Të vegjllit fare i gënjym U thamë se të mbyturit mbillen si fara në tokë.
Pakashumë si monedhat e arta që Pinocchio futi në dhë.

Të mbyturit në det janë qindarkat Në fund të kutisë së kursimit.
Prej të mbyturit diçka mund të fitosh Nëse ndjek kursin njerëzor të këmbimit.

Kur shtetet të nënshkruajnë Marrëveshjen e rialdhesimit
Mes të mbyturve tanë Dhe të mbyturve fqinjë do takohemi më shpesh.

Veshur me thasë të zinj me zinxhirë Të ngjashëm me kellefat Hugo Boss
Oë ruajnë kostumet nga pluhuri dhe nga rrezet ultravioleat.

Në hambarin e avionit arkivolet - frigrifer Pikuan mbi dhuratat
E valixheve me rrota I mbyturin nderon radhën Me qetësi e durim pret
Një shqiptar Një evropian Një i mbytur shoqëruar me dossier dhe eskortë:
<< EU PASSPORTS - MAJTAS • DJAHTAS • ALL OTHER PASSPORTS >>

Hartë memece

Në varrezën detare, kur u mbytet ju.
Ne hapem varre.
Mbollem zambakë blu...

Mbyllem kriporet.
Vdekja të mos hyjë në gjellë.
Pa fjalë vajtoret...

Vdekja di not.
Fsheh thikën në squetull
Prithëm kot...

Vrimë në det

Deti kishte qenë e çara që futi ujë në bibliotekën e shtëpisë. Përmbytja e madhe.
Cili autor duhej shpëluar nga mbytja? Cili libër nga fundosja? Hygoi shkoi në fund
bashkë me Marsejezen. Lufta dhe Paqja u lodh duke notuar. Servantesi u mbyt në
dallgët e bibliotekës së tij. Stalini ishte i vrazhdë si dallgët në detet e ftohtë. Guliveri
nuk e mbante gjatë frymën nën ujë. Marksi me kapakët e trashë blu ishte obez për
stomakun e zbratur në mes dhe dy veshkat e dy koqet në fund si rregullator
peshash.
Futa ajër në mushkër për t'u zhytur brenda aortës. Mes librave të vdekur (rrethuar

...nga numri i shkuar

"Milosao" e këtij numri ishte relativisht e thjeshtë. Shkrimi kryesor ishte shumë i gjetur dhe jashtëzakonisht interesant dhe na u afrua si ide nga një njeri i biznesit të letrave por që nuk donte të dilte në publik. Habitsmërisht, kishte frikë se do ta ngacmonin prej biznesit. Nëse ky mentalitet është deri te njerëzit e librave, atëherë duhet të mendojmë se diçka nuk shkon realisht me ne shqiptarët. Redaktori, fotokopioi vetë në Bibliotekën Kombëtare përmbajtjen e "Shqipëria e re", ku gjendej materiali. Fabula ishte e thjeshtë: një arkitekt nga Opari i Korçës kishte paraqitur në vitin 1932 planin e një teatri kombëtar shqiptar me arkitekturë shumë interesante, me një ide shumë klasike për strukturën, por edhe në një shikim më të kujdesshëm edhe modern për Tiranën e asaj kohe, që po merre imazhin e një qyteti bashkëkohor. Një arkitekt shqiptar me banin në Romani në vitet '20-'30 kishte gjetur vendin dhe kishte gati projektin e Teatrit Kombëtar të Shqiptarëve, paraqitur në Fakultetin e Arkitekturës në Bukuresht. Ai, "çuditërisht", korrespondon me atë ku ndërtuan italianët, por synimi i tij, ishte që ky objekt të ishte mbi të gjitha godinat e tjera të cilat po bëheshin përreth. Ai kishte menduar t'i jepte të gjithë rëndësinë e duhur në komplekset ndërtimore që po zhvilloheshin asokohe, ndërsa mendonte deri për një Tiranë të shumë kohëve më vonë. Nuk kemi mundur ta gjejmë projektin, që me siguri, duhet



të jetë diku, ndërsa skica të tij ruhen me koleksionet e organit "Shqipëria e Re" në Bibliotekën Kombëtare. Në këtë numër vazhduam shkrimin e Gjon Markut për Skënderbeun. Ndërkohë, në stilin e zakonshëm gati kozmogonik të Moikom Zeqos erdhi një cikël i propozuar nga vetë autori, pjesë e librit të porsabotuar poetik "Këmbësori poetik"... Ndërkohë që në këtë numër patëm edhe një fragment të romanit "Fermani i përgjakur" të autorit Vasil Premçi, që i kushtohet një teme, të cilën autori e ka evidentuar qartë si qëndresa. Redaktori shkroi se: Ndoshta mund t'i kufizonte pak evidencimet e kohës për ta thjeshtësuar punën e lexuesit, por që e ka prekur pak vepren e vet. Personazhet janë shumë të lexueshëm prej pozicionimit të narracionit. Maks Velo, në kuadër të cikleve të tij dedikuar udhëtimeve dhe perceptimeve të muzeve ndërkombëtare, na ka sjellë frymëzimin e tij para modeleve imagjinare, mu ato që kanë frymëzuar në kohën e tyre Matisse dhe Pikaso. Vetëm se në ndryshim nga mjeshtrat, ai mundohet të penetrojë natyrshëm stilin e tij dhe të jetë sa më afër vëzhgimeve të mjeshtrave, kuptohet me erën e vet. Patëm shumë pakënaqësi për botimin e skicave të tij, por redaktori e mori me sportivitet. Ai, vetë, shkroi se: Duket si një ushtrim, por në këtë rast, Maks Velo e përdor për të shjuar mrekullinë e artit botëror dhe për të dhënë përmes vizatimit reagimin e tij instiktiv ndaj kryeveprave... Në përgjithësi mund të themi se ishte një numër relativisht i këndshëm por fare i zakonshëm.



nga shishe e qeska plastike, nga lodra të mbushura me rërë, leshterik apo flokë të prerë, këpucë të ngopura, fatura pa numra, pantallona me xhepat plot ujë, ventilatore si diej të mbytur, anijeve gjithë ndryshk, mes shalqinjve të shpuar dhe gjithë faunës dhe florës detare që merr frymë me vëlëza dhe thith oksigjen të shtypur, notojnë personazhe e tituj kufomë, krijesit e të cilëve janë ende gjallë në erëminin antologjik të dafinave) zhytja është frikë. Librat janë femijet e vrarë prindërve heronj. Nga çasti në çast prej fletëve mund të zgjaten duar që të zhyzin dhe me siguri për shkak të shtimit të nivelit të dioksidit të karbonit në gjak, mendoj se mund të kishim pasur tjetër histori sikur autorët e librave të kishin ikur më parë dhe librat të mbeleshin gjallë ose sikur të ishin larguar pa e parë mbyljen e librave të tyre me sy. Librat e mbytur lëshuan rreth meje embrione shkronjash dhe fjalë këlyshë pa sy. Dikush mbuloi me gisht vrimen me ndryshk që plumbi i kishte lënë mbi gjoks dhe nxori një gjerdan filloskash nga hunda. Një lletër mbuloi me pe të kuq vrimën që dekorata e artë i kishte lënë mbi jakën e xhaketes. Luzmë meduzash drejt bregut për pëllimin janë librat që ranë më ngadalë sesa rendi shoqëror fundosur pasi na siguroi plankton iluzionesh dhe ideologji për vite pritjesh të kota. - Ç'ka përtej? - Ata që punojnë, mbajnë token në krahë. Të tjerët qeshin...! Fytyra e poetit kombëtar palosur më dësh mbi kartmonedhë veshtron. Edhe sot ai do paguaje për të gjithë në kafenenë buzë delit. Do paguaje një golë verë. *Shest /Z/ per mua: një Asgjë të madhe për ty që do kesh varr me fotografi në kujtesë: do të lere edhe 10% bakshish për ata që nuk lahen në ujëra të ëmbël, por në djersë.*

I mbyturi im

Në ranishten e zbehtë fare në fund, deti nxjerr trarë gjithkund. I shtyn, i lërëq deri në mëngjes pisharet shuhen nga shkulumet prej vesës. Shpirtrat e mbytur nemilen mbi kur kurorë algash mbi krye nuk ditëm aq shumë. Trungje të trashë për të djegur vetminë, thirrëm emra, nuk dëgjuan, kuptuam lotët pse bien. Lundrimet u fshinë në matrikullin detar trungjet njohën shtëpinë

njohëm njerëzit tanë.

I huaji në detin tim

Ndërtimi i mendjes mbeti punë më e vështirë se ngritja e murit prej dallgësh ndarëse dhe telave me dhembë në Mesdhe. Si filloskat e ajrit plasen urimet, përshëndeljet dhe dëshirat e mira të presidentëve. U bëme gjallesa me gjak të ftohtë, zemra transplantë të ngjira, kur mësuam se Vdekja është ksenofiliqe, na puth të gjithëve, na bën frymëmarrje artificiale gojë me gojë

Ditën kur gjithçka u var në çengel dhe kur nga endrrat kulloi gjak, ia rropëm lekurën delit tonë, e tërëm mbi ltegjulla, e varëm në trarë dhe pamë tekssa nga goja peshty miza peshku. Me silë vrimash të imta ndamë ata që dolën në breg për të ndihmuar të mbyturit nga ata që, me telekomandë në dorë, ndryshuan stacionin televiziv për të mos e bashkuar endrën e tyre për pushime në një vilë bregdeti me dritare nga lufta me makthin tonë për t'u dhënë të mbyturve tanë një veshje që mbulonte shenjat e kafshimeve në trup

Mare Nostrum – Mare Mortum. Të huajt zgjodhën delin tonë për varr. Nuk grinden për detin, por shefillin kontinental ku mund t'u shkruajmë emrin dhe t'u mbjellim fare. Me të mbyturit marrëdhëniet janë dhanore. Zanoret lakohen njelloj si emat tanë. O – për dhimbjen. U – për atë që nuk u kthye kurrë A – për ndarjen

Me alga mbyll veshët i mbyturim tim. Të mos dëgojë folëset televizive tek grinden si grajet se kush do e ketë syrin e vetëm mbi ballë dhe për lajmin e kufomës së shpallur kampion se mbërriti e para në ranishten tonë. Pikën e fundit të ujit që era solli mbi kuvertë dhe fluskën e fundit të ajrit të tretur në ujë i mbyturit i huaj e ndau me të mbyturin tim. Pasiq ranë në fund. Shterruan. Njelloj si rezervat e hekurit në gjakun e zbehtë të talasemikëve mesdhetarë. Shpirti del të rrenjë, nxjerr gjelhe butake, gjemba të shkurtër, jo lule.

Damar i prerë

Ka mbetur larg ajo natë kur pashe në ëndërr vendin tim. U derdh nga matriarkali në det. Shtrirë dhe tendosur, ngrohu vezë dyzetë ditë e dyzetë net derisa prej trupit dolën varka ngarkuar me lumenj me djem të mbytur në det dhe me vajza të vrara nëpër botë.

- Ç'i deshëm lumenjtë pa djemtë tanë, Adria?
- Ç' duhej begatia pa vajzat?

Asnjë luftë nuk kishte ndodhur për faqen e parë të gazetës.

Mban mend? E mban mend atë natë?

Nënat mbyllnin veshët me re. Me lumenj i lidhën burrat damarët e prerë.

Veshët dëgjuan dhe ne mbajtëm mend me sa drejtësi u ndanë hiset e botës:

- Ajo që është e Tokës, edhe e Delit do jetë!
- Gjithçka është e Delit, s'mund të jetë dhe e Tokës.

Njolla

Brenda poetit është një burrë - pastron njollat në lekurë. Brenda burrit një kalshë - pastron lekuren gjithë afsh. Brenda kalshës deli rri shtrirë - fle jashtë me trafikantët.

Trupi i marsit doli i ngrohtë prej stinës së ngjirë. Si pulpa e bukur e vajzës prej çizmes plot ballë.

Dimri blegëriu. Vuri kokën mbi gur të filijmit dhe u duk sikur tha:
- Te mbuloj kryet që tani me kërcëjë rëre prej Afrikë?
- Apo të mbulohem më vonë me argjilë të bardhë Mesdheu?

Ngushellim vjen nga helmet siç nga mjallti rrjedh vdekje - djersë - gjak - ballë.

Shlangur me sgepin futur nën gushën e maleve rri ky vend. Sheh veten pasqyruar nën det. Territori rënduar nga mermeret. Nuk gjenden në hartat topografike. Banorët nuk jetojnë mes rrenojave. Të fundosura anilke ku notojnë emigrantë që shkuan në fund. Ngaqë buka e patretur peshoi në stomak.

Nga toka erdhi vera sivijet. Durim shkrinë në farkë. Në kodra mbinë lule. Në det dallgë.

Plumb Bakër Ar Dyllë

Anija e regjistruar me emër tjetër Me tjetër pronar dhe ekulpazh multietnik Mban ende në bord librat e tim eti, në rrafsh e gjelbër Lyer dy duarshe me antindryshkun më të lirë.

Me fletët e librave detarët zunë vrimat e obllave prej nga fulej era. Me libra pasrojnë duart, fytyren nga vaji i zi. Peshkun e kapur në ujërat e porteve, Ku bashkë me fekalet pluskon mërzi, peshkataret e fusin si ndarëse mes kapitujve.

Nuk ka rëndësi se ku ndodhesh kur biblioteka shpërthen si bombë në mes të shlepëve. Të gjithë do stërpikemi prej shpërthimit të librave të rremë. Nga plasja e shkronjave prej plumbi do përullemi. Nga rrenjë e flokëve të thonjë, flokët e mjekrat e zbutura me krem. Do ndihemi pis dhe nuk do pasrohemi dot edhe sikur ta fërkojmë trupin me fletë të bardha, pa shkronja, pa pikë, pa presjen e mprehtë si kosë dhe pa sidomos pa ato thonjëz.

Vdekja nga fjalet e ndotura kishte qenë çështje doze. Njerëzit me ulçer dhe diabet zgjodhën plumb-pluhur në qeska të vogla. Një miligram i përditshëm me lituj bold, lëpirje gishtërinsh pas leximit të gazetës. Të tjerët vdiqen nga mbidoza e shkronjave të plumbit nxjerrë nga minierat me të burgosur politike, ku kishte krom të pasur me ar për stoli e medalje heronjsh, bakër për antenat televizive dhe plumb për ata që nuk kënduan himne e që e dinin se plumbi i shpërndarë në shkronja, nëpër paragrafë e mbi faqe librash, ishte arma sekrete e shfarosjes në masë, varr me rufepërtes.

Urim detar

... dhe sa më pak pafshi...

zonjusha me vel prej këрпи

dhe anije me vela mëndafshi...!

R
RISIA

Nga data 2 korrik deri më 7 korrik 2018, shoqata "Art-Im-Pulse" organizon në kinemanë e Pogradecit edicionin e VIII të Festivalit Ballkanik të Filmit dhe Kulinarisë (B3F), i vetmi aktivitet kulturor ndërballkanik në Shqipëri. Marrin pjesë me krijimit e tyre qindra artistë nga të gjitha vendet e Ballkanit. Gjatë këtij edicioni do të projektohen 75 filma të gjinive: metrazh i gjatë, i shkurtër, filma eksperimentalë, filma të animuar...

Një festival për Ballkanin, kulinarinë dhe të rinjtë

NGA BEN ANDONI

Para 8 vjetësh, një grup i pasionuar artistësh, gazetarësh dhe njerëz të fushave të ndryshme por me interesa kulturore të mëdha, inician një festival ndërkombëtar në qytetin e Pogradecit. Pa shumë bujë por me një interes mirëfilli për të shtuar jetën kulturore të Shqipërisë, ata me kohë i shtuan dhe atributet të tjera krijesës së tyre, në përshatje me kohën dhe realitetet. Merita e tyre ishte se fokusin e drejtuan drejt Ballkanit dhe sidomos brezit të ri.

Në veprimtarinë e tyre ata kanë përfshirë shumë elementë, që fillojnë nga workshop-et me personalitete, përcjelljen e traditave dhe shfaqjen e filmave në kategori të ndryshme. Falë të gjithë këtyre elementeve, Shoqata Art-Im-Pulse, e cila e menaxhon këtë aktivitet, e ka kthyer qytetin juglindor në një qendër kulturore në muajt e verës dhe më shumë se kaq në një pikë tërheqje turistike-kulturore.

Një nga gjetjet më interesante

të aktivitetit është që kultura e këtij festivali ka gjetur pika përkimi me kulinarinë dhe kjo e fundit është shtylla e dytë e identitetit të këtij festivali dhe ndoshta ajo që i jep një përcjellje shumë interesante por edhe tërheqje.

Në vitet e ekzistencës së tij dhe në përpjekjen e madhe për të krijuar traditën, ajo është përballur jo thjesht me vështirësitë e zakonshme financiare të realizimit, por edhe shpesh me përpjekjet e organizatorëve të saj për të qëmtuar përmbajtje sa më bashkëkohore për aktivitetin e vet.

Të rinjtë është një nga elementët shtesë dhe tepër identitar të aktivitetit, që edhe në këtë edicion kanë jo thjesht pjesëmarrje, por edhe përfshirje të plotë. Tek e

fundit, një nga qëllimet e organizatorëve është jo thjesht zbutja e barrierave të vendeve të Ballkanit, përmes projektimit të filmave, por përfshirja e tyre. Dhe, realisht duhet vlerësuar ideja që pothuaj çereku i prodhimeve janë produkte të të rinjve nga shkollat e filmit në Shqipëri, Ruman, Serbi, Maqedoni etj.

Po ashtu, në një formë organizimi modern, është gjetur ideja e inkurajimit përmes projekteve të

prezantuara. Kështu, p.sh. "Balkan Story", formati i ri, do ketë konkurrimin e tetë projekteve, që do të prezantohen nga vetë autorët dhe Juria e festivalit do të përzgjedhë fituesin, i cili me skenarin e tij fitues do ketë mundësi të zhvillojë projektin.

Nga ana tjetër duhet të theksohet se kohë-organizimi i këtij aktiviteti përkon me kohën kur qyteti i Pogradecit kthehet në një pikë

shumë atraktive turistike, ku duhet llogaritur se atributet kulturore-kulinarë të tij i japin një rëndësi të veçantë. Dhe, e fundit, organizatorët kanë menduar si për çdo vit që të ftojnë një grup artistësh të njohur të vendit, që janë figura ikonike të kulturës dhe me anë të të cilëve shpalolet dhe kujtesa e gjallë e kulturës së vendit.

Grupi i ngushtë i organizimit, i përbërë nga Gerta Qurku, një organizatore e mrekullueshme e infrastrukturës së këtij festivali; Eno Milkanit, që bën punën përzgjedhëse dhe të mundimshme artistike; bashkë me kontributin e madh të gazetarit, skenaristit dhe publicistit Fatos Baxhaku premtojnë për një aktivitet interesant dhe me shumë pretendime.

Festivali Ballkanik i filmit dhe kulinarisë i afrohet dekadës

Nga data 2 korrik deri më 7 korrik 2018, shoqata Art-Im-Pulse organizon në kinemanë e Pogradecit edicionin e VIII të Festivalit Ballkanik të Filmit dhe Kulinarisë (B3F), i vetmi aktivitet kulturor ndërballkanik në Shqipëri. Marrin pjesë me krijimit e tyre qindra artistë nga të gjitha vendet e Ballkanit. Gjatë këtij edicioni do të projektohen 75 filma të gjinive: metrazh i gjatë, i shkurtër, filma eksperimentalë, filma të animuar. Gati një e katërta e filmave janë krijime të rinjsh nga shkollat e filmit në Ruman, Serbi, Shqipëri, Maqedoni, etj.

Filmat e gjatë në konkurrim janë "Dita zë fill", Genti Koçi, Shqipëri; "Martesa", Blerta Zeqiri, Kosovë; "Sekrete nga e kaluara", Rasit Gorgulu, Turqi; "Omnipresent" Ilian Djevelevok, Bullgari.

Në kuadrin e vitit jubilar në përkujtim të 550-vjetorit të vdekjes së Gjergj Kastrioti-Skënderbeut do të projektohen filmi "Skënderbeu", versioni i restauruar, dhe "Një kafë me Skënderbeun" nga Piro dhe Eno Milkanit.

Për herë të parë këtë vit do të organizohet dhe "Balkan Story". Tetë projekteve do të prezantohen nga vetë autorët dhe Juria e festi-

valit do të përzgjedhë një fitues i cili do të fitojë 500 euro për zhvillim të mëtejshëm të skenarit. Këto para autori mund ti përdorë për përkthim të skenarit apo fazë përgatitore të filmit.

Në bashkëpunim me World Vision, programi "Reporter", në kuadër të festivalit do të organizohet një shkollë verore filmi me pjesëmarrjen të rinjve nga Shqipëria dhe Kosova. Ekspertë me përvojë do të trajnojnë të rinjtë në lidhje me pasqyrimin e tematikave të mprehta sociale. Një çmim special është parashikuar për punën më të mirë të të rinjve.

Çmimet e festivalit do të caktohen nga një juri ndërkombëtare, joballkanike, me pjesëmarrës të figurave të njohura të ekranit nga SHBA, Franca, Anglia, Italia, Austria, Spanja.

Të ftuar ndër të festivalit janë figura të njohura të kinemasë shqiptare: Margarita Xhepa, Tinka Kurti, Xhevdet Ferri, Ndiçim Xhepa, Ema Andrea, Reshat Arbana, Mirush Kabashi, Kujtim Çashku, Mevlan Shanaj etj.

President nderi i festivalit është i mirënjohuri Viktor Zhusti.



Për "Art-Im-Pulse", festivalin e bukur të Pogradecit

PËRMBLEDHJE

Ky festival filloi në vitin 2011 me idenë për të mbledhur krijuesit e filmave dhe artistët nga vendet e Ballkanit për të ndarë dhe shkëmbyer përvojat e tyre. Aktiviteti pati mbështetjen e madhe të Bashkisë së Pogradecit dhe kështu filloi Festivali i Filmit dhe Kulinarisë në Ballkan. Të ftuarit e parë theksuan vendndodhjen e mrekullueshme të qytetit për të mbajtur një festival të tillë. Natyra, Liqeni i Ohrit, qyteti i Pogradecit dhe ai i Ohrit janë një kombinim i mrekullueshëm për një ngjarje të tillë. Çdo gjë ndodhet në qendër, kinema, restorant, hotele dhe objekte të tjera janë në një distancë të këmbë, kështu që është e pamundur të humbasësh askënd apo ngjarje. Të gjitha ngjarjet u nënshtrohen syve kurioz të njerëzve lokalë që janë gjithashtu pjesë e shfaqjeve dhe ngjarjeve të tjera, që zhvillohen në qytetin e tyre. Filmat, muzika, artizanët vendas, kuzhinat etj. përhapen në të gjitha mjediset e qytetit. Ballkani është krejtësisht prezent në atë që zhvillohet në qytetin e Pogradecit gjatë një jave. Nën këtë atmosferë të këndshme, artistët të ndryshëm nga vende të ndryshme të Ballkanit mblihen së bashku si një shenjë e toler-

ancës dhe bashkëjetesës paqësore dhe ky është qëllimi më i madh i organizatorëve.

KUSHTET E PJESËMARRJES

Çdo artist nga Ballkani ka të drejtë të marrë pjesë në festival. Filmat cilësorë, filmat dokumentarë, të shkurtër dhe ato të studentëve janë materiali kryesor i festivalit. Në mëngjes në kinema kryesisht paraqesin filma të shkurtër dhe shfaqjet pasdite i dedikohen dokumentarëve. Shfaqjet e mbrëmjes i dedikohen filmave të metrazhit të gjatë ku ka përfaqësime dinjitoze, sipas organizatorëve. Artistët inkurajohen të marrin pjesë edhe nga faqja e internetit (www.balkan3f.com) që i grish të marrin pjesë ose të plotësojnë aplikacionin për të sjellë, natyrën shumë ballkanike, gjuhën, filozofinë, fytyrat dhe zakonet, sepse ky është qëllimi i festivalit. Shkëmbimi i kulturës dhe disponimit tonë është mënyra e vetme e marrëdhëniesve të mira fqinjësore.

QËLLIMET E FESTIVALIT

Përveç shfaqjeve publike ngjarja synon gjithashtu: shkëmbimin e kulturave ball-

kanike që pasurojnë jetën kulturore në qytetin e Pogradecit.

Krijimin e një mënyre të besueshme dhe zrytore të bashkëpunimit eventual në fushën e bashkëprodhimit të filmit.

Diskutimin e skenareve të përfunduara për zhvillim të mëtejshëm, ose për gjetjen e mënyrave të mbështetjes financiare përmes qendrave kinematografike kombëtare të Ballkanit.

Prodhimin e shkollave të filmit. Çdo ide tjetër që do të dalë gjatë ditëve të festivalit.

Trajnimi i të rinjve, nën mbikëqyrjen e filmave profesionistë.

PSE NË POGRADEC?

Historikisht, kjo zonë, është e njohur për rrugët e saj tregëtare midis vendeve të Ballkanit në shekuj si Rumania, Bullgaria, Greqia, Maqedonia dhe Shqipëria që nga koha e ekzistencës së Perandorisë Osmane. Kufijtë e ujit, të cilat në një farë mënyre janë të pakuptimta midis Shqipërisë, Greqisë dhe Maqedonisë janë çelësi për të organizuar një festival të tillë në Pogradec, kjo si shenjë e respektit dhe mirëkuptimit të bashkëjetesës midis vendeve të Ballkanit. Gjithashtu qyteti i Pogradecit mbarnt një numër të mirë të karakteristikave shqiptare. Është gjithashtu një qytet me tradita të pasura të kulturës dhe artit dhe përmbush kërkesat dhe infrastrukturën për një festival të tillë.

Periudha e hershme e verës përkon me fillimin e sezonit turistik, kështu që prania e turistëve do të rrisë vëmendjen e publikut. Kjo është një kohë e përshatshme për shfaqje në mbrëmje në natyrë si një pjesë magjike e jetës së filmit. Së fundi, ajo shton edhe një tërheqje tjetër në jetën kulturore dhe artistike në qytet.

A

AKTIVITETE

Lidhja e Prizrenit kujtohet në Kostancë të Rumanisë

Muzeu Kombëtar i Historisë dhe Arkeologjisë së Konstancës, në Rumani, së bashku me Shoqatën Lidhja e Shqiptarëve të Rumanisë (ALAR), zhvilluan konferencën shkencore me rastin e 140-vjetorit të Lidhjes Shqiptare të Prizrenit, me pjesëmarrjen e universitarëve dhe historianëve rumunë.

Konferenca u përshëndet nga deputeti i Parlamentit të Rumanisë, përfaqësues i pakicës kombëtare shqiptare në Rumani, Bogdan Alin Stoika. Deputeti Stoika foli për numrin e madh të aktivitetëve që ka ndërmarrë ALAR për promovimin e historisë, kulturës dhe artit shqiptar, sidomos gjatë këtij viti. Gjithashtu ai në fjalën e tij theksoi se “Rumania luajti një rol të rëndësishëm në Rilindjen Kombëtare Shqiptare, vendi ku është zhvilluar aktiviteti politik i shoqërive patriotike shqiptare, ku janë botuar veprat e shkrimtarëve më të rëndësishme të Rilindjes, librave dhe gazeta të ndryshme, duke filluar me abetaren e Naum Veqilharxhit, librat e Naim Frashërit, Lasgush Poradecit etj”.

Më pas e mori fjalën historiani dhe shkrimtari Dr. Liviu Lungu, me origjinë shqiptare nga nëna,



dhe me katër romane të botuara në gjuhën shqipe. Historiani i mirënjohur Liviu Lungu theksoi përpos të tjerash se: “Lëvizja kulturore e Rilindjes Kombëtare Shqiptare, si vetëdije kulturore, si dhe Lidhja Shqiptare e Prizrenit, si vetëdije politike, janë ngjarjet më të rëndësishme në historinë e kombit shqiptar në gjysmën e dytë të shekullit XIX, të cilat përgatitën shpalljen e pavarësisë së Shqipërisë.” Dr. Liviu Lungu theksoi se ishte zgjedhur pikërisht Konstanca për këtë veprimtari të rëndë-



sishme, për shkak të kontributit të vyer të komunitetit shqiptar të Konstancës gjatë Rilindjes Kombëtare, para dhe pas shpalljes së

Pavarësisë. Në qytetin e Konstancës u hap shkolla e parë në gjuhën shqipe, ku Asdreni ishte mësues i saj. Këtu u ngrit “Tipografia Albania”, në të cilën u botuan libra të rëndësishëm të kulturës shqiptare, periodikë në shqip dhe tekste shkollore për nevojat e shkollave shqiptare.

Prof. Dr. Daniela Busa, e njohur si specialiste e historisë moderne të vendeve të Evropës Juglindore, punonjëse shkencore pranë Institutit të Historisë “Nicolae Iorga”, mbajti kumtesën: “Shqipëria në një kontekst zonal dhe evropian”. Stu-


diuesja e mirënjohur iu referua kontekstit historik evropian, në të cilin u themelua Lidhja e Prizrenit, duke e ndalur në vendimet e marra, në luftën për mbrojtjen e territoreve shqiptare, deri tek shtypja e saj nga forcat otomane. Prof. Dr. Busa theksoi rëndësinë historike të Lidhjes së Prizrenit, e cila shënoi fazën pararendëse të shpalljes së pavarësisë së Shqipërisë më 1912.

Marius Dobrescu, përkthyes i vepër së Kadare në rumanisht, shkrimtar dhe gazetar, bëri një paraqitje të historiografisë shqiptare mbi këtë eventim, duke u ndalur veçanërisht në kronologjinë e dhe rrethanat historike të Lidhjes së Prizrenit.

Në këtë aktivitet merrnin pjesë universitarë, studiues të historisë, anëtarë të komuniteti historik të shqiptarëve të Konstancës, por dhe studentët shqiptarë që ndodhen me studime në Universitetin “Ovidius” të Konstancës.

Kujtojmë se Muzeu i Historisë dhe Arkeologjisë së Konstancës ka qenë vendi ku janë zhvilluar një sërë aktivitetesh me personalitete të letërsisë së sotme shqipe, si Visar Zhiti, Rita Petro etj, organizuar nga Lidhja e Shqiptarëve të Rumanisë.

Përgatiti M. Skënderi Bukuresht



A

ARTE PAMORE

Vepra artistike “Çufoja dhe Bubi Kaçurrel” përballë Presidencës

Lulishtes përballë Presidencës i janë shtuar dy “banorë” të rinj, aq të dashur për fëmijët, Çufoja dhe Bubi Kaçurrel, të cilët këtë vit kanë mbushur 40 vjeç. Dy personazhet, që kanë shoqëruar fëmijërinë e shumë shqiptarëve, janë përjetësuar tashmë jo vetëm në kujtesën tonë me batuat e tyre, por edhe përmes instalacionit të ideuar dhe konceptuar nga artisti Eljan Tanini.

Vepra artistike “Çufoja dhe Bubi Kaçurrel” vjen si një përmorje në 40 vjetorin e botimit të romanit me të njëjtin titull të shkrimtarit të dashur për fëmijë, Gaqo Bushaka, dhe imiton letrat origami të zmadhuara, si një mënyrë për të ngacmuar memorien e të rriturve, por edhe për të nxitur fëmijët dhe të rriturit drejt librit dhe kujtimeve të fëmijërisë. Instalacioni u përua nga nënkryetari i Bashkisë së Tiranës, Andi Seferi, ideatori Eljan Tanini dhe krijuesi i dy personazheve, shkrimtari Gaqo Bushaka.

Nënkryetari i Bashkisë së Tiranës, Andi Seferi falenderoi Ta-

nin për veprën e artit modern që i ka dhuruar Tiranës, si dhe autorin e romanit “Çufo dhe Bubi Kaçurrel”, Gaqo Bushaka, për të gjitha emocionet që ka dhuruar me librat dhe humorin e tij në fëmijërinë e çdo shqiptari. “Interesi publik për vendosjen e kësaj vepre në park, mbetet i lartë. Sa estetik, fëmijor, artistik, simbolik, por edhe historik. Është e hera e parë në historinë e vendosjes së veprave të parkut në Shqipëri, ku krijohet kjo veper arti kushtuar përrallës shqiptare



që ka frymëzuar breza të tërë fëmijësh dhe të rriturish”, tha Seferi.

Artisti Eljan Tanini theksoi se “Çufo dhe Bubi Kaçurrel”, kanë ndikuar dhe vazhdojnë të prekin ende jetët e mijëra shqiptarëve të vegjël dhe të mëdhenj me batutat e tyre, ndaj kjo veper arti që i kushtohet të vegjëlve vjen edhe si një mirënjohje për autorin që



ka krijuar dy personazhe origjinale shqiptare.

“Duke falënderuar përzemërsisht Gaqo Bushakën për humorin e tij fin që nuk fyen askënd, i shkruar në kohën kur Shqipëria jetonte vite të vështira, uroj shumë që këta dy personazhe të vendosur në park, të jenë një ogur i mirë për t’u kthyer më shumë te libri, te politikat mbi librin, te autorët e ndryshëm, por edhe te këta personazhe që unë mendoj se duhen lexuar patjetër nga çdo shqiptar. Çufo është simboli i shpirtit të lirë dhe aventurierit që e jeton jetën si t’i vijë e që gjithmonë gjen një zgjidhje për problemet që has”, tha Tanini.


Romani Çufoja dhe Bubi Kaçurrel është shkruar për herë të parë në vitin 1978, prandaj ky inaugurim sillet në 40 vjetorin e krijimit të tyre. Të vendosur në lulishten karshi Presidencës së Republikës, pranë Qemal Stafës, Ismail Qemalit, dhe kompleksit të Checkpoint të diktaturës, vepra artistike “Çufo dhe Bubi Kaçurrel” i kushtohet fëmijëve, që u rritën me përrallat dhe letërsinë e gjuhës shqipe.

Kjo veper është dhuratë për qytetin e Tiranës nga Emira Zen

V

VIZATIM

Ky është një cikël i ri i piktorit Maks Velo me përshtypjet lirike për Parisin, vendlindjen e tij. Pa u kujdesur shumë për detajin, por duke dhënë gjendje të tij të çastit, ai na shpalos emocionin e qytetit më romantik të botës. Duket se adhurimi për këtë qytet e bën më të çlirët, por nga ana tjetër e nguc të shpalosë me forcën e materialit të vizatimit atë që e ngërthen brenda dhe e mban kaq të lidhur me qytetin e madh...



Opinion *i* Ditës

Sa mirë ke bërë, o Zot, që nuk e kufizove budallallëkun!

Nga Kiço Blushi

(vijon nga faqja 1)

... pa surpriza e pa të papritura, me siguri, për këtë shkak, - të mërziqë dhe monotonisë - një jetesë e, në daç, edhe një bashkëjetesë e kësollojtë, - në kotani e në shkretëri njëtrajtshmerie - do të na kishte ofruar më shumë vetmi, më pak befasi, humor e gëzim, interesa e konkurrencë, përpjekje dhe ambicie për përparim. Pse jo, edhe një botë me më shumë vetëvrasje se lindje.


Guri i famshëm që pat hedhur dikur në lumë një budalla, bëri që dyzet të mençurit e katundit të mblidhen e të kërkojnë jo gurin në lumë, por të zbulojnë formulën H₂O, gjallesat, ligjet e florës e të faunës, si mund të ngjitet uji përjetë, si mund të shndërrohet rrjedha e lumenjve në energji, madje të parakuptojmë pastërtinë apo ndotjen e ujit që pimë, para se të jetë vonë e të helmohejmë...

Sepse pa budallallëkun nuk do të kishim as politikanë, as shkrimtarë, as analistë, as art, as humor, as dramë, as komedi, as televizione e gazeta, rrjedhimisht as regjisorë e aktorë, që të luanin me sukses rolet që i patën bërë të shquar, aq sa adolehentët, nëpër kudo, të vdesin për të pasur një selfie me ta...

Raporti i vlerave me antivlerat nuk do të ishte ky që është sot, në favor të budallallëkut. Po të ishin të gjithë të mençur, nuk do të kishte asnjë mundësi që derat, si në "Fermën e kafshëve" të Orwellit, të merrnin pushtetin e të vinin përfund shoqërinë njerëzore.

Njeriu normal nuk do të kishte asnjë mundësi të kuptonte e të zbulonte, pa shumë mundim, të vërtetën, po qe se Zoti do të na e kishte kufizuar budallallëkun, si bëri me inteligjencën... Njerëzimi nuk do të kishte shpikur shkollat, universitetet, librin, akademinë, filmin... Shoqëria nuk do të kishte nevojë për qeveri, parlament, polici, gjykata, veting... Kujtesa dhe trashëgimia nuk do të kishin këtë kuptim e vlerë universale që kanë në shoqëritë demokratike e përnjimend të civilizuar, që përparojnë edhe për shkak se shumica di për kë voton e përse voton...

Po të kufizonte budallallëkun, Zoti do të na e kishte hequr mundësinë të dallonim kufirin që ndan të mençurin me budallanë, faqezin me të ndershmin, horrin me të drejtin, diktatorin me autokratrin. Po të kishte kufizim budallallëku, sikurse inteligjenca, ne nuk do të zgjidhnim historikisht e ciklikisht kësi sojsëzësh e delirantësh, tanimë edhe "me vota të lira dhe demokratike"...



E jo vetëm një, por disa herë... E jo vetëm me dhunë, por edhe me duartrokitje e gëzim.

Jo, jo, nuk ka faj Zoti që budallallëku tanimë është bërë gjithëpërfshirës, një epidemie

Njeriu normal nuk do të kishte asnjë mundësi të kuptonte e të zbulonte, pa shumë mundim, të vërtetën, po qe se Zoti do të na e kishte kufizuar budallallëkun, si bëri me inteligjencën... Njerëzimi nuk do të kishte shpikur shkollat, universitetet, librin, akademinë, filmin... Shoqëria nuk do të kishte nevojë për qeveri, parlament, polici, gjykata, veting... Kujtesa dhe trashëgimia nuk do të kishin këtë kuptim e vlerë universale që kanë në shoqëritë demokratike e përnjimend të civilizuar, që përparojnë edhe për shkak se shumica di për kë voton e përse voton...

shëm, i papërballueshëm, i pakkonkurrueshëm, mjaft që të hyjë e të mbetet në histori.

Sepse me sa ka provuar historia njerëzore, pra jo vetëm tek ne në Shqipëri e më gjerë, në trojet tona etnike, ku ne ndjehemi aq krenarë e fodullë, por edhe në botë, edhe në SHBA dhe në BE, nuk paska ndihmës më të madh e më të kollajtë për t'iu afruar së vërtetës se sa kur dëgjojmë me vëmendje e madje edhe me respekt budallenjtë.

Duan nuk duan intelektualët e shquar të një kombi, janë këta, pra budallenjtë, shtytësit dhe eksploratorët e së vërtetës, lakmuesit e saktë që vërtetojnë "shkencërisht" e lehtësisht nivelin dhe rrezikun e sëmundjeve morale të çdo shoqërie normale.

Aq më tepër tani që kemi aq shumë podiume, tribuna, demagogji diarretike, gënjeshtër e mashtrime, dëgjesa publike, debate, seanca kuvendore të enjteve, kanale televizive dhe portale gjirizore nëpër internet, nevoja për të pasur e për të dëgjuar budallenjtë është bërë, duam nuk duam, buka jonë e përditshme, një domosdoshmëri ose, thënë me gjuhën e kohës, një nevojë "institucionale", që fatkeqësisht po i jep shijë dhe, pse jo, edhe kuptim përditshmërisë.

Sepse budallallëku është përherë një hap më para, dmth. në avantazh ndaj inteligjencës, ndoshta ngaqë ka më shumë guxim t'i thotë dërrit dajë e të hajë jo vetëm turpin, por edhe të pëgërat e të vjellat e veta me bukë. Ca më tepër të shefave... Një sherrbudalla nuk e ka për turp e për marre të shkelë edhe mbi emrin e vet, siç druhet e matet një njeri i mençur që e ka ngritur emrin e vet me sakrificë, me dije, me dinjitet dhe djersë.

Por kush shkel mbi emrin e vet, pa u shquar e pa u zverdhur, duke thënë edhe para kamerave, edhe para popullit të kundërtën e asaj që kanë pas mbrojtur një ditë më parë, nuk ka ngurrim, as cipë në ballë, as ndërgegje të bëjë të pabërën. Përkundrazi, ai që shkel edhe mbi emrin e vet ofrohet me entuziazëm të shkelë e të shesë për hiçmosgjë dinjitetin vetjak, kursesi nuk mund të mbrojë interesin publik, një kauzë të drejtë, aq më pak një ideal, apo ca më pak, një pronë publike, siç është Teatri Kombëtar për të cilin po flitet aq shumë...

Ja pra përse malli që kushonit më pak dhe vlen më shumë sot është budallallëku.

Prandaj nuk duhet bërë me faj Zoti që nuk e ka kufizuar budallallëkun.

Sepse ai na ka dalë borxhit, dmth., na ka krijuar mundësinë e kollajllëkun të kuptojmë më mirë e më drejt veten, njerëzitetrin, shoqërinë ku jetojmë...

mbarëkombëtare, model i vetëm i suksesit dhe përparimit, karrierës dhe karizmës, fatit dhe shansit, aq sa një mediokër e një hiç, të cilit i lexohet injoranca, pa e hapur gojën, të bëhet pa vështirësi jo vetëm pasunar, biznesmen, por edhe i shquar, VIP, udhëheqës, sundues, arbitrar, pushtetar, kryeministër, ministër, deputet, madje edhe akademik.

Nuk paska gjë më të shpifur e më të dëmshme se një budalla i vetëgopur, i dehur me vetveten që kujton veten sipëror e kompetent për gjithçka. Ky tip, kur merr edhe pushtet, fillimisht humbet veshët, pastaj sytë e më në fund edhe atë pak arsye që i ka falur Zoti sa për të lidhur ushkurët... Një udhëheqës i tillë nuk ka rrugë tjetër veçse të shtojë zullumet, të bëhet i rrezik-

Opinion i Ditës

Kampionati njëvjeçar i integritimit

Nga Fatos Çoçoli

(vlon nga faqja 1)

...vendosi që për Shqipërinë dhe Maqedoninë ta shtyjë një vit datën e nisjes së bisedimeve për anëtarësim. Pse? Arsyet janë tërësisht jashtë nesh. Kush rreket t'i gjej jo te qeveria e kimit, tek narco-shteti e me radhë, e ka kot. Opinionin teknik për përparimin e Shqipërisë dhe Maqedonisë, të 28 shtetet anëtare të Bashkimit Evropian e morën më 17 prill 2018 nga Komisioni Evropian. Ata nuk e diskutojnë më atë. I besojnë plotësisht. Nuk janë si ne. Por disa shtete nuk na besojnë ne. Ose, më mirë, disa nga politikanët e tyre kryesorë. Cilat? Franca, Holanda, Danimarka. Franca, në personin e Presidentit të saj Emanyel Makron nuk e ka tamam me ne, por me shqetësimin se hapja e negociatave me Shqipërinë e Maqedoninë do të rrisë elektoratin e forcave kundër emigracionit, në prag të zgjedhjeve për Parlamentin Evropian. Politikanët e Holandës dhe Danimarkës thjesht nuk besojnë se jemi gati. Kanë një dyshim të fortë ndaj aftësisë sonë për një shtet me ligjor. Është e drejtë kjo? Sigurisht që jo. Në vitin 2012, Malit të Zi, vendimi për hapjen e bisedimeve iu shty vetëm me 6 muaj. Për Serbinë, hapja ishte e menjëhershme. Por kjo ka pak rëndësi tani. Në Bashkimin Evropian ka shumë politikanë të rëndësishëm që nuk na besojnë, janë skeptikë ndaj nesh. Është faji i tyre? Jo. A ka paragjykimë pse jemi një vend me shumicë myslimane? Jo, pse vendimi i shty edhe për Maqedoninë, që nuk ka shumicë të popullsisë myslimane. Kurse papërgjegjësitë e politikës sonë nuk kanë fund. Duhet të ndërgjegjësohemi mirë për këtë, pse rrallëherë jemi shqetësuar si na shohin dhe konsiderojnë të huajt. Sidomos ata që na matin nga mëngjesi e deri në darkë, nga Brukseli. Me gjithë mosbesimet, vendi ynë ka bërë hapa të fortë përpara. Shqipëria u vlerësua për nisjen e reformës në drejtësi, ndërsa vende si Serbia e Mali i Zi, që i kanë nisur bisedimet nuk e kanë filluar ende këtë reformë. Prej kohësh, brenda Bashkimit Evropian ka një diskutim që sa vjen dhe bëhet edhe më i fortë: BE duhet të vijojë të zgjerohet, apo të mbyllet e të mos hapet më? Ky diskutim është real. Ofensiva e partive dhe politikanëve populjistë është rreziku kryesor i mbylljes brenda kufijve të tanishëm të Bashkimit Evropian. Ne duhet t'i ndihmojmë forcat zgjeruese brenda Bashkimit Evropian, si politika e sotme gjermane në qeverisje, ajo austriake, greke e me radhë. Lind pyetja, në këtë situatë, ç'duhet të bëjmë ne për një vit: korrik 2018-qershor 2019? Atë që nuk e kemi bërë, për fat të keq, kurrë deri tani. Të bashkohemi për t'u rreguar të gjithë mosbe-



suesve në qeveritë e vendeve anëtare të BE-së, sidomos tek Holanda dhe Danimarka, por edhe Franca, se e meritonim nisjen e bisedimeve që këtë qershor edhe po na e shtyjnë me pa të drejtë. Kuvendi të dalë me një rezolutë të përbashkët, mundësisht brenda kësaj legjislatore (i mbyll dyert në fund të korrikut). Të firmoset rezoluta edhe po të mos votojë opozita. Një plan konkret veprimesh në nivel të çdo institucioni kush-

tetues dhe ministrish të qeverisë, të përcaktohet për masa të forta në tri drejtimet ku na janë vendosur kushtet-kritere për t'u plotësuar në këto 12 muaj. Në reformën në drejtësi, në luftën kundër korrupsionit dhe në luftën kundër kriminit të organizuar. Nëse në reformën në drejtësi kanë nisur të duken rezultatet e para të ndryshimit, nga mungesa e strukturave shtyllë të kësaj reforme si SPAK, etj., si dhe në luftën kundër krim-

it të organizuar ka disa lëvizje konkrete, me ofensivën shtetërore kundër korrupsionit jemi në vendnumëro. Madje, butaforia qeveritare se goja po e lufton nga themelet atë, është veprimi më i dëmshëm, që nuk bind jo vetëm çdo qytetar shqiptar, por as edhe Brukselin. Me portale dhe me ligje në letër nuk luftohet nga rrënjët korrupsioni. Korrupsioni luftohet në sistem, me struktura dhe institucione të pavarura, jo me bërthamë qeveritare. Institucione si ILLD-KPKI, që ka denoncuar shumë fort me dokumentacion profesional jo pak herë, apo KLSH që në 6 vjet e gjysmë, e cila po me dosje të kopistura mirë ka bërë nga një denoncim çdo javë, duket sikur anashkalohej nga politika e ditës, sidomos nga potenciale qeveritare për goja masa efektive kundër korrupsionit. Duhet të ndihemi në garë me kohën, si në një kampionat me dyloftime përjashtuese. Duhet të nisim kampionatin kombëtar njëvjeçar i integritimit, ndryshe e kemi pisk punën.

Me gjithë mosbesimet, vendi ynë ka bërë hapa të fortë përpara. Shqipëria u vlerësua për nisjen e reformës në drejtësi, ndërsa vende si Serbia e Mali i Zi, që i kanë nisur bisedimet nuk e kanë filluar ende këtë reformë. Prej kohësh, brenda Bashkimit Evropian ka një diskutim që sa vjen dhe bëhet edhe më i fortë: BE duhet të vijojë të zgjerohet, apo të mbyllet e të mos hapet më?

HOROSKOPI

DASHI

Dielli së bashku me Hënë do t'ju vërë në provë. Do të zbatoheni duke bërë të shfaqen tensione, që zakonisht i mbani nën kontroll. Do të jeni të acaruar dhe aspak tolerantë përballë keqkuptimeve të vogla me të tjerët.

DEMI

Nëse jeni ende beqarë, ndoshta do të krijohen kushtet favorizuese për të bërë takime premtuese, duke u dhënë më shumë hapësirë hobive dhe krijimtarisë suaj, do të jeni më të gatshëm për të ndihmuar të tjerët.

BINJAKET

Do të jeni autoritarë dhe konkretë. Edhe pse për shkak të kundërshtive të vogla do të përjetoni momente të mira e të këqija. Dorëzohuni përpara fakteve, zemra ju rreh fort për një person të veçantë, që deri më tani e keni shpërfillur.

GAFORJA

Urani ju jep shumë energji, e cila është ideale për të dalë për t'u argetuar me miqtë, por edhe për të ushtruar sporte të ndryshme. Do të dini gjithashtu edhe të gjeni një mes të artë midis dashurisë dhe punës, duke fituar admirim nga të gjithë.

LUANI

Strategjitë pak komplekse dhe pak të paqarta që po vini në zbatim nuk do jenë më efektive sesa një linjë veprimi konkrete, e qartë dhe e saktë. Me Venusin dhe Marsin armiqësor qëndroni larg flirtimeve, që i bëni thjesht për inat.

VIrgjeresha

Në mjedisin e punës mund të ndryshojë disa gjëra. Duhet të përballeni me sfida të reja. Është e fortë dëshira për të rilindur, për t'ia nisur nga e para. Është një ëndërr që mund të realizohet dhe e keni vetë në dorë për t'ia dalë. Varet nga vullneti juaj.

PESHORJA

Me Plutonin jo shumë miqësor bëni kujdes me ata që nuk janë duke ju thënë të vërtetën. Nuk mund të bëni më sikur nuk e kuptoni, është koha për sqarime. Do të përftoni nga një frymëzim nismëtar, që do të mbështetet nga fantazia dhe krijimtaria.

AKREPI

Venusin do ta keni kundra, por nuk ju sjell ndërlitime. Ndërkohë, e mbështetur nga aspekti pozitiv i Hënës, nxjerr në pak interesin reciprok. Do të jeni të lumtur dhe të kënaqur, aq sa të ndryshoni qëndrimin duke i hapur dhe dëgjuar nevojat dhe dëshirat e partnerit.

SHIGJETARI

Nëse do t'ju duhet të përballeni me tekat e një familjari, jini të duruar. Mos bini pre e nervozimit dhe përpuni ta zgjidhni çështjen me urtësi. Të mendoni mbi atë që duhet të bëni do t'ju ndihmojë të qartësohen për rrugën që doni të vazhdoni të ndiqni.

BRICJAPI

Sot do të keni të bëni më shumë me kënaqësinë sesa me punën. Do t'i zgjidhni çështje e përditshme me efikasitet për t'u pasur zili. Në çështjet e dashurisë do të keni një luftë të brendshme midis dëshirës për t'u shmagur dhe nevojës për siguri.


UJORI

Është koha e duhur për të ndërtuar me vendosmëri dhe durim bazat për të zhvilluar më tej projekte të ndërrmarra. Jepini pral! Do të dini të shqyrtoni në mënyrë të prerë dhe me zgjuarsi çështje shumë delikate dhe të rëndësishme, që kanë të bëjnë me punën.

PESHQIT

Detyrat dhe përgjegjësitë duhet të jenë në plan të parë për ju me Saturnin dhe Hënë që bashkëveprojnë duke ju mbështetur. Një mijë me ndikim, me ju shumë përvojë ose me i madh se ju, do t'ju ndihmojë të realizoni një ëndërr.

Fjalëkryqi (1)



HORIZONTAL

- Mund të jetë kursimi.
- Ylli i Nostradamus.
- Tamam pa kufij.
- Ross këngëtare.
- I lashtë.
- Eshhtë Aleanca ku sapoi kemi aderuar.
- Kufijtë e lëvizjes
- I ka tek plepi.
- Paguhën për shërbim.
- Fillojnë lejen.
- Kufizojnë trotualet.
- Bëjnë karrierë në parti.
- Thahet me bonifikim.
- Mund të jetë unik një i tillë.
- Preka komik shkordran.
- Fund dhjetori.
- Fillojnë aksionin.
- Ente Operative Tiranë

- Agjenci Ajrore Durrës.
- Një pjesë e dimensioneve.
- Eshhtë përfaqësuesja e Adriam Mutu.
- Kalimi në ekstreme.
- Eshhtë e re pas Krishtit.
- Shkruhet për të mos vazhduar më.
- Si i gjithë.
- Kush e thotë lutet.
- Kufij elementi.
- Ishtë nija që preu Aleksandri i Madh.
- Një pjesë e titanëve.
- Mund të jetë kundërmuese.
- Pak titanike.

VERTIKAL

- Si i përshtatëshëm.
- Mund të jenë fetare.
- Ai i kuq e ka një huq.
- Pak analogji.
- Eshhtë metri i rrobaqepësit.
- Në hyrje të oazit.
- Arte pa re.
- Arthur që qe dramaturg.
- Janë boshte.
- Michelangelo regjisor.
- Mund të bëjë stil të lirë.
- Ishin monedhe te Tobias.
- Eshhtë bas me katër tela.
- Pak efikasitet.
- Eshhtë marrëveshje me nota.
- Ishite babai i Akitit.
- Fillojnë nazet.
- Në krye të kuadrove.
- Eshhtë faqe muri.
- Një apendisit i menjëhershëm.
- Kurosawa që qe regjisor.
- Vriten nga espada.
- Eshhtë shtet aziatik.
- Edouard piktor.
- Një transporti është kamioni.
- Uni i Freud.
- Një cigan.
- Fundi i një samurai.

Fjalëkryqi (2)


HORIZONTAL

- Fillojnë panikun.
- Gibson aktor.
- Në mes të cogito dhe sum e thën nga Descartes.
- Mund të jetë trofe.
- Janë vendet si Katari
- Maureen që qe aktore.
- Janë kundërmuese.
- Mund të fitojnë etapa.
- Ushtojnë nga "ola".
- Një thirrje
- Janë ministritë.
- Një rrugë në Paris.
- Markë cigareje.
- Eshhtë ngjinja.
- Ricciarelli soprano.
- Fillojnë sefte.


- Ente Ekonomike Sarandë.
- Mbyllin një ditar.
- Satelit i Jupiterit
- I ka tek Luani.
- Boldi komik italian.
- Eshhtë kolana në filma
- Kush e thotë lutet.
- Oxa këngëtare.
- Inicialet e Nolte aktor.
- Eshhtë tokë që... fitohet.
- Një... gjermane.

VERTIKAL


- Një votë në favor.
- Filozofi me eksperimentin e gomarit.
- Në hyrje makinës.
- Fillojnë lehtë.
- Irlanda në Dublin.
- Eshhtë edhe ajo e historisë.
- Një pjesë e gamiljeve
- Notat pa kufij.
- Ishin komitë.
- Ka kryeqytet Islamabad.
- Don... i Interpretuar nga Terence
- Mbyllin aktet.
- Janë përmasa.
- Gjysma e lutjes.
- Castellitto aktor.
- Inicilat e Dalí, piktor.
- Tanita këngëtare.
- Eshhtë trysni
- Në hyrje të Europës.
- Janë rrobat për t'u larë.
- Bën mëza.
- Moreau aktore.
- Janë thika.
- Një pjesë e satelitit.
- Janë teke në sende.
- Pak marramendëse.
- I ka tek zdapi.
- Inicialet e Nolte-s.



Gjeni ndryshimin



Di figurat kanë ndryshime nga njëra-tjetra



Përgjigja, ja cilat janë ndryshimet e figurave

PËRGJIGJET E FJALËKRYQVEVE TË NUMRIT TË KALUAR

FJALËKRYQI (1)

DAVID ROCK LKR
EMER KE A SEAN
MALOT KENETAT
IN NIM ROMANET
R MPASIVET
MOKASINA IDEM
EMIRATI AVATI
STANE ATOMIK N
AR ST RETE OD
RASE MI KORE
ATA T AKATI DAR
H STAR STRART

FJALËKRYQI (2)

BALENA AM MOTI
ENK AGAL UMA
KIMIKR KARA TE
IT PALET LIRIA
MAT PETALET MR
IT MAKETEET KOT
KALKULIMET RE
MULER METALE
ANBETA IREPOI
NAIF P TIDE
ETJE MINA TOREI
TTRENI AFATI

SUDOKU

7	6	8					4
			2	4			5
		2	6			3	9
9	8		5	6			2
	7		8		3		4
6				1	9		3
	3	1			7	2	
	5			9	6		
4						5	7

Plotësoni vendet bosh në mënyrë që çdo kolonë të ketë numrat nga 1-9

Përgjigje e sudokut të numrit të kaluar

3	8	5	1	9	6	2	4	7
2	9	4	7	3	5	6	8	1
7	6	1	8	2	4	9	3	5
1	2	3	5	4	8	7	6	9
5	7	8	6	1	9	3	2	4
9	4	6	2	7	3	1	5	8
8	1	9	4	6	2	5	7	3
6	5	7	3	8	1	4	9	2
4	3	2	9	5	7	8	1	6

Argëtim filozofik

- Në jetë ekzistojnë: dashuria, urrejtja, mospërfilla. Jep çfarë të duash, merr çfarë jep.
- Nëse të pasurit mund të punësonin dikë që të vdiste për ta, të varfrit do të jetonin një jetë të rehatshme.
- Që të jeni në kujtimet e fëmijëve tuaj nesër, DUHET të jeni në jetën e tyre sot!



KRIPTOSKEME

KRIPTOSKEME
Përgjigja e numrit të djeshëm

3	1	7	2	7	3	13	2
2	7	5		8	4	3	5
7		3	1	9	1	6	5
	3	5	8	2	3	5	6
12	5	13	5	10	1	7	6
2	7	18		5	11	2	6
8	2	6	2		2	1	8
1	6	8		17	9	5	7
3	1	5	8	2	16		2
2			3	2	6	5	9
6	2	7	2		3	7	3
3	4	8	5	19	1	5	3

A	P	A	P	E	K	E	N	D	E	T
D	I	A	B	E	T	I	D	E	T	I
R	A	K	L	K	A	P	E	L	E	T
F	E	N	I	M	O	R	E	T	R	
F		E	K	O	N	O	M	I	A	D
R	A	T	A	K	E	M	E	T	P	E
A	N	T	E	N	A	A	T	A	A	B
K	A	N	T	E	S	T	L	A	R	A
K	N	E	I	I	L	I	R	E	T	
I	B	A	N	A	K	A	E	T		
B	A	R	I	A	L	E	T	N	E	D
E	B	A	S	T	I	A	F	A	T	I

Thënie të mëncura

- Njeriu kur ndjen dhimbje, është i gjallë...
- Por kur ndjen dhimbjen e tjetrit, atëherë është NJERI!
- Gabimet e te shkuars. . . Rrezikojne lumturine e te ardhmes. . .
- Çdo gjë që këputet mund të lidhet, por mos harro se në vendin ku lidhet mbetet nija..!
- Gënjeshtrat që ti thua për mua, nuk thonë asgjë për karakterin tim, por thonë shumë për tëndin..

www.gsh.al

www.gsh.al

www.gsh.al

www.gsh.al

www.gsh.al

www.gsh.al

GAZETA SHQIPTARE

GSH.AL



- Na merrni!
- Na shkruani!
- Na lexoni!

GSH

www.gsh.al



Tashmë edhe lundroni!

